



**THE AIRE CENTRE**  
Advice on Individual Rights in Europe



**GENDER AND  
THE JUDICIARY**  
in the Western Balkans

# Femicidi në Republikën e Kosovës: Korniza ligjore dhe praktika gjyqësore

2018–2022



Në bashkëpunim me



**FemPlatz**  
UDRUŽENJE GRAĐANKI



# **Femicidi në Republikën e Kosovës: Korniza ligjore dhe praktika gjyqësore**

2018–2022

<b>Titulli:</b>	Femicidi në Republikën e Kosovës: Korniza ligjore dhe praktika gjyqësore (2018-2022)
<b>Botuesi:</b>	Qendra AIRE (Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë)
<b>Për botuesin:</b>	Biljana Braithwaite
<b>Redaktor:</b>	Kosana Beker, PhD
<b>Autorë:</b>	Selvete Gërzhaliu-Krasniqi Gresa Caka-Nimani
<b>Menaxher i projektit:</b>	Sabina Đapo
<b>Përkthimi:</b>	Inter-language

Raporti në origjinal në anglisht është përkthyer gjithashtu në gjuhën shqipe dhe në gjuhën boshnjake/kroate/malazeze/serbe.

©2024 AIRE Centre

<b>Dizajni nga</b>	Kliker Dizajn
<b>Shtypur nga:</b>	PRINT RICOH
<b>Tirazhi:</b>	80
<b>ISBN:</b>	978-1-914005-10-7



**THE AIRE CENTRE**  
Advice on Individual Rights in Europe

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Ky publikim është përgatitur si pjesë e aktiviteteve të mbështetura nga AIRE Centre, me qëllim të forcimit të zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardeve të saj, përmes mbështetjes së analizës së praktikës gjyqësore mbi femicidin në shtetet e rajonit. Autorët janë anëtare të Rrjetit për Barazi Gjinore dhe Forumit të Drejtësisë të Ballkanit Perëndimor. Mendimet e shprehura në këtë raport reflektojnë vetëm mendimet individuale të autoreve.

# » PËRMBAJTJA

<b>I. RRETH FEMICIDIT</b> .....	<b>7</b>
<b>II. KORNIZA LIGJORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b> .....	<b>16</b>
1. Instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë.....	16
2. Korniza ligjore e brendshme .....	20
3. Korniza ligjore përkatëse lidhur me vrasjet dhe/ose vrasjet në tentativë .....	26
4. Korniza ligjore përkatëse lidhur me dhunën ndaj grave/dhunën në familje .....	29
<b>III. STATISTIKAT DHE TË DHËNAT E MBLEDHURA – DHUNA NË FAMILJE/FEMICIDI</b> .....	<b>35</b>
1. Statistikat dhe të dhënat e mbledhura në rastet e dhunës në familje dhe të vrasjes së grave .....	35
2. Të dhënat për Femicidet dhe Femicidet në Tentativë të trajtuara përgjatë 2018-2022 .....	41
<b>IV. RASTET STUDIMORE</b> .....	<b>43</b>
1. Femicidi I: kryesi P.N., viktimat V.N. dhe K.N. ....	43
1.1. Përshkrim i shkurtër i rastit .....	43
1.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit .....	44
1.3 Të dhënat për viktimën .....	45
1.4 Procedura penale.....	45
1.5 Sanksioni penal.....	49
2. Femicidi II: kryesi B.V., viktimat A.V.....	58
2.1 Përshkrim i shkurtër i rastit .....	58
2.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit .....	59
2.3 Të dhënat për viktimën .....	59
2.4 Procedura penale .....	60
2.5 Sanksioni penal .....	63

3. Femicidi III: kryesi S.Q., viktima L.Q.....	67
3.1 Përshkrim i shkurtër i rastit .....	67
3.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit .....	67
3.3 Të dhënat për viktimën.....	68
3.4 Procedura penale .....	68
3.5 Sanksioni penal .....	69
4. Femicidi IV: kryesi N.M., viktima S.M.....	72
4.1 Përshkrim i shkurtër i rastit .....	72
4.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit .....	73
4.3 Të dhënat për viktimën.....	73
4.4 Procedura penale.....	73
4.5 Sanksioni penal .....	75
<b>V. TË GJETURAT KRYESORE DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>78</b>
1. Të gjeturat kryesore .....	78
2. Rekomandime .....	83
<b>VI. REFERENCAT .....</b>	<b>86</b>

## » I. RRETH FEMICIDIT

*Romancierja kandaze Margaret Atwood e pyeti njëherë një mik se pse burrat ndjehen të kërcënuar nga gratë. Ai u përgjigj: "Ata frikësohen se gratë do të qeshin me ta". Pastaj ajo pyeti një grup grash se përse ato ndjehen të kërcënuara nga burrat. Ato u përgjigjën: "Frikësohemi se do të na vrasin".*

Ekstrakt nga artikulli "Femicidi: Terrorizmi seksist ndaj grave", nga Jane Caputi dhe Diana Russell<sup>[1]</sup>

Pjesa hyrëse e "Femicidi: Terrorizmi seksist ndaj grave", shpërfaq një realitet shqetësues në mënyrë të thjeshtë por mbresëlënëse. Përderisa burrat mund të ndihen të kërcënuar nga talljet e grave ndaj tyre – në anën tjetër të peshores së shtrembëruar – gratë kanë frikë se mos vriten nga burrat. Pabarazia gjinore, diskriminimi dhe besimi patriarkal se burrat janë superiorë dhe gratë inferiore, janë shkaqet themelore të dhunës ndaj grave dhe gjithashtu shkaqet kryesore të formës më ekstreme të një dhune të tillë: Femicidit. Burrat gjithmonë kanë përdorur dhunën për të kontrolluar gratë, përkatësisht për të ruajtur statusin që gjinore, pra dominimin e burrave ndaj grave.<sup>[2]</sup> Edhe pse janë bërë arritje të rëndësishme që nga koha kur bashkëshortet në masë të madhe konsideroheshin pronë e burrit, është një realitet i trishtë që patriarkati dhe mizogjia janë ende të rrënjosura thellë në kulturat tona dhe vazhdojnë të shërbejnë si motiv për dhunën ndaj grave dhe vrasjen e tyre anembanë botës.

Termi "femicid" ka shumë përkufizime, por bazuar në përkufizimin e përdorur më së shpeshti, në thelb reflekton "vrasjen e grave për shkak të gjinisë së tyre". Fjala "femicid" fillimisht ishte zgjedhur për të rritur vetëdijesimin kundër fenomenit të vrasjeve të grave për shkak të gjinisë, ashpërsia dhe përmasat e të cilave ishin më pak të dukshme nën termin neutral ndaj gjinisë "vrasje". Për shembull, Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), përdor përkufizimin "Vrasje e qëllimshme lidhur me gjininë që mund të motivohet nga rolet stereotipike gjinore, diskriminimi ndaj grave dhe

[1] Jill Radford, Diana E.H. Russell, *Femicide - The Politics of Woman Killing*, Twayne Publishers, New York, 1992., e disponueshme në: [https://www.dianarussell.com/f/femicide\(small\).pdf](https://www.dianarussell.com/f/femicide(small).pdf).

[2] Ibid., f. 14-15.

vajzave, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave ose nga norma të dëmshme shoqërore.”<sup>[3]</sup> Përderisa Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, në Rekomandimin e tij të Përgjithshëm Nr. 19, e ka përkufizuar dhunën ndaj grave me bazë gjinore si “dhunë që drejtohet ndaj një gruaje sepse ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë joproporcionale”<sup>[4]</sup>, që gjithashtu përfshin femicidin. Më tej dhe sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, “*motivimi i lidhur me gjininë*” tregon shkaqet themelore të femicidit, si “*rolet stereotipike gjinore, diskriminimi ndaj grave dhe vajzave, pabarazia dhe marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave në shoqëri – që karakterizojnë kontekstin specifik në të cilin ndodhin vrasje të tilla. Këta faktorë mund të nxisin dhunën nga dhunuesit kur sjellja e një gruaje perceptohet se nuk është në përputhje me normat shoqërore ose me rolet stereotipike gjinore. Në këtë kontekst, termi “motivimi i lidhur me gjininë” nuk i referohet qëllimit subjektiv të autorit për të kryer vrasjen, por shkaqeve rrënjësore të tij. Motivimi subjektiv i autorit për të kryer krimin – siç është një paragjykim specifik ose urrejtja ndaj grave – mund të jetë i pranishëm në disa raste krahas “motivimit të lidhur me gjininë”.*<sup>[5]</sup>

Në anën tjetër, Diana Russell, një nga pionieret e lëvizjes për njohjen dhe luftimin e këtij fenomeni, e përshkroi femicidin si “vrasje e grave nga burrat për shkak se janë gra”.<sup>[6]</sup> Në antologjinë seminale ‘Femicidi – Politika e Vrasjes së Gruas’ botuar në vitin 1992, znj. Russell theksoi se ekzistonte nevoja urgjente për përdorimin e termit “femicid”, si formë alternative e termit neutral ndaj gjinisë “vrasje”, pasi që kjo përbënte një hap të rëndësishëm për ta bërë të njohur si fenomen, gjë që pastaj hap rrugën për ngritjen e lëvizjes kundër tij.<sup>[7]</sup> Në përshkrimin e qëllimit të antologjisë revolucionare, Jill Radford dhe Diana Russell, mes tjerash, theksojnë se “ndërsa koncepti i femicidit është i ri, fenomeni që përshkruan është po aq i vjetër

[3] UN Women, *Pesë fakte esenciale që duhet ditur për femicidin*, 22 nëntor 2023, e disponueshme në: <https://www.unwomen.org/en/news-stories/feature-story/2022/11/five-essential-facts-to-know-about-femicide>.

[4] Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), *Rekomandimet e Përgjithshme të CEDAW Nr. 19, miratuar në sesionin e njëmbëdhjetë, (gjendet në Dokumentin A/47/38)*, 1992, e disponueshme në: <https://www.refworld.org/docid/453882a422.html>.

[5] UNODC, UN Women, *Korniza statistikore për matjen e vrasjeve të grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (e referuar edhe si “femicid/feminicid”)*, f. 3., e disponueshme në: [https://www.unodc.org/documents/data-and\\_analysis/statistics/Statistical\\_frameëork\\_femicide\\_2022.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and_analysis/statistics/Statistical_frameëork_femicide_2022.pdf).

[6] Radford, Russell, supra note 1, f. xiv.

[7] Ibid., f. xiv.



sa vetë patriarkalizmi”.<sup>[8]</sup> Dy nga shumë përshkrimet e rëndësishme të femicidit në antologjinë e tyre pasqyrohen në vijim:

*“Ashtu si përdhunimi, shumica e vrasjeve të grave nga burrat, dashnorët, baballarët, të njohur dhe të panjohur, nuk janë produkt i ndonjë devijimi të pashpjegueshëm. Ato janë Femicide, forma më ekstreme e terrorizmit seksist, të motivuar nga urrejtja, përbuzja, kënaqësia ose ndjenja e pronësisë ndaj grave. Femicidi përfshin vrasjen përmes gjymtimit, vrasjen e përdhunimit, rrahje që përshkallëzon në vrasje, djegien e shtrigave në Evropën Perëndimore dhe të nuseve dhe të vejave në Indi dhe “krimet e nderit”...”<sup>[9]</sup>*

*“Femicidi është në skajin ekstrem të një vazhdimësie të terrorit anti-grua që përfshin një shumëllojshmëri të gjerë abuzimesh verbale dhe fizike, të tilla si përdhunimi, tortura, skllavëria seksuale (veçanërisht në prostitucion), keqtrajtimi seksual i fëmijëve në incest dhe jashtë-familjar, lëndimi fizik dhe emocional, ngacmimi seksual (në telefon, në rrugë, në zyrë dhe në klasë), gjymtimi i organeve gjinitale (klitoridektomi, ekscision, infibulacione), operacione të panevojshme gjinekologjike (histerektomitë e panevojshme), heteroseksualiteti i detyruar, sterilizimi i detyruar, amësia e detyruar (duke kriminalizuar kontracepsionin dhe abortin), psikokirurgjia, mohimi i ushqimit për gratë në disa kultura, kirurgjia kozmetike dhe gjymtime të tjera në emër të zbulimit. Sa herë që këto forma të terrorizmit rezultojnë me vdekje, ato bëhen femicide.”<sup>[10]</sup>*

Sipas literaturës ekzistuese, ekzistojnë edhe disa forma të femicidit: (i) femicidi martesor ose intim; (ii) vrasja e foshnjave; (iii) femicidi racist; (iv) femicidi masiv; (v) femicidet për shkak të operacioneve kirurgjike të panevojshme, të tilla si histerektomitë dhe klitorektomitë; (vi) femicidet homofobike; (vii) femicidet serike; dhe (viii) vdekjet nga neglizhenca dhe uria në kulturat që preferojnë dhe kujdesen më shumë për djemtë.<sup>[11]</sup> Disa autorë janë përpjekur të mohojnë ekzistencën e femicidit, ndër të tjera, përmes (i) procesit të individualizimit, ku femicidet ishin parë si incidente të izoluar nga psikopatët dhe sociopatët, në vend që të shiheshin si një shprehje e përsëritur e dhunës seksuale mashkullore;

[8] Ibid., f. 25.

[9] Ibid., f. 15.

[10] Ibid., f. 15.

[11] Ibid., f. 7.

si dhe përmes (ii) procesit të fajësimit të viktimës, ku stili i jetës, veshja, sjellja dhe personaliteti i viktimës i nënshtroheshin një shqyrtimi të rreptë nga, duke përfshirë por pa u kufizuar në, gjyqësorin dhe mediet.<sup>[12]</sup>

Që nga përdorimi i parë i termit femicid, është bërë shumë punë për të rritur vetëdijësimin për këtë fenomen nga aktivistët, OShC-të, organizatat ndërkombëtare dhe nga një numër qeverish. Raportet tematike të Raportuesit Special të OKB-së për Dhunën ndaj Grave, janë ndër më të rëndësishmet. Raportuesi Special i OKB-së për Dhunën ndaj Grave, shkaqet dhe pasojat e saj, në Këshillin Akademik për Sistemin e Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera, vëren si më poshtë:

*"Koncepti i vrasjeve me motive gjinore të grave dhe të vajzave lidhet me ekzistencën e një sistemi të diskriminimit strukturor ndaj grave".*

- » *Megjithatë, për t'i dhënë fund kësaj praktike, është e nevojshme të adoptohet një qasje holistike, duke përfshirë masa ligjore, administrative, politike dhe të tjera për të adresuar faktorët socialë politikë, ekonomikë, kulturorë dhe faktorë të tjerë që e vazhdojnë diskriminimin dhe dhunën.*
- » *Kjo qasje përfshin gjithashtu veprimet e mëposhtme:*
  - » *Promovimi i një transformimi social, duke përfshirë çrrënjosjen e stereotipeve të dëmshme;*
  - » *Zhvillimi i sistemeve të informacionit dhe të dhëna të cilësisë së mirë për vrasjet me motive gjinore;*
  - » *Sigurimi i zbatimit të duhur nga policia dhe gjyqësori të masave parandaluese si lëshimi i urdhrave mbrojtës ose të ndalimit dhe të sanksioneve penale*
  - » *sigurimi i ofrimit adekuat të shërbimeve për gratë viktime të dhunës.*<sup>[13]</sup>

[12] Ibid., f. 352.

[13] Deklaratë nga dr. Dubravka Shimonović, Raportuese Speciale e OKB-së për Dhunën kundër Grave, shkaqet dhe pasojat e saj, në Këshillin Akademik për Sistemin e Kombeve të Bashkuara (ACUNS), Zyra Ndërlidhëse e Vjenës, *Femicidi, Vëllimi V – Një çështje globale që kërkon veprim*, (e disponueshme në: <https://femicide-watch.org/node/920608>), 2016, f. 6.

Më tej dhe sipas kornizës së përgatitur nga UNODC dhe UN Women, vrasja e grave dhe vajzave e lidhur me gjininë (femicidi/femicidit), përfshin karakteristikat vijuese: (i) vrasja e një gruaje nga një person tjetër (kriteri objektiv); (ii) qëllimi i kryerësit për të vrarë ose për të lënduar rëndë viktimën (kriteri subjektiv); (iii) paligjshmëria e vrasjes (kriteri ligjor); dhe (iv) motivimi i lidhur me gjininë i vrasjes.<sup>[14]</sup> Përveç kësaj, sipas kornizës përkatëse “...motivimi i lidhur me gjininë është ai që identifikon në mënyrë specifike vrasjet e grave dhe vajzave lidhur me gjininë. Në terma të përgjithshëm, kjo lidhet me vrasjet e kryera mbi bazën e “faktorëve të lidhur me gjininë, si ideologjia e së drejtës dhe privilegjit të burrave ndaj grave, normat sociale në lidhje me maskulinitetin dhe nevojën për të theksuar kontrollin ose pushtetin mashkullor, për të zbatuar rolet gjinore ose për të parandaluar, dekurajuar ose ndëshkuar atë që konsiderohet si sjellje e papranueshme femërore.”<sup>[15]</sup> Sipas të njëjtit raport, marrëdhënia specifike ose lloji i kryesit, jo gjithmonë përcakton në parim vrasjen e lidhur me gjininë, por më tepër e përcakton fakti që një ose më shumë motive të lidhura me gjininë kanë shkaktuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi vrasjen e grave ose vajzave.<sup>[16]</sup>

Për sa i përket masave të mundshme parandaluese, Caren D. Stout, kreu një studim mbi femicidin intim dhe lidhjen e tij me nivelin e shërbimeve të ofruara për viktimat dhe ekzistencën e legjislacionit të lidhur me dhunën në familje në Shtetet e Bashkuara. Sipas studimit, ndër të tjera, u arrit në përfundimin se (i) shtetet që ofronin një numër më të madh shërbimesh si strehimore për gratë e lënduara ose shërbime në krizë përdhunimi, kishin një shkallë më të ulët të femicideve intime; dhe se (ii) shtetet që kishin legjislacione individuale për dhunën në familje, kishin një mesatare më të ulët të grave të vrara, krahasuar me mesataren e shteteve që nuk kishin legjislacion të tillë.<sup>[17]</sup> Prandaj, sipas dëshmive empirike të ofruara nga znj. Stout, (i) ekziston “një lidhje negative midis krizës së përdhunimit dhe shërbimeve të strehimit në një shtet dhe shkallës së femicideve intime në një shtet”; si dhe (ii) “shtetet që kishin miratuar legjislacionin për nxjerrjen e masave të sigurisë kishin mesatarisht më pak gra të vrara... shtetet që kishin miratuar forma të tjera të legjislacionit përkitazi me dhunën në familje (financim për strehimore, masa të përkohshme të sigurisë, arrestim pa urdhërarrest të bazuar në shkaqe të mundshme, dhe raportim dhe mbledhje e nevojshme e të dhënave për dhunën në familje) kishin një numër mesatar më të ulët të grave të vrara nga partnerët meshkuj, sesa shtetet që nuk kishin një legjislacion të tillë...”.<sup>[18]</sup>

[14] UNODC, UN Women, supra note 5, f. 7.

[15] Ibid., f. 7.

[16] Ibid., f. 7.

[17] Radford, Russell, supra note 1, f. 136, 138.

[18] Radford, Russell, supra note 1, f. 138, 139.

Nga ana tjetër, nga pikëpamja sociologjike, pesë qasje janë përdorur nga studiuesit në studimin e femicidit që nga botimi i antologjisë seminale nga Radford dhe Russell dhe punimi me autor Stout në vitin 1992.<sup>[19]</sup>

- 1) qasja feministe, përmes të cilës konfrontohet dominimi patriarkal në të njëjtën kohë teksa hetohet vrasja e grave. Baza e kësaj qasjeje është patriarkalizmi si nocion, një shoqëri e dominuar nga burrat e cila është shtypëse dhe vdekjeprurëse për gratë, përkatësisht "*parimi themelor i patriarkatit është pushteti; ku pushteti shpërndahet në mënyrë të pabarabartë midis burrave dhe grave, dhuna është mjete që burrat përdorin për të mbajtur gratë nën kontrollin e tyre*". Ndër të tjera, për shkak të mungesës së të dhënave të disponueshme, ka vështirësi në kapjen e motivimit mizogjinist, pra vrasjen e një gruaje për shkak se ajo është grua, e cila sipas literaturës konsiderohet si dobësi e qasjes feministe;
- 2) qasja sociologjike, përmes të cilës hetohen situatat dhe kontekstet që formësojnë aktet e individëve të dhunshëm. Baza e kësaj qasjeje është fakti se vrasja e grave dhe burrave ndodh në rrethana të ndryshme nga kryes të ndryshëm, përkatësisht "*fakti që një numër i lartë i grave vriten nga partnerët e tyre intimë, ose në një mjedis familjar, përderisa një numër i lartë i burrave vriten në një mjedis jointim ose familjar, e bën femicidin një fenomen shoqëror per se*";
- 3) qasja kriminologjike, sipas të cilës, një grup autorësh e zbatojnë termin femicid gjerësisht për të nënkuptuar vrasjen e një gruaje, ndërsa një grup tjetër i referohet '*vrases së partnerit intim*' si një nëngrup i veçantë i studimeve të vrasjeve. Në këtë qasje, studiuesit studiojnë detajet e rasteve, duke përfshirë moshën, racën dhe nivelin e barazisë gjinore, si dhe fokusohen në marrëdhënien e viktimës me kryesin;
- 4) qasja e të drejtave të njeriut, përmes të cilës, femicidi përshkruhet nga Këshilli Akademik i Sistemit të Kombeve të Bashkuara (ACUNS) dhe organizata të tjera, si një fenomen i gjerë që përfshin "*vrases, si dhe torturën, vrases e nderit, vrases e lidhur me pajën, vrases e foshnjave dhe seleksionimin me bazë gjinore para lindjes, gjymtimin gjeneral dhe trafikimin e qenieve njerëzore*"; dhe

[19] Consuelo Corradi, Chaime Marcuello-Servos, Santiago Boira, Shalva Weil, *Theories of femicide and their significance for social research*, Sage Publications, Vëllimi 64, 2016, f. 979.

- 5) qasja dekoloniale, përmes të cilës, femicidi shqyrtohet në kontekstin e dominimit kolonial, bazuar në idenë se *"diskursi i dominimit kolonial nga Perëndimi i ka kthyer disa praktika, si 'vrasjet e nderit', në një simbol të rezistencës ndaj kolonizatorëve"*.<sup>[20]</sup>

Pas shpjegimit të plotë të qasjeve ekzistuese të hulumtimit të femicidit, autorët propozuan një qasje multidisiplinare në shpjegimin e femicidit, pasi që është një fenomen kompleks shoqëror.<sup>[21]</sup> Megjithatë, cilido qoftë përkufizimi i përdorur për femicidin, fenomeni nuk mund të mohohet më, pasi është vërtetuar pafundësisht nga statistikat botërore dhe tashmë është një e vërtetë e pamohueshme. Në lidhje me këtë, sipas përmbledhjes hulumtuese globale të UNODC dhe UN Women mbi vrasjet e grave dhe vajzave lidhur me gjininë, në vitin 2022, u raportua, ndër të tjera, se (i) 89,000 gra dhe vajza u vranë qëllimisht në vitin 2022 në mbarë botën; nga të cilat (ii) 48,800 gra dhe vajza u vranë nga anëtarët e familjes ose nga partnerët e tyre intimë; (iii) shumica e vrasjeve të grave dhe vajzave ishin me motive gjinore; dhe (iv) çdo ditë, mesatarisht, më shumë se 133 gra ose vajza vriteshin nga dikush në familjen e tyre.<sup>[22]</sup> Hulumtimi vuri në dukje në parathënien e tij se *"me shqetësim dhe zemërim të thellë raportojmë se numri i grave dhe vajzave të vrara me dashje në vitin 2022 – afërsisht 89,000 – është numri më i lartë vjetor i regjistruar në 20 vitet e fundit."*<sup>[23]</sup>

Në përmbledhjen e UNODC dhe UN Women theksohet gjithashtu se, *"përderisa shumica e vrasjeve në mbarë botën kryhen ndaj burrave dhe djemve (80% në 2022), gratë dhe vajzat janë të prekura në mënyrë joproporcionale nga dhuna vrasëse në shtëpi: ato përfaqësojnë përafërsisht 53% të të gjitha viktimave të vrasjeve në shtëpi dhe 66% të të gjitha viktimave të vrasjeve nga partneri intim"*.<sup>[24]</sup> Sipas statistikave të paraqitura, për gratë dhe vajzat, vendi më i rrezikshëm është vetë shtëpia e tyre.<sup>[25]</sup> Numri i vrasjeve të grave dhe vajzave me motive gjinore mund të jetë edhe më i madh se sa ai i paraqitur, pasi që për katër (4) nga dhjetë (10) vrasje femrash në mbarë botën, nuk ka të dhëna kontekstuale për t'i klasifikuar ato si femicide.<sup>[26]</sup>

[20] Ibid., f. 979-982.

[21] Ibid., f. 988.

[22] UNODC, UN Women, *Vrasjet e grave dhe vajzave të lidhura me gjininë (femicide/femicicide), Vlerësimet globale të vrasjeve në lidhje me partnerin intim femër/familjen në vitin 2022*, f. 3, e disponueshme në: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2023-11/gender-related-killings-of-women-and-girls-femicide-femicicide-global-estimates-2022-en.pdf>.

[23] Ibid., f. 1.

[24] Ibid., f. 3.

[25] Ibid., f. 6.

[26] Ibid., f. 7.

Republika e Kosovës nuk bën përjashtim nga këto dukuri, siç është theksuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia Kombëtare). Sipas të dhënave në dispozicion, edhe pse jo plotësisht të besueshme për arsyet që do të shpjegohen më poshtë, gjatë periudhës 2018-2022, rezulton që në Kosovë mund të kenë ndodhur njëzet (20) femicide dhe katër (4) femicide në tentativë. Pothuajse në të gjitha këto raste, gratë u vranë nga burrat e tyre. Një grua dhe vajza e saj e mitur u vranë nga bashkëshorti/babai me pushkë automatike. Një grua shtatzënë në prag të lindjes, u vra nga bashkëshorti i saj në oborrin e spitalit, teksa ajo i përgjerohej për jetën e saj dhe për jetën e fëmijës së saj të palindur. Një mësuese u vra nga bashkëshorti i saj me sëpatë derisa ishte në gjumë. Një grua 18-vjeçare u torturua, u rrah dhe u përdhunua për dy ditë me radhë, dhe pasi pësoi plagë të rënda, në fund u vra nga partneri i saj 30-vjeçar, i cili u ndihmua nga shoku i tij. Historitë e mësipërme pasqyrojnë vetëm disa shembuj të vrasjeve me motive gjinore që kanë ndodhur së fundi në Republikën e Kosovës. Të njëjtat kanë ngjallur thirrje publike, kanë nxitur zemërim të thellë dhe protesta të shumta përgjatë viteve.

Më tej, si në të gjitha vendet e botës, pabarazia gjinore, diskriminimi, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave, janë të përhapura në shoqërinë kosovare, ku sipas "*Anketës për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*", të kryer nga OSBE, (i) 54% e të gjitha grave në Kosovë deklarojnë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga partneri që nga mosha pesëmbëdhjetë (15) vjeçare; ndërsa (ii) 29% deklarojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual.<sup>[27]</sup> Fatkeqësisht, "*gati gjysma e grave të anketuara (48%) besojnë se dhuna në familje është një çështje private që duhet mbajtur brenda familjes*".<sup>[28]</sup>

Ndërsa, siç do të shtjellohet më poshtë, përderisa saktësia e statistikave të disponueshme lë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim, të dhënat e disponueshme ndërmjet viteve 2018 dhe 2022, tregojnë një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të dhunës në familje. Në anën tjetër, përderisa femicidi si i tillë nuk cilësohet si vepër penale në legjislacionin e Kosovës, Kodi Penal ofron mekanizmin përmes të cilit një vrasje dhe/ose vrasje në tentativë mund të cilësohet si e motivuar në bazë gjinore. Megjithatë, përderisa rastet studimore të disponueshme tregojnë se gjykatat e kanë zhvilluar në kohë të arsyeshme

[27] Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë, *Anketa për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*, 2019, f. 8, e disponueshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/439781.pdf>.

[28] Ibid., f. 9.

procedurën dhe dënimet për autorët janë të konsiderueshme, asnjë nga aktgjykimet e gjykatave të rregullta, nuk i ka cilësuar vrasjet respektive dhe/ose vrasjet në tentativë si të motivuara në bazë të gjinisë, përkundër faktit se rrethanat e rasteve në fjalë, qartazi bien nën përkufizimet përgjithësisht të pranuar femicidit.

Me qëllim të shtjellimit të trendeve dhe/ose sfidave të lartpërmendura, në vijim, raporti do të fillojë me shtjellimin e kornizës ligjore në Republikën e Kosovës, duke përfshirë (i) instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme; (ii) kornizën ligjore vendore; dhe (iii) kornizën ligjore që ndërlidhet në mënyrë specifike me dhunën ndaj grave dhe me dhunën në familje. Në vazhdim, raporti do të fokusohet në (i) statistikat e disponueshme dhe të dhënat e mbledhura në rastet e dhunës në familje; dhe (ii) statistikat dhe të dhënat e mbledhura në rastet e femicideve dhe/ose femicideve në tentativë. Më pas, raporti do të paraqesë katër (4) raste studimore të pasqyruara nga të vetmet vendime gjyqësore të formës së prerë të disponueshme në këtë drejtim, dhe në fund do të përmbillet me disa vështrime dhe rekomandime përkatëse.<sup>[29]</sup>

[29] Rastet e zgjedhura për t'u analizuar për qëllime të këtij raporti janë vetëm ato që ndërlidhen me vendimet gjyqësore të formës së prerë që kanë të bëjnë me vrasjen e grave nga kryesit përkatës të veprave penale dhe rrethanat e të cilave bien nën përkufizimet e pranuar përgjithësisht të femicidit. Forma e prerë e aktgjyqimeve do të thotë se afatet për mjete juridike të mëtejme, përfshirë edhe kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, kanë kaluar. Sigurisht që ka një sërë rastesh aktualisht në gjykim e sipër në nivel të gjykatave themelore ose që janë duke iu nënshtruar procedurave të ankesës, duke përfshirë një në Gjykatën Kushtetuese. Për shkak të procedurave gjyqësore në vazhdim e sipër, këto raste nuk janë përfshirë në këtë analizë.

## » II. KORNIZA LIGJORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

### 1. Instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë

Fillimisht, janë nëntë (9) instrumente ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe që kanë përparësi, në rast konflikti, ndaj ligjit vendor dhe akteve të tjera. Sipas nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara nga këto instrumente garantojnë me Kushtetutë dhe përfshijnë si në vijim:

- i) Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut;
- ii) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- iii) Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- iv) Konventën Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- v) Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- vi) Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- vii) Konventën për të Drejtat e Fëmijës;
- viii) Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëuese; dhe
- ix) Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.<sup>[30]</sup>

Përveç kësaj dhe për aq sa është relevante për këtë raport, duhet theksuar se sipas Kushtetutës (i) të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë baza e rendit juridik në Republikën e Kosovës; (ii) Republika siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabarta si për

[30] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe Amendamenti nr. 26, e disponueshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.



burrat ashtu edhe për gratë; (iii) të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; dhe (iv) askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.<sup>[31]</sup> Për më tepër, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës, përcakton që të gjitha institucionet publike janë të detyruara të interpretojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ).

Me përjashtim të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), e cila është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë që nga miratimi i Amendamentit nr. 26 të Kushtetutës, më 25 shtator 2020, të gjitha instrumentet e tjera ndërkombëtare të renditura në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, janë drejtpërdrejtë të zbatueshme që nga viti 2001, kur ishte miratuar dhe ishte e zbatueshme Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, gjatë administrimit të përkohshëm ndërkombëtar të Kosovës.<sup>[32]</sup>

Megjithatë, meqenëse Kosova ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe, për rrjedhojë, nuk është palë nënshkruese e instrumenteve të lartpërmendura ndërkombëtare, ndërkohë që shumica prej tyre kanë qenë të zbatueshme drejtpërdrejtë për më shumë se dy dekada, Republika e Kosovës nuk përfiton drejtpërdrejtë nga mekanizmat monitorues përkatës që lidhen me instrumentet ndërkombëtare të lartpërmendura. Kësisoj, për shembull, Kosova nuk dorëzon apo merr raporte të rregullta siç bëjnë shtetet e tjera nënshkruese nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

Megjithatë, në lidhje me Konventën e Stambollit, në vitin 2022, Sekretariati i GREVIO-s publikoi "*Vlerësimin e përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)*".<sup>[33]</sup> Ky

[31] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 7 [Vlerat] dhe 21 [Parimet e Përgjithshme].

[32] Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kapitulli 3 (Të Drejtat e Njeriut), e disponueshme në: [http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket\\_ENG\\_Dec2002.pdf](http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ENG_Dec2002.pdf).

[33] Virginia Gil Portoles, Eileen Skinnider, Valentine Josenhans, *Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për*

Vlerësim është publikuar si pjesë e projektit "*Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje Faza III*" (në tekstin e mëtejshëm: Raporti i Vlerësimit i GREVIO-s) dhe megjithëse thekson se opinionet e shprehura në të janë përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën zyrtare të Këshillit të Evropës, Vlerësimi zbaton metodologjinë e GREVIO-s dhe bazohet në informacionin e ofruar nga autoritetet publike dhe shoqëria civile në Republikën e Kosovës. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm/informativ në vlerësimin e zbatimit të Konventës së Stambollit.<sup>[34]</sup>

Raporti i Vlerësimit i GREVIO-s vuri në dukje, ndër të tjera, zhvillime pozitive dhe theksoi se Kosova "*ka bërë përpjekje të lavdërueshme për të hartuar ligje dhe politika gjithëpërfshirëse për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*"<sup>[35]</sup>. Megjithatë, sipas Raportit të Vlerësimit, Kosova duhet të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me Konventën e Stambollit. Për të ilustruar pozicionin e të drejtës së brendshme të Kosovës për aq sa është relevante për këtë raport, në vijim janë disa nga rekomandimet e dhëna nga Raporti i Vlerësimit: (i) autoritetet duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të harmonizuar të gjitha përkufizimet ligjore dhe të politikave të dhunës ndaj grave dhe të dhunës në familje bazuar në përkufizimet e përcaktuara në Konventën e Stambollit dhe të sigurojnë implementimin efektiv të tyre; (ii) autoritetet duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të zbatuar ligje, politika dhe mekanizma gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara për arritjen e barazisë gjinore, teksa ndërmarrin veprime të mëtejshme për të korrigjuar zbrazëtirat ekzistuese në qasjen e grave në të drejtat e tyre socio-ekonomike dhe për të matur progresin e tyre, si p.sh. pasuria, trashëgimia dhe ushqimia; (iii) autoritetet duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të integruar reagimin e ndjeshëm gjinor ndaj dhunës ndaj grave në të gjitha politikat përkatëse nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të udhëzimeve përkatëse për institucionet publike; (iv) autoritetet duhet të institucionalizojnë plotësisht Zyrën e Koordinatorës Kombëtare kundër Dhunës në Familje, duke ndarë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për punën e saj; (v) autoritetet duhet të zgjerojnë fushëveprimin e të dhënave të mbledhura nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori për të mbuluar të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe për të siguruar që këto të dhëna të ndahen sipas gjinisë, moshës dhe marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe kryesit të dhunës; (vi) të sigurojnë fushën e të dhënave të mbledhura nga shërbimet sociale dhe strehimoret për të siguruar që ato adresojnë

---

*Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)*, 2022, e disponueshme në: [\\*1680a9203e \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/kosovo/ta/1680a9203e).

[34] Ibid., f. 7.

[35] Ibid.

të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit, të cilat janë të ndara sipas gjinisë, moshës dhe marrëdhënies së kryesit të dhunës me viktimën, si dhe kategori të tjera përkatëse siç është statusi i aftësisë së kufizuar; (vii) të kryejë anketa të rregullta të përhapjes për të gjitha format e dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa e Stambollit; (viii) të shtohen përpjekjet për të mbështetur hulumtimin mbi manifestimet e dhunës ndaj grave që mbeten të paeksploruara dhe të vazhdojnë vlerësimin e legjislacionit ekzistues dhe zbatimit të tyre; (ix) të nxisin masat që synojnë zhdukjen e stereotipeve, paragjykimeve dhe të gjitha praktikave të bazuara në idenë e inferioritetit të grave ndaj burrave, të cilat kontribuojnë në arsyetimin dhe shfaqjen e dhunës ndaj grave; (x) të diversifikojnë dhe të mbështesin më tej përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për të trajtuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit; (xi) të përfshijë materiale mësimore mbi barazinë mes grave dhe burrave, të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave, rolet gjinore jostereotipike, respektin e ndërsjellë etj., si dhe të sigurojnë trajnime sistematike dhe të detyrueshme për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të dhunës ndaj grave; (xii) të zgjerojnë numrin e strehimoreve dhe të sigurojë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm; (xiii) të adresojnë çdo pengesë në përdorimin e masave të së drejtës civile në dispozicion për t'i mbajtur autoritetet publike përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimit për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar me përkushtim aktet e dhunës, për të mbrojtur viktimat dhe për të siguruar sigurimin e informacionit adekuat për viktimat; (xiv) të lehtësojnë dhe garantojnë qasjen në kompensim për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave; (xv) të marrin masa për të hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar në mënyrë efektive aktet e dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale; (xvi) të përmirësojnë kapacitetin dhe njohuritë e të gjithë zyrtarëve të zbatimit të ligjit në lidhje me ndërtimin e rasteve të qëndrueshme; dhe (xvii) të sigurojnë që viktimat e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit të kenë qasje *de jure* dhe *de facto* në ndihmë juridike në një fazë të hershme të procedurës.<sup>[36]</sup>

Siç është ilustruar nga rekomandimet e listuara më lart, shumica e të cilave janë klasifikuar si urgjente nga Raporti i Vlerësimit i GREVIO-s, Kosova duhet të fuqizojë përpjekjet e saj në mënyrë që të harmonizojë plotësisht të drejtën e brendshme me Konventën e Stambollit dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë. Megjithatë, siç do të shtjellohet më poshtë, ndërkohë që ka vend për përmirësim në aspektin e cilësisë së legjislacionit, sfida kryesore mbetet zbatimi i kornizës ligjore ekzistuese dhe standardeve ndërkombëtare të aplikueshme.

[36] Ibid., f. 88-100.

## 2. Korniza ligjore e brendshme

Si shumë vende të botës, edhe Republika e Kosovës është e afektuar nga shfaqja e dhunës në familje, e dhunës me bazë gjinore dhe femicidit, krime të cilat jo gjithmonë hetohen dhe ndëshkohen siç duhet dhe, në disa raste, reflektojnë krime të cilat do të mund të parandaloheshin sikur autoritetet shtetërore përgjegjëse të kishin vepruar me shpejtësi dhe përkushtimin e duhur.

*Një aktgjykim i kohës së fundit i Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht Aktgjykimi K1129/21, vuri në dukje këtë fenomen, duke theksuar, ndër të tjera, se autoritetet përkatëse shtetërore, në radhë të parë Prokuroria e Shtetit dhe Policia, kishin dështuar të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të parandaluar vdekjen e nënës së parashtrueses.<sup>[37]</sup>*

Termi "*femicid*" nuk gjen përdorim në kornizën ligjore të Kosovës, përkatësisht nuk përdoret si vepër penale e pavarur apo e veçantë. Megjithatë, që nga miratimi i Kodit të ri Penal në vitin 2019, përkatësisht Kodit nr.06/L-074 Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi Penal i vitit 2019)<sup>[38]</sup>, (i) një vrasje kualifikohet si vrasje e rëndë nëse, ndër të tjera, është konstatuar se vrasja ka qenë e motivuar në bazë të gjinisë dhe nëse vepra penale e lëndimit të rëndë trupor konstatohet se ka qenë e motivuar në bazë të gjinisë, ndër të tjera, është paraparë dënim më i ashpër për kryesin; dhe (ii) "*dhuna në familje*" parashikohet gjithashtu si vepër penale e veçantë dhe e pavarur. Kjo ndryshon nga Kodi i mëparshëm Penal, përkatësisht Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi Penal i vitit 2012)<sup>[39]</sup>, i cili nuk parashikonte gjininë dhe/ose identitetin gjinor si një nga bazat mbi të cilat një vrasje mund të cilësohej si e rëndë dhe nuk parashikonte dhunën në familje si vepër penale të pavarur dhe/ose vepër penale të veçantë.

[37] Rasti K1129/21, parashtrues V.S., Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 7 mars 2023, e disponueshme në: <https://gjk-ks.org/en/decision/leresim-i-kushtetutshmerise-se-veprimeve-dhe-mosveprimeve-te-gjykatës-themelore-ne-gjilan-prokurorisë-themelore-ne-gjilan-stacionit-policor-ne-gracanice-dhe-prokurorisë-themelore-n/>

[38] Kodi nr.06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/2019, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=435>.

[39] Kodi nr.04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/2012, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=147>.

Thënë këtë, dhe përderisa "*femicidi*" si term i pavarur nuk përdoret në mënyrë specifike në legjislacionin në fuqi, korniza ligjore në Kosovë, e cila në thelb është e zbatueshme në rastet që hyjnë në kategorinë e përkufizimit të pranuar përgjithësisht të femicidit dhe dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshinë por nuk kufizohet në sa vijon:

- i) Kodin Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074;<sup>[40]</sup>
- ii) Ligjin nr.08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës;<sup>[41]</sup>
- iii) Kodin nr.08/L-032 të Procedurës Penale;<sup>[42]</sup>
- iv) Ligjin nr.08/L-187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr.08/L-032;<sup>[43]</sup>
- v) Ligjin nr.03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (i shfuqizuar në tetor 2023 me miratimin e Ligjit të ri);<sup>[44]</sup>
- vi) Ligjin nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore;<sup>[45]</sup>
- vii) Ligjin nr.05/L -003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës;<sup>[46]</sup>
- viii) Ligjin nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore;<sup>[47]</sup>

[40] Kodi nr.06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, supra note 38.

[41] Ligji nr.08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 23/2023, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=551>.

[42] Kodi nr.08/L-032 Kodi i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 24/2022, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=507>.

[43] Ligjin nr.08/L-187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr.08/L-032, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 23/2023, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=551>.

[44] Ligji nr.03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 76/2010, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=82>.

[45] Ligji nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22/2023, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=550>.

[46] Ligji nr.05/L -003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12/2015, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=295>.

[47] Ligji nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/2015, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=299>.

- ix) Ligjin nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi;<sup>[48]</sup>
- x) Ligjin nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit (i shfuqizuar në nëntor 2022 me miratimin e ligjit të ri);<sup>[49]</sup>
- xi) Ligjin nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit;<sup>[50]</sup>
- xii) Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhmë Viktimave (Prokuroria);<sup>[51]</sup>
- xiii) Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (Agjencia për Barazinë Gjinore);<sup>[52]</sup> dhe
- xiv) Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë.<sup>[53]</sup>

Në dritën e sa më sipër, fillimisht duhet theksuar se Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për Kompensimin e Viktimave i vitit 2015), është zëvendësuar me Ligjin nr. 08/L-109 për Kompensimin e viktimave të Krimit më 2 nëntor 2022 (në tekstin e mëtejme: Ligji për Kompensimin e Viktimave i vitit 2022).

Për më tepër, fundi i vitit 2023 rezultoi në ndryshime të rëndësishme në legjislacionin në fuqi që janë relevante për rastet e femicidit dhe/ose femicidit në tentativë. Së pari, në tetor 2023, Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje është zëvendësuar me ligjin e ri në këtë drejtim, përkatësisht Ligjin nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave

[48] Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/2015, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=299>.

[49] Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/2015, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=300>.

[50] Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 33/2022, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/OfficialGazetteDetail.aspx?GZID=516>.

[51] Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhmë Viktimave, të nxjerra nga Prokurori i Shtetit në vitin 2013, i disponueshëm në: [ZMNV\\_28022014.pdf \(prokuroria-rks.org\)](https://www.zmnv.org/prokuroria-rks.org).

[52] Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, të nxjerra nga Agjencia për Barazinë Gjinore, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, në vitin 2013, të disponueshme në: [Agjencia Për Barazi Gjinore \(rks-gov.net\)](https://www.rks.gov.net).

[53] Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë, i nxjerrë nga Qeveria e Kosovës në vitin 2022, i disponueshëm në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8C3ACF03-4387-453D-942A-AC5B38B00838.pdf>.

dhe Dhuna në Bazë Gjinore. Ndërsa së dyti, në nëntor 2023, u bënë dy ndryshime të rëndësishme që kanë të bëjnë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, përkatësisht (i) Ligji nr.08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr.06/L-074 i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kodi Penal i vitit 2023); dhe (ii) Ligji nr. 08/L -187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 08/L-032 (në tekstin e mëtejshëm: Kodi i Procedurës Penale i vitit 2023), u miratuan nga Kuvendi i Kosovës. Të dy këto ndryshime që kanë të bëjnë me legjislacionin penal, janë të rëndësishme për sa i përket përparimeve në fushën e dhunës në familje dhe/ose dhunës me bazë gjinore.

Më konkretisht, Kodi Penal i vitit 2019,<sup>[54]</sup> u ndryshua, ndër të tjera, (i) për të ofruar dhe zgjeruar përkufizimin e veprave penale, përfshirë në fushën e dhunës në familje dhe/ose dhunës me bazë gjinore; dhe (ii) për të parashikuar dënime përkatëse më të ashpra. Ndryshimet më të rëndësishme mund të përmbliken në gjashtë (6) kategoritë si në vijim:

Së pari, ligji i ri që ndryshon Kodin Penal të vitit 2019, e plotëson dënimin plotësues të parashikuar me nenin 59 (Dënimet plotësuese) të Kodit Penal të lartpërmendur, për veprat penale të dhunimit dhe/ose dhunës në familje, duke përfshirë (i) ndalimin e blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, asetëve publike ose licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vite; dhe (ii) ndalimin e aplikimit si investitor strategjik dhe çdo formë tjetër të përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislacioni në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vite.

Së dyti, neni 60 (Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur) i Kodit Penal të vitit 2019, është ndryshuar gjithashtu në mënyrë specifike për të zgjeruar dënimin me heqje të së drejtës për t'u zgjedhur, në rrethanat e shpalljes fajtor për veprën penale të dhunimit dhe/ose dhunës në familje, përkatësisht për t'u dhënë kompetencën gjykatave të ndalojnë të drejtën për kandidim për çdo pozitë publike nga tre (3) deri në dhjetë (10) vite personit që shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje.

Së treti, ligji i ri për ndryshimin e Kodit Penal të viti 2019, zgjeron fushëveprimin e nenit 62 (Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik) të Kodit të lartpërmendur, duke i dhënë kompetencë gjykatave për t'i ndaluar (i) punësimin në sektorin publik në të gjitha nivelet, nga një (1) deri

[54] Ligji nr. 08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr. 06/L-074 të Republikës së Kosovës, supra note 41.

në pesë (5) vite, personit që shpallet fajtor për veprën penale të dhunimit; dhe (ii) të drejtën për të drejtuar automjet në çdo lloj të kategorisë, nga një (1) deri në pesë (5) vite, për personin që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit në kohën kur ai/ajo ushtronte profesionin e vozitësit.

Së katërti, neni 183 (Ngacmimi Seksual) i Kodit Penal të vitit 2019, plotësohet dhe zgjerohet, në dy aspekte parësore. Rrit dënimin (i) nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vite burgim, në një (1) deri në pesë (5) vite burgim, në rastet kur vepra penale e ngacmimit seksual kryhet nga kryesi i cili është mësues, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja ose kujdesi i personit të tillë apo në ndonjë mënyrë tjetër ka pozitë të autoritetit mbi atë person; dhe (ii) nga një (1) deri në pesë (5) vite burgim, në pesë (5) deri në dhjetë (10) vite burgim, kur vepra përkatëse penale kryhet me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose me send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit mendor apo fizik. Më e rëndësishmja, në të parashikohet konkretisht se kushdo që ngacmon seksualisht një person nën moshën dhjetë (10) vjeçare ose një person të cenusëshëm nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, dënohet me burgim prej tre (3) deri në tetë (8) vite dhe se kryesit të veprës së tillë ndaj fëmijës, gjykata ia ndalon ushtrimin e profesionit apo veprimtarisë që lidhet me punën me fëmijë.

Së pesti, ligji i ri për ndryshimin e Kodit Penal të vitit 2019, parashikon veprën e re penale të testimi të virgjërisë, duke kriminalizuar (i) cytjen dhe obligimin e një personi tjetër për të kryer ekzaminim me qëllim të testimi të virgjërisë dhe duke e bërë atë të dënueshme me gjobë dhe burgim deri në një (1) vit; dhe (ii) kryerjen e testimi ose ekzaminimit mjekësor me qëllim të testimi të virgjërisë dhe duke e bërë atë të dënueshme me gjobë dhe me burgim nga një (1) deri në tre (3) vite, duke përfshirë parashikimin e rrethanave rënduese përkatëse dhe gjithashtu kriminalizimin e vetë tentativës për kryerjen e kësaj vepe penale.

Së fundi, ligji i ri për ndryshimin e Kodit Penal të vitit 2019, shton veprën penale të dhunës kundër grave në jetën publike, duke parashikuar që kushdo që me qëllim të frikësimit ose detyrimit për të vepruar kundër vullnetit të tyre, me dashje ushtron dhunë fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike, në formë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndaj grave që ushtrojnë funksione publike ose kandidatëve për ushtrimin e funksioneve publike, dënohet me gjobë dhe me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vite.

Nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Penale i vitit 2022, ndër të tjera, është ndryshuar për të shkurtuar afatet e hetimit dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor për veprat



penale të dhunimit dhe të dhunës në familje. Ndryshimet më domethënëse mund të përmbliken në dy (2) kategori, përkatësisht, (i) ndryshimi i nenit 157 (Afatet kohore të hetimit) të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2022, për të parashikuar një shmangie nga afatet e përgjithshme të hetimit dhe për t'i kufizuar këto afate në një (1) vit, dhe përjashtimisht për gjashtë (6) muaj shtesë; dhe (ii) ndryshimi i nenit 310 (Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor) të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2022, për të parashikuar një shmangie nga afatet e përgjithshme të zbatueshme dhe për të kufizuar këto afate nga gjashtëdhjetë (60) në nëntëdhjetë (90) ditë për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, varësisht se a zhvillohet para një gjyqtari të vetëm apo para një trupi të vetëm gjykues.

Më tej, por para ndryshimeve të lartpërmendura që lidhen me ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore dhe ndryshimeve përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, në janar 2022, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026,<sup>[55]</sup> e cila, ndër të tjera, e pranon se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë ndër format më të përhapura të dhunës dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhe se dhuna në familje mbetet një nga problemet më serioze me të cilat përballet shoqëria në Kosovë. Strategjia Kombëtare, ndër të tjera, pranon gjithashtu se (i) "*dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e plotë të grave*"; (ii) "*gratë dhe vajzat janë shpesh të ekspozuara ndaj dhunës, si për shembull dhuna në familje, ngacmimi seksual, dhunimi, martesa e detyruar, trafikimi, krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit "nder" dhe gjymtimi i organeve gjentiale, që përbëjnë vepër penale, duke u shndërruar në pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave*"; (iii) "*gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat dhe djemtë ndaj një rreziku më të lartë të dhunës në baza gjinore*"; dhe (iv) "*dhuna në familje prek gratë në mënyrë disproporcionale*".<sup>[56]</sup>

Sipas kësaj Strategjie Kombëtare, prioritet i Qeverisë është luftimi i dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore përmes objektivave strategjike të mëposhtme deri në vitin 2026, përkatësisht (i) marrja e përgjegjësisë për trajtimin me prioritet

[55] Strategjia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, e miratuar nga Qeveria në vitin 2022, e disponueshme në: <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/08/ENG-Strategjia-Kombetare-per-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-2026.pdf>.

[56] Ibid., f. 4-5.

të të gjitha rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; (ii) sigurimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për të luftuar dhunën e tillë; (iii) sigurimi i qasjes në shërbime cilësore të integruara; (iv) garantimin e drejtësisë për viktimat dhe të mbijetuarat; (v) sigurimin e riintegritimit dhe fuqizimit të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; (vi) ndëshkimi, risocializimi dhe rehabilitimi i kryesve të dhunës; dhe (vi) vetëdijesimi i shoqërisë kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.<sup>[57]</sup>

Për më tepër, Strategjia Kombëtare, ndër të tjera, u referohet anketave të zhvilluara nga OSBE në vitin 2018, sipas të cilave, dhe siç u theksua më lart, (i) 57% e grave kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike dhe seksuale që nga mosha pesëmbëdhjetë (15) vjeçare; ndërsa (ii) 48% e të anketuarve ende konsiderojnë se një dhunë e tillë është një çështje private familjare.<sup>[58]</sup> Me rëndësi, Strategjia Kombëtare vëren se studimet e kryera nga shoqëria civile evidentojnë se vitet e fundit ka një vëmendje të shtuar ndaj femicideve në kontekstin e dhunës në familje në Kosovë.<sup>[59]</sup>

### 3. Korniza ligjore përkatëse lidhur me vrasjet dhe/ose vrasjet në tentativë

Kapitulli XVI [Veprat penale kundër jetës dhe trupit] i Kodit Penal të vitit 2019, parashikon veprat penale kundër jetës dhe trupit të personit. Në lidhje me vrasjen, i njëjti parashikon veprat penale si vijon: (i) vrasje; (ii) vrasje e rëndë; (iii) vrasje e kryer në një gjendje të tronditjes së fortë mendore; (iv) vrasje nga pakujdesia; dhe (v) vrasje e foshnjës gjatë lindjes.

Vepra penale e "vrasjes" përkufizohet si "*Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim*".<sup>[60]</sup> Ndërsa, vepra penale e "vrasjes së rëndë" përkufizohet si "*Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:*

1.1. *privon nga jeta fëmijën;*

1.2. *privon nga jeta femrën shtatzënë;*

[57] Ibid., f. 9.

[58] Ibid., f. 6.

[59] Ibid.

[60] Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, supra note 38, neni 172 (Vrasja).

1.3. *privon nga jeta anëtarin e familjes;*

1.4. *privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;*

1.5. *privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;*

1.6. *privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;*

1.7. *privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;*

1.8. *privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;*

1.9. *privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare;*

1.10. **privon nga jeta personin tjetër motivuar në bazë të** kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, **gjinisë, identitetit gjinor**, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura;

1.11. *me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 174 dhe 176 të këtij Kodi;*

1.12. *privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 174 dhe 176 të këtij Kodi; ose*

1.13. *Veprimet përgatitore për cilindo nën-paragraf të paragrafit 1 të këtij neni do të dënohen.*<sup>[61]</sup>

Në anën tjetër, "Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore" përkufizohet si "Kushdo që personin tjetër e privon nga jeta në gjendje të tronditjes së fortë mendore, të shkaktuar pa fajin e tij nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10)

[61] Ibid., neni 173 (Vrasja e rëndë).

vjet." Ndërsa, "Vrasja nga pakujdesia" përkufizohet si "Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet"<sup>[62]</sup>, kurse "vrasja e foshnjës gjatë lindjes" përkufizohet si "Nëna që e privon nga jeta foshnjën e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa te ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet."<sup>[63]</sup>

Siç u përmend më lart, femicidi nuk është një term që përdoret në legjislacionin e Kosovës për të përshkruar vrasjen e grave me motive gjinore. Thënë këtë dhe siç u tha më lart, për dallim nga Kodi Penal i vitit 2012, Kodi i miratuar në vitin 2019 parashikon, ndër të tjera, një plotësim të ri në veprën penale "vrasje e rëndë". Konkretisht, neni 173 (Vrasja e rëndë) i Kodit Penal të vitit 2019 përfshin, në nënparagrafin 10 të paragrafit 1, veprën penale "vrasje e rëndë, privim nga jeta i personit tjetër motivuar në bazë të gjinisë ose identitetit gjinor". Pra, Kodi Penal e parashikon veprën e vrasjes me motivim gjinor si formë të vrasjes së rëndë, vepër penale e dënueshme me jo më pak se dhjetë (10) vite burgim deri në burgim të përjetshëm.<sup>[64]</sup> Megjithatë, siç u përmend më lart, "vrasja e motivuar në bazë të gjinisë" mund të kryhet nga burra ose gra kundër burrave ose grave. Megjithatë, ndonëse formulimi i neni 173 (Vrasja e rëndë) i Kodit Penal të vitit 2019, parashikon mundësinë që edhe meshkujt të jenë viktimë, është e qartë që përfshin edhe "vrasjen e grave të motivuar në bazë të gjinisë", e cila sipas përkufizimeve të mësipërme të pranuar përgjithësisht, nënkupton femicid. Duhet theksuar gjithashtu se përderisa Kodi Penal i vitit 2019 dhe ndryshimet përkatëse të vitit 2023, kanë avancuar ndjeshëm veprat penale dhe/ose dënimet përkatëse, duke përfshirë edhe fushën e dhunës në familje, ato nuk kanë shkuar aq larg sa të përfshijnë termin "femicid" në përmbajtjen e tyre përkatëse.

Më tej dhe për sa i përket zbatimit të kornizës ligjore të lartpërmendur, sipas aktgjykimeve të disponueshme të gjykatave të rregullta, që nga miratimi i Kodit të ri Penal në vitin 2019, i cili përfshin vrasjet e motivuara në bazë të gjinisë, nuk ka pasur dënime për vrasje të rëndë të motivuar në bazë të gjinisë. Përderisa, janë katër (4) aktgjykime të formës së prerë që kanë shpallur fajtorë kryesit për vrasjen e partnereve të tyre, vrasjet përkatëse nuk janë cilësuar si vrasje të rënda të motivuara në bazë të gjinisë, por si vrasje të rënda për (i) "privim nga jeta të një anëtarit të familjes"; dhe/ose (ii) "me dashje për të kryer dy ose më shumë vrasje". Edhe në rastet kur, sipas vendimeve përfundimtare të disponueshme të gjykatës,

[62] Ibid., neni 175 (Vrasja nga pakujdesia).

[63] Ibid., neni 176 (Vrasja e foshnjës gjatë lindjes).

[64] Ibid., neni 173 (Vrasja e rëndë), paragrafi 1, nënparagrafi 1.10.

mund të konkludohet se vrasja e gruas ka rezultuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, për shembull, nga ndjenja e pronësisë ose dominimit të burrit ndaj gruas, ose nga besimi se gruaja ka një rol të caktuar në marrëdhënie, rol ky që është shkelur, megjithatë, sipas aktgjykimeve përkatëse të gjykatave dhe siç do të shtjellohet më në detaje më poshtë, gjykatat e rregullta këto vrasje i kanë cilësuar vetëm si "vrasje e rëndë ndaj një anëtarit të familjes", por duke mos e përfshirë motivimin gjinor në cilësimin e vrasjes përkatëse si vrasje të rëndë.

#### 4. Korniza ligjore përkatëse lidhur me dhunën ndaj grave/dhunën në familje

Kodi Penal i vitit 2019 parashikon, ndër të tjera, këto vepra penale që lidhen me përdorimin e dhunës ndaj grave: (i) sulmi; (ii) lëndimi i lehtë trupor; (iii) lëndimi i rëndë trupor; (iv) gjymtimi i organeve gjenitale femërore; (v) kanosja; (vi) ngacmimi; (vii) ngacmimi seksual; (viii) pjesëmarrja në rrahje; (ix) sterilizimi i detyruar; (x) ndërprerja e palejuar e shtatzënisë; (xi) dhunimi; (xii) sulmi seksual; (xiii) degradimi i integritetit seksual; (xiv) martesja e detyruar; dhe (xv) dhuna në familje. Veprat penale të shtuara përmes miratimit të Kodit Penal të vitit 2019 dhe që nuk ishin pjesë e Kodit Penal të mëparshëm, përkatësisht Kodit Penal të vitit 2012, përfshijnë: (i) dhunën në familje; (ii) ngacmimin seksual; dhe (iii) gjymtimin e organeve gjenitale femërore. Ndryshimet e vitit 2023 në Kodin Penal, shtuan edhe veprën e re penale të testimit të virgjërisë.

Në lidhje me femicidin, Kodi Penal i vitit 2019, ndër të tjera, parashikon se (i) kur një personi tjetër i shkaktohet lëndim i rëndë trupor, që rezulton me vdekjen e personit, atëherë kryesi dënohet me burgim nga pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite; dhe se (ii) kur lëndimi i rëndë trupor kryhet ndaj një viktime të ndjeshme, ose është i motivuar, ndër të tjera, nga gjinia, atëherë në bazë të shkallës së dëmit të shkaktuar, do të dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vite.<sup>[65]</sup> Sipas Kodit Penal, viktimitë e ndjeshme është, ndër të tjera, gruaja shtatzënë ose personi, marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit, e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.<sup>[66]</sup>

[65] Ibid., neni 186 (Lëndimi i rëndë trupor).

[66] Ibid., neni 113 (Përkufizimet), paragrafi 39.

Vepra penale e “lëndimit të rëndë trupor” përshkruhet si:

*“1. Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me:*

*1.1. dobësimin e përkohshëm ose esencial të një pjese vitale të trupit të personit tjetër;*

*1.2. paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe esencial ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; ose*

*1.3. dëmtimin e përkohshëm dhe serioz të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

*2. Kushdo që shkakton lëndim trupor ose e dëmton shëndetin e personit tjetër dhe kjo rezulton me:*

*2.1. rrezikim të jetës së personit tjetër;*

*2.2. paaftësimin ose dobësimin e përhershëm të një pjese vitale të trupit të personit tjetër;*

*2.3. paaftësimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për çfarëdo lloj pune;*

*2.4. shëmtimin e përhershëm të personit tjetër; ose*

*2.5. dëmtimin e përhershëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.*

*3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me:*

*3.1. burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni;*

*3.2. burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni.*

4. Kur vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, **gjinisë, identiteti gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me:**

4.1. burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni;

4.2. burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni; ose

4.3. burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet për veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni.

**5. Kur vepra penale nga paragrafi 1., 2., 3. ose 4. i këtij neni rezulton me vdekjen e personit tjetër, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet. [...]"**

Nga ana tjetër, siç u theksua më lart, Kodi Penal i vitit 2019 parashikoi një vepër penale shtesë, konkretisht atë të përcaktuar në nenin 248 (Dhuna në familje) të Kodit Penal, i cili dhunën në familje e cilëson si në vijim:

"1. Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.

2. Kur çfarëdo vepre në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese.

3. Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet."

Për më tepër, Kodi Penal parashikon se një "marrëdhënie familjare" nënkupton marrëdhënien ndërmjet personave (i) që janë të fejuar apo kanë qenë të fejuar, janë të martuar apo kanë qenë të martuar, ose janë në bashkësi jashtëmartesore apo kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore, bashkëjetojnë në një ekonomi të përbashkët familjare ose kanë bashkëjetuar në një ekonomi të përbashkët; (ii) që përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi,

krushqie apo janë në një lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesat dhe nipërit nga vëllai dhe motra, kushërinjtë; ose (iii) që janë prindër të një fëmije të përbashkët.<sup>[67]</sup> Ndërsa anëtarë i familjes nënkupton prindin, prindin adoptues, fëmijën, fëmijën e adoptuar, vëllain ose motrën, bashkëshortin ose bashkëshorten, të afërmin e gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personin me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.<sup>[68]</sup> Çështja kryesore me këto përkufizime është se ato përjashtojnë partnerët që nuk kanë jetuar së bashku ose nuk kanë bashkëjetuar në një ekonomi të përbashkët. Prandaj, një nga rekomandimet e Raportit të Vlerësimit të GREVIO-s ishte përfshirja e këtyre llojeve të partneriteteve gjithashtu në përkufizimin e dhunës në familje.

Neni 248 (Dhuna në familje) i Kodit Penal parashikon gjithashtu se dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike për qëllime të Kodit Penal, është e njëjtë me atë të përcaktuar në Ligjin nr. 03/L-182 Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i cili është ligj i miratuar në vitin 2010. Ky i fundit, siç u përmend më lart, është zëvendësuar me ligjin e ri, përkatësisht me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, të miratuar në vitin 2023. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka miratuar Udhëzimin lidhur me Cilësimin Ligjor të Akteve të Dhunës në Familje,<sup>[69]</sup> me qëllim që të udhëzojë autoritetet zyrtare përkatëse në interpretimin e veprës së dhunës në familje sipas nenit 248 (Dhuna në familje) të Kodit Penal. Sipas këtij Udhëzimi, qëllimi i nenit 248 (Dhuna në Familje) është përfshirja edhe e formave më të lehta të dhunës në familje, veçanërisht veprimet që nuk mund të kategorizohen si vepra të tjera, qoftë kur nuk plotësohen të gjithë elementët e veprës, qoftë kur ka mungesë provash.

Në dritën e sa më sipër, dhe duke theksuar se korniza ligjore e Kosovës në përgjithësi është e avancuar dhe në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, në veçanti, pas miratimit të (i) Ligjit të ri për Kompensimin e Viktimave të Krimit; (ii) Ligjit të ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore; dhe (iii) ndryshimeve të Kodit

[67] Ibid., neni 113 (Përkufizimet), paragrafi 25.

[68] Ibid., neni 113 (Përkufizimet), paragrafi 26.

[69] Udhëzim lidhur me Cilësimin Juridik dhe Trajtimin e Rasteve të Dhunës në Familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës në vitin 2020, i disponueshëm në: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/75340\\_Supreme%20Court%20DV%20Guidance\\_June%202020.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/75340_Supreme%20Court%20DV%20Guidance_June%202020.pdf).



Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të vitit 2023, Raporti i Vlerësimit GREVIO-s, siç u përmend më lart, ka identifikuar pengesa të konsiderueshme dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse, veçanërisht në kuptim të përpjekjeve të nevojshme për zbatimin e kornizës ligjore përkatëse në fuqi.

Më tej dhe sipas shumë organizatave të shoqërisë civile, vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Rrjetin e Grave të Kosovës, disa çështje duhet të adresohen urgjentisht nga administrata shtetërore, duke përfshirë sa vijon: (i) edhe pse ka përmirësim në mënyrën se si institucionet i trajtojnë rastet e dhunës në familje që nga viti 2017, kultura e fajësimit të viktimave ende vazhdon; (ii) përpjekjet për të 'pajtuar' çiftin dhe për të 'ruajtur familjen' janë ende të përhapura; (iii) Strategjia Kombëtare 2022-2026 është zbatuar vetëm pjesërisht dhe financimi i pamjaftueshëm e ka penguar këtë zbatim; (iv) disa zyrtarë ende largojnë viktimat nga shtëpitë e tyre dhe jo kryesisht; (v) mungesa e personelit dhe mungesa e fondeve ndikojnë negativisht në punën e Mbrojtësit të Viktimave, Qendrave për Punë Sociale dhe Strehimoreve; dhe (vi) dënimi gjyqësor nuk është gjithmonë efektiv, proporcional dhe dekurajues, siç kërkohet nga Konventa e Stambollit.<sup>[70]</sup>

Përveç sa më sipër, Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës ka publikuar së fundi Raportin "*Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje*", ku ndër të tjera konstatohet se: (i) edhe pse institucionet kanë ndërmarrë një sërë veprimesh në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave; (ii) ka mangësi në angazhimin e hetuesve primarë, përfshirjen e mbrojtësve të viktimave, shqyrtimin me kohë e rasteve nga gjyqësori, si dhe në regjistrimin e rasteve të raportuara; (iii) viktimat nuk kanë mbështetje sociale, veçanërisht në aspektin ekonomik; (iv) mungojnë programet për trajtimin e kryesve të veprës; (v) ka mangësi në angazhimin adekuat të burimeve njerëzore në monitorimin dhe mbështetjen e viktimave gjatë rehabilitimit; (vi) megjithëse policia ndërhyr në një kohë optimale, sistemi është i mangët sa i përket procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të urdhrave mbrojtës, për përcjelljen e informacionit tek avokati i viktimës dhe për regjistrimin e rasteve; (vii) gjykatave u duhet një kohë e gjatë për të vendosur për rastet e dhunës në familje; dhe (viii) ka mungesë angazhimi institucional në regjistrimin e të dhënave në Databazën Kombëtare për Dhunën në Familje.<sup>[71]</sup>

[70] Rrjeti i Grave të Kosovës, *Nga Ligjet në Vepra – Monitorimi i përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë*, 2021, f. 7-8, i disponueshëm në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ENG-Final-2.pdf>.

[71] Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, "*Efektiviteti i institucioneve në trajtimin*

Më tej, sipas një studimi të kryer nga Amnesty International, çështjet e pranishme në Kosovë vazhdojnë të përfshijnë si në vijim: (i) të mbijetuarat nuk janë të informuara siç duhet për shërbimet mbështetëse shtetërore dhe mbrojtjet në dispozicion të tyre; (ii) policia dështoi të mbronte disa viktime përmes paragjyqimeve, mosbesimit dhe keqtrajtimit, veçanërisht të mbijetuarat nga grupet e marginalizuara; (iii) urdhrat mbrojtës janë vështirë të zbatueshëm, pasi nuk ka mbikëqyrje dhe zbatim efektiv të urdhrave të tillë; (iv) strehimoret janë të financuara pamjaftueshëm dhe me staf të pamjaftueshëm; (v) mbrojtësit e viktimave janë të mbingarkuar dhe me staf të pamjaftueshëm; (vi) janë të pranishme dënimet joadekuate, ku kryesit nuk marrin dënime në proporcion me veprën e tyre; dhe (vii) të mbijetuarat përballen me shumë pengesa drejt qasjes në dëmshpërblime.<sup>[72]</sup>

Raportet e lartpërmendura dhe shumë të tjera tregojnë se çështja kryesore me të cilën ballafaqohet Kosova është mungesa e zbatimit të duhur të kornizës ligjore ekzistuese, që aktualisht është më e rëndësishme se nevoja për miratimin e ligjeve të reja. Prandaj, një nga fokuset parësore të autoriteteve publike duhet të jetë krijimi i mekanizmave të duhur të zbatimit dhe monitorimit, të cilët do të siguronin zbatimin e ligjeve ekzistuese dhe atyre që do të miratohen në të ardhmen. Gjithashtu, duhet theksuar se një nga çështjet më urgjente me zbatimin e mangët të kornizës ligjore ekzistuese, është fakti se Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, nuk është zbatuar, edhe pse është miratuar para tetë (8) vitesh. Nëse ky ligj do të ishte zbatuar siç duhet, femicidet do të mund të ishin parandaluar, pasi do të siguronte që urdhrat mbrojtës të gjykatës po respektohen dhe policia do të njoftohej menjëherë kur kryesi i afrohet viktimës.

Përveç këtyre çështjeve, siç vërehet edhe në Raportin e Vlerësimit të GREVIO-s dhe siç do të shtjellohet më hollësisht në vijim, mungesa e statistikave të besueshme, duke përfshirë mungesën e angazhimit institucional në regjistrimin e të dhënave në Databazën Nacionale për Dhunën në Familje, pengon në masë të konsiderueshme çdo përpjekje për të krijuar dhe zbatuar çfarëdo politike të duhur në adresimin efektiv të dukurive të femicidit në Republikën e Kosovës.

*e rasteve të dhunës në familje*", gusht 2023, f. 1-2, i disponueshëm në: <https://zka-rks.org/Reports/ReportDetails?reportId=508>.

[72] Amnesty International, *Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje*, gusht 2023, f. 6-8, i disponueshëm në: <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7125/2023/en/#:~:text=73%2F7125%2F2023-,Kosovo%3A%20From%20paper%20to%20practice%3A%20Kosovo%20must%20keep%20its%20commitments,trying%20to%20leave%20abusive%20situations>.

## » III. STATISTIKAT DHE TË DHËNAT E MBLEDHURA – DHUNA NË FAMILJE/FEMICIDI

### 1. Statistikat dhe të dhënat e mbledhura në rastet e dhunës në familje dhe të vrasjes së grave

Në vitin 2018, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Policia e Kosovës, nënshkruan një Memorandum të Bashkëpunimit, përmes të cilit u pajtuan që të krijojnë një databazë për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi është krijuar për të funksionuar si një databazë e integruar e një numri institucioneve që mbajnë të dhëna dhe ofrojnë shërbime në rastet e dhunës në familje. Gjashtë (6) institucione janë autorizuar për përditësimin e databazës me të dhëna, konkretisht Policia, Qendra për Punë Sociale, Mbrojtësit e Viktimave, Strehimoret, Prokuroria dhe Gjykatat.

Sipas informacioneve të marra nga Ministria e Drejtësisë, nga Databaza Nacionale e të Dhënave mund të gjenerohen statistikave të mëposhtme: (i) statistika për numrin e rasteve të dhunës në familje; (ii) statistika për numrin e kryesve dhe viktimave të dhunës në familje; (iii) statistika për shërbimet e ofruara nga institucionet në rastet e dhunës në familje (Policia, Prokuroria, Gjykatat, Mbrojtësit e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale dhe Strehimoret); (iv) statistika për veprat penale të raportuara nga institucionet (Policia, Prokuroria dhe Gjykatat); (v) statistikave për masat dhe vendimet e gjykatave; dhe (vi) statistikave për ditët e qëndrimit të viktimës në strehimore.<sup>[73]</sup>

Gjithashtu, Databaza Nacionale në fjalë ofron mundësinë e klasifikimit të rasteve sipas veprës penale përkatëse, me dyzet e tetë (48) klasifikime gjithsej, duke përfshirë, por pa u kufizuar në veprat penale të (i) vrasjes; (ii) vrasjes në tentativë; (iii) lëndimit të rëndë ose të lehtë trupor; (iv) dhunës në familje; (v) përdhunimit; (vi) sulmit seksual; dhe (vii) martesës së detyruar. Megjithatë,

[73] Komunikim me Ministrinë e Drejtësisë.

rezulton se jo të gjitha funksionet e databazës përdoren në mënyrë konsistente dhe shumica e rasteve mbeten të paklasifikuara dhe regjistruhen nga Policia vetëm nën kategorinë e dhunës në familje.<sup>[74]</sup> Më tej dhe sipas Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, jo të gjitha autoritetet përgjegjëse plotësojnë ose përditësojnë të dhënat në Databazën Nacionale.<sup>[75]</sup> Institucioni i cili regjistron të dhënat në mënyrë më të rregullt dhe më koncize është Policia e Kosovës. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, institucionet e tjera përgjegjëse nuk i regjistrojnë plotësisht të dhënat e tyre, ndërsa gjykatat japin më së paku informacione në databazë.

Në këtë aspekt, duhet të theksohet gjithashtu se, sipas gjetjeve të Rrjetit të Grave të Kosovës dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit, Databaza Nacionale (i) është një bazë e të dhënave e cila nuk është publike dhe vetëm institucionet e autorizuara kanë qasje në të; (ii) nuk përmban të dhënat e plota për shkak të hezitimit dhe/ose mungesës së angazhimit/trajnimit të institucionit për t'i regjistruar ato, dhe më pas, informacioni statistikor i nxjerrë përmes tij nuk është plotësisht i saktë dhe i besueshëm; dhe (iii) përfshin vetëm rastet e dhunës brenda familjes/partneritetit, duke përjashtuar dhunën ndaj grave jashtë familjes/partneritetit. Më tej, statistikat e përfshira në Databazën Nacionale mund të merren vetëm nëpërmjet kërkesës për informacion. Kjo është gjithashtu një nga dobësitë e identifikuar nga Raporti i Vlerësimit i GREVIO-s. Në këtë drejtim, edhe pse Policia e Kosovës zakonisht është e shpejtë në përgjigjen ndaj kërkesave për informacion statistikor, ajo mund të sigurojë vetëm statistika të përgjithshme bazuar në të dhënat që i ka në dispozicion.

Në hartimin e këtij raporti, nga Policia e Kosovës është kërkuar që të ofrojë informatat në dispozicion, përkatësisht t'i përgjigjet pyetjes se *Sa raste të dhunës në familje janë regjistruar gjatë periudhës 2018-2022 në Kosovë?* Të dhënat e mëposhtme janë ofruar nga Policia e Kosovës:

Dhuna në familje në Kosovë	
2018	
Numri total i rasteve të dhunës në familje	1541
Numri i viktimave femra	1227
Numri i viktimave meshkuj	340

[74] Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, supra note 71, f. 41.

[75] Ibid., f. 39.

Dhuna në familje në Kosovë	
2019	
Numri total i rasteve të dhunës në familje	1915
Numri i viktimave femra	1593
Numri i viktimave meshkuj	385
2020	
Numri total i rasteve të dhunës në familje	2069
Numri i viktimave femra	1632
Numri i viktimave meshkuj	469
2021	
Numri total i rasteve të dhunës në familje	2456
Numri i viktimave femra	1986
Numri i viktimave meshkuj	500
2022	
Numri total i rasteve të dhunës në familje	2674
Numri i viktimave femra	2289
Numri i viktimave meshkuj	519

Përveç informatave të ofruara sipas kërkesës, Policia e Kosovës në Raportin Vjetor të Punës e paraqet numrin e krimeve të raportuara çdo vit, i cili përfshin numrin e vrasjeve dhe dhunës në familje që kanë ndodhur brenda vitit përkatës. Megjithatë, të dhënat nuk janë të ndara sipas gjinisë dhe nuk përmbajnë asnjë informacion tjetër përveç numrit të krimeve të kryera.<sup>[76]</sup> Nga ana tjetër, Agjencia e Statistikave të Kosovës po ashtu publikon "*Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhorë*", ku ndër të tjera përfshihet edhe numri i personave që janë dënuar për kryerjen e veprave penale brenda vitit përkatës. Megjithatë, jepen vetëm informacionet për cilësimin ligjor të veprës penale, gjininë e kryesit dhe shtetësinë e kryesit.<sup>[77]</sup> Prandaj, përkundër ekzistencës të së paku tri sistemeve, përkatësisht Databazës Nacionale, Raportit Vjetor të Policisë së Kosovës dhe Raportit Vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përveç raporteve të ndryshme të përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile, nuk ekziston një sistem i vetëm dhe/ose gjithëpërfshirës nga i cili mund të nxirren informacione të sakta dhe të besueshme

[76] Uebfaqja e Policisë së Republikës së Kosovës, e disponueshme në: <https://www.kosovopolice.com/dokumente/dokumentet-strategjike/>.

[77] Uebfaqja e Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës, e disponueshme në: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/02d4d612-1d43-4755-90c9-0e1d6f44c977.pdf>.

statistikore mbi dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe/ose femicidin.

Më tej dhe në pyetjen më konkrete për Policinë e Kosovës, se *“Sa gra janë vrarë apo është tentuar të vriten gjatë periudhës 2018-2022 në Kosovë?”*, informacionet e mëposhtme janë dhënë nga Policia e Kosovës:

VRASJA E GRAVE NË KOSOVË		
Nr.	Marrëdhënia e viktimës me të pandehurin	Cilësimi i veprës penale nga Prokuroria ose Policia
Viti 2018		
1	Burri - gruaja dhe vajza e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
2	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje nga pakujdesia
3	Nëna - foshnja e saj (vajzë)	Vrasje e rëndë
4	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
5	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
6	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
7	Burri - gruaja e tij	Vrasje në tentativë
Viti 2019		
1	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje (gjatë festimeve e vrau gruan e tij)
2	Burri - gruaja e tij dhe e reja e tij (gruaja - vjehri)	Vrasje e rëndë
3	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Lëndim i rëndë trupor, rasti pastaj u shndërrua në vrasje të rëndë.
4	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
Viti 2020		
1	Djali - babai dhe nëna e tij	Vrasje e rëndë <sup>[78]</sup>
2	Vajza - nëna, babai dhe vëllezërit e saj	Vrasje e rëndë
3	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
4	Babai - vajza e tij	Vrasje (Vrasje aksidentale)
5	Djali - gruaja e axhës së tij	Vrasje (gjatë festimeve aksiden-talisht e vrau viktimën)
6	Burri - gruaja dhe dy djemtë e tij	Vrasje e rëndë
7	Djali - nëna e tij	Vrasje e rëndë
8	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje në tentativë

[78] Sipas raporteve të medieve, djali pretendohet se vrau prindërit e tij për shkaqe financiare.

VRASJA E GRAVE NË KOSOVË		
Viti 2021		
1	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
2	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
3	Burrë - grua (partnerë ose bashkëjetesë)	Vrasje e rëndë
4	Motra - motra e saj	Vrasje e rëndë
5	Burrë - grua (bashkëjetesë)	Vrasje në tentativë
Viti 2022		
1	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
2	Burri - gruaja e tij (gruaja)	Vrasje e rëndë
3	Burrë - grua (bashkëjetesë)	Vrasje e rëndë
4	Kunata - Kunata	Vrasje
5	Burrë - grua (bashkëjetesë)	Vrasje në tentativë

Sipas tabelës së mësipërme, treguesit e vetëm të matshëm janë: (i) marrëdhënia e kryesit me viktimën; dhe (ii) cilësimi i veprës penale. Mungesa e specifikimit të të dhënave, e bën të vështirë nxjerrjen e numrit të femicideve dhe/ose femicideve në tentativë për vitet përkatëse, përkatësisht 2018-2022. Megjithatë, në përpjekje për të përcaktuar numrin e femicideve dhe/ose femicideve në tentativë, bazuar në të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës, janë përdorur këto përkufizime përkatëse: (i) femicid – *të gjitha format e vrasjes me dashje të grave të kryera nga burrat*; dhe (ii) femicid në tentativë – *të gjitha format e tentativës për vrasje me dashje të grave të kryera nga burrat*.<sup>[79]</sup>

Në zbatimin e këtyre përkufizimeve, rastet e mëposhtme nga tabela e mësipërme nuk janë numëruar/cilësuar si femicide, konkretisht: (i) vrasjet aksidentale; (ii) vrasjet e grave nga gratë; dhe (iii) vrasjet ku, sipas informacioneve të marra nga Policia e Kosovës, raportet e shoqërisë civile dhe mediat, motivi i kryesit nuk duket të jetë i motivuar në bazë të gjinisë.

[79] Ky përkufizim i gjerë i femicidit dhe femicidit në tentativë është përdorur për të përcaktuar numrin e femicideve të dyshuara dhe femicideve në tentativë në Kosovë për periudhën 2018-2022, siç është paraqitur në tabelat e mëposhtme. Nëse do të ishin përdorur përkufizime të tjera të femicidit, atëherë numrat e paraqitur këtu do të ndryshonin. Megjithatë, duhet theksuar se, për shkak të mungesës së të dhënave të disponueshme në shumicën e rasteve – veçanërisht sa i përket "motivit" të kryesve për vrasjen e grave – ishte e pamundur të nxirreshin statistika të sakta duke përdorur përkufizimet e tjera të njohura.

Prandaj, (i) në zbatimin e përkufizimeve të femicidit dhe/ose femicidit në tentativë siç përshkruhet më sipër; dhe (ii) duke përjashtuar kategoritë sipas sqarimeve të mësipërme, në mënyrë të kujdesshme mund të konkludohet se numri i përafërt i femicideve të dyshuara dhe tentim femicideve të dyshuara në Kosovë për periudhën 2018-2022, është si vijon:

Femicidet në Republikën e Kosovës					
Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i femicideve të dyshuara	6	4	4	3	3
Gjithsej	20				

Femicidet në tentativë në Republikën e Kosovës					
Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i femicideve në tentativë të dyshuara	1	0	1	1	1
Gjithsej	4				

Përveç të dhënave të mësipërme të cilat pasqyrojnë një periudhë pesë (5) vjeçare, sipas statistikave të ofruara nga Rrjeti i Grave të Kosovës dhe Policia e Kosovës, në Kosovë janë vrarë pesëdhjetë (50) gra në periudhën 2010-2022. Më tej dhe, edhe pse nuk ka statistika zyrtare për këtë çështje, duket se në Kosovë është e pranishme edhe "vrasja" e foshnjave (infanticidi), pasi sipas një Raporti të publikuar nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) në vitin 2016, familjet favorizojnë lindjen e djemve dhe rrjedhimisht, gratë janë të prira të abortojnë kur fëmija është vajzë, veçanërisht nëse është fëmija i tretë në familje.<sup>[80]</sup>

Pavarësisht nga sa më sipër, një numër i organizatave në Kosovë kanë bërë një ndikim të jashtëzakonshëm në adresimin e mungesës së statistikave gjithëpërfshirëse dhe publike, siç është Rrjeti i Grave të Kosovës,<sup>[81]</sup> Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Qendra për Informim, Kritikë dhe Veprim – QIKA. Këto organizata, kanë publikuar raporte të shumta të cilat jo vetëm kanë

[80] Deklaratë nga aktivistja feministe, znj. Luljeta Demolli "Demolli: Duke e mbajtur të fshehtë femicidin në Kosovë, s'mundta luftojmë atë - Klan Kosova", e disponueshme në: <https://klankosova.tv/demolli-duke-e-mbajtur-te-fshehte-femicidin-ne-kosove-smund-ta-luftojme-ate/>

[81] Uebfaqja e organizatës Rrjeti i Grave të Kosovës, e disponueshme në: [Ballina - Kosovo Women's Network \(womensnetwork.org\)](http://Ballina-Kosovo-Womens-Network(womensnetwork.org)); dhe uebfaqja e organizatës Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion – QIKA, e disponueshme në: [QIKA - 1e1](http://QIKA-1e1).



evidentuar dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje dhe femicidet, por edhe kanë ngritur vetëdijesimin dhe kanë edukuar publikun për këto dukuri dhe për nevojën për të bërë ndryshime. Organizata Qika ka lansuar së fundmi një platformë digjitale e cila përdor të dhëna nga institucionet publike për rastet e dhunës në familje dhe me fokus në dhunën ndaj grave.<sup>[82]</sup> Kjo platformë ofron informacione të detajuara, ndër të tjera, për rastet e dhunës në familje, të ndara sipas gjinisë, komunës, përkatësisë etnike, mënyrës se si janë zgjidhur rastet dhe hapave përkatës të ndërmarrë nga institucionet përgjegjëse. Organizata të tjera si Rrjeti i Grave dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore gjithashtu monitorojnë rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe rregullisht publikojnë raporte për këto tema.

## 2. Të dhënat për Femicidet dhe Femicidet në Tentativë të trajtuara përgjatë 2018-2022

Siç u përmend më lart, Databaza Nacionale nuk përfshin të gjitha informacionet e nevojshme për të ndërtuar statistika të sakta dhe përfundimtare mbi dhunën në familje dhe veçanërisht, mbi rastet e femicideve dhe/ose femicideve në tentativë në Kosovë. Mungesa e statistikave zyrtare për dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje dhe veçanërisht për femicidet, paraqet pengesë në ngritjen e vetëdijesimit dhe në luftën kundër kësaj dukurie në Kosovë. Hendeku statistikor reflektohet edhe nga rekomandimet në Raportin e Vlerësimit të GREVIO-s, sipas të cilit, ndër të tjera, autoritetet në Kosovë duhet (i) të zgjerojnë fushën e të dhënave të mbledhura nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori për të përfshirë të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të sigurohet që të dhënat e tilla të ndahen sipas gjinisë, moshës dhe marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe kryesit; dhe (ii) të sigurojnë fushën e të dhënave të mbledhura nga shërbimet sociale dhe strehimoret për të siguruar që adreson të gjitha format e dhunës sipas Konventës së Stambollit, të cilat janë të ndara sipas gjinisë, moshës dhe marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe kryesit, si dhe kategori të tjera relevante, siç është statusi i aftësisë së kufizuar.

Pavarësisht sfidave në mbledhjen e të dhënave të besueshme për dhunën në familje, por posaçërisht për femicidin dhe/ose femicidin në tentativë, numri i vendimeve gjyqësore të formës së prerë që janë të disponueshme, është gjithashtu i kufizuar. Në këtë drejtim, fillimisht duhet theksuar se sipas informatave të ofruara nga mediat dhe raportet e shoqërisë civile, në së paku katër (4) raste të paraqitura në tabelën e mësipërme, autorët kanë kryer vetëvrasje dhe, rrjedhimisht procedura penale nuk është iniciuar ndaj autorëve. Së dyti, duhet

[82] Ibid.

theksuar gjithashtu se, përderisa në Republikën e Kosovës gjatë periudhës 2018-2022 mund të kenë ndodhur rreth njëzet (20) femicide dhe katër (4) femicide në tentativë, vetëm katër (4) aktgjykime të formës së prerë për këto krime, janë aktualisht në dispozicion për t'u studiuar.

Përderisa aktgjykimet e formës së prerë të gjykatave dhe/ose rastet studimore të disponueshme, do të shtjellohen në detaje më poshtë, me qëllimin kryesor të identifikimit të veçorive, trendeve dhe sfidave të përbashkëta, mund të vërehet në mënyrë preliminare se, emëruesi i përbashkët thelbësor që buron nga rastet e lartpërmendura, tregon, ndër të tjera, se (i) të gjitha vrasjet e grave janë kryer nga burrat brenda marrëdhënies familjare; (ii) në aktgjykimet e formës së prerë, tri (3) nga katër (4) rastet janë cilësuar si "*vrasje e rëndë, privim nga jeta i anëtarit të familjes*" dhe një (1) rast është cilësuar si "*vrasje e rëndë, me dashje kryen dy ose më shumë vrasje*"; (iii) asnjë nga vrasjet nuk është cilësuar si "*vrasje e rëndë, e motivuar në bazë të gjinisë*", siç parashikohet në nënparagrafin 10 të paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019; (iv) kryesit janë dënuar mesatarisht me njëzet e gjashtë (26) vite burgim; dhe (v) nuk është shprehur ndonjë gjuhë diskriminuese gjinore në arsyetimin e aktgjykimeve përkatëse të gjykatave, viktimat nuk janë fajësuar dhe nuk ka pasur ndonjë ton që do të dukej se arsyeton krimet përkatëse.

## » IV. RASTET STUDIMORE

Rastet e mëposhtme pasqyrojnë përshkrime të shkurtra të fakteve dhe konstatimeve të dhëna nga aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta. Në vijim janë përmbledhur vetëm informacionet që konsiderohen relevante për qëllimet e këtij studimi. Në këtë aspekt, për secilin rast studimor, informacionet që rezultojnë nga aktgjykimet përkatëse të gjykatave, do të organizohen në kategoritë e mëposhtme, përkatësisht (i) një përshkrim i shkurtër i rastit; (ii) personaliteti dhe sjellja e kryesit, siç del nga përshkrimi i aktgjyqimeve të gjykatave të rregullta; (iii) të dhënat për viktimën, siç dalin nga përshkrimi i aktgjyqimeve të gjykatave të rregullta; (iv) procedura penale përkatëse; (v) sanksioni penal; dhe (v) një komentim i shkurtër për rastin përkatës.

### 1. Femicidi I: kryesi P.N., viktimat V.N. dhe K.N.

#### 1.1. Përshkrim i shkurtër i rastit

Më 7 gusht 2018, rreth orës 21:20, kryesi P.N., qëlloi për vdekje bashkëshorten V.N., dhe vajzën e tij të mitur K.N., me një pushkë AK-47, të cilën e posedonte në mënyrë të paligjshme. Viktima V.N., dhe fëmijët e saj, po qëndronin në shtëpinë e vëllait të saj, pasi V.N., kishte vendosur të largohej nga P.N., për shkak të dhunës së tij të vazhdueshme, ku një nga keqtrajtimet e fundit ishte kryer në një dasmë, pra në prani të shumë njerëzve. V.N., kishte raportuar në Polici sulmin e fundit të P.N.-së, si rezultat i të cilit, ai u mbajt në masën e paraburgimit për një (1) muaj dhe më pas u lirua.

Sipas informacioneve të dhëna në aktgjykimet e gjykatës, në ditën e kryerjes së krimit, P.N., shkoi në shtëpinë e mikut së bashku me disa burra nga familja e tij dhe tentoi të pajtohej me V.N., dhe t'a "çojë në shtëpinë e tij, për të vazhduar jetën e tyre së bashku". Kur V.N., refuzoi dhe shprehu neveri të madhe për t'u kthyer me të, duke deklaruar, bazuar në të dhënat që dalin nga vendimet e gjykatave, se "*edhe sikur të kishte vdekur, nuk do të kthehej tek ai*", P.N., u ngrit dhe i urdhëroi burrat të largoheshin, duke kërcënuar se "*do ta dëgjoni krismën e kësaj pune*". Më vonë gjatë ditës, P.N., i kishte dërguar mesazhe kërcënuese V.N., për të cilat ajo e njoftoi brenda ditës Policinë, duke vënë në dukje ndër të tjera shqetësimin që kishte se ai ishte një person i rrezikshëm dhe nuk qëndronte kurrë pa armë. Policia deklaroi se do të merrej me të, por, sipas të dhënave në vendimeve e gjykatave, nuk ndërmorën asnjë veprim të menjëhershëm për ta mbrojtur V.N.-një.

Më tej dhe sipas informacioneve të dhëna në aktgjykimet përkatëse të gjykatave, më vonë gjatë ditës, P.N., shkoi në shtëpinë e tij dhe mori pushkën AK-47. Ai më pas shkoi në shtëpinë e mikut të tij rreth orës 21:20, hapi derën dhe menjëherë qëllloi me breshëri zjarri në drejtim të gruas dhe vajzës së tij. Për pasojë V.N., ishte qëlluar në fytyrë, qafë dhe shpatulla, ndërsa K.N., ishte qëlluar në kokë, pas veshit dhe dorës. Në momentin kur ndodhën të shtënat, të pranishëm ishin familja e viktimës V.N., përkatësisht nëna, vëllezërit, fëmijët e tjerë të saj si dhe anëtarë të tjerë të familjes. V.N., ndërroi jetë në vendngjarje, ndërsa K.N., vajza e tyre, ndërroi jetë në spital.

## 1.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit

Sipas të dhënave të disponueshme në aktgjykimet e gjykatave, P.N., ishte veteran luftë. Ai u përshkrua nga familjarët, të cilët iu referuan problemeve të tij pas kthimit nga burgjet në Serbi, duke përfshirë se shpesh kishte sjellje agresive, ishte i padurueshëm dhe i ndjeshëm ndaj çdo reagimi apo situatë. Ai ishte i shtresës së mesme ekonomike. P.N., kishte ushtruar dhunë ndaj V.N., shumë herë. Siç u përmend më lart, një nga rastet kur ai e kishte keqtrajtuar, kishte qenë gjatë një dasme, për të cilën ai ka qëndruar në paraburgim prej tridhjetë (30) ditësh. Ai kishte premtuar se do të ndalonte keqtrajtimet, por situata vazhdoi në të njëjtën mënyrë.

Gjatë procedurës gjyqësore në shkallën e parë, P.N., e pranoi në tërësi krimin dhe tha se ishte penduar që e kishte kryer krimin. Megjithatë, pasi Gjykata Supreme e ktheu çështjen në rigjykim në shkallë të parë, ai pohoi se veprën penale e kishte kryer vetëm objektivist, se i kishte vrarë viktimat pa dashje dhe se qëllimi i tij ka qenë ta vrasë vëllain e gruas së tij, duke e konsideruar atë si shkakun kryesor të kësaj tragjedie. Nga ana tjetër, avokati i tij mbrojtës pohoi se rasti në fjalë kishte të bënte me pakujdesi ekstreme në momentin e shkreptjes së armës dhe se kryesi P.N., nuk e kishte qëllimin të vraste anëtarët e familjes së tij, por dikë tjetër. Avokati i tij mbrojtës gjithashtu kishte theksuar se familjarët e P.N., i ishin referuar kohës që kishte kaluar në burgjet në Serbi dhe problemeve të tij pas lirimit, duke iu referuar edhe një raporti të lëshuar nga Spitali në vitin 2016, nga i cili rezultoi se ai ishte diagnostikuar me çrregullim të stresit post-traumatik (PTSD).

Më pas, Gjykata i lëshoi urdhër Institutit të Psikiatrisë Forenzike që të bëjë ekzaminim psikiatrik në lidhje me shëndetin mendor të kryesit në kohën e kryerjes së veprës penale. Pas ekzaminimit, ekspertët, ndër të tjera, konstatuan se ai nuk kishte çrregullime mendore të përkohshme apo të përhershme; nuk kishte aftësi të zvogëluar për të kontrolluar veprimet e tij në kohën e kryerjes së veprës penale; dhe se ai ishte i vetëdijshëm dhe ishte në gjendje të ndiqte procedurën gjyqësore.

### 1.3 Të dhënat për viktimën

Sipas të dhënave që janë të disponueshme në aktgjykimet e gjykatave, viktima V.N., ishte në mesin e të tridhjetave kur u vra. Ajo ishte martuar në moshë të re, me shkuesi dhe me kryesin kishte pesë (5) fëmijë, katër (4) vajza dhe një (1) djalë. Ajo ishte keqtrajtuar shumë herë fizikisht nga bashkëshorti, keqtrajtim të cilin e mbante të fshehtë për shumë vite nga familja. Viktima K.N. ishte tetë (8) vjeçare kur u vra.

### 1.4 Procedura penale

#### (i) gjykimi i parë

Kryesi e kreu vrasjen më 7 gusht 2018. Prokuroria ngriti aktakuzën [PP/I. nr.47/18] ndaj P.N., më 26 shtator 2018, për shkak të (i) veprës penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafët 1.1, 1.3 dhe 1.11 të paragrafit 1 të nenit 179 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2012, përkatësisht për shkak të "*privimit nga jeta të fëmijës*", "*privimit nga jeta të anëtarit të familjes*" dhe "*kryerjes me dashje të dy ose më shumë vrasjeve...*", respektivisht; dhe (ii) veprës penale nga paragrafi 1 i nenit 374 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) të Kodit Penal të vitit 2012, përkatësisht "*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*".

Gjykata Themelore e shpalli Aktgjykimin [PKR.nr.48/18] më 2 nëntor 2018 dhe e publikoi më 19 nëntor 2018. Sipas aktgjyimit të lartpërmendur, P.N., u shpall fajtor për (i) veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafët 1.1, 1.3 dhe 1.11 të paragrafit 1 të nenit 179 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2012; dhe (ii) veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga paragrafi 1 i nenit 374 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) të Kodit Penal të vitit 2012. Gjykata Themelore caktoi dënimin me njëzet e tre (23) vite burgim për vrasje të rëndë dhe dy (2) vite burgim për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Në fund, Gjykata Themelore e dënoi kryesin P.N., me dënim unik prej njëzet e katër (24) vitesh burgim, po ashtu duke urdhëruar P.N., (i) që të paguajë shpenzimet procedurale gjyqësore, si dhe (ii) që të paguajë pesëdhjetë (50) euro për kompensimin e viktimave të krimit, duke iu referuar nenit 39 (Financimi i kompensimit të viktimave të krimit) të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të vitit 2015, duke këshilluar palën e dëmtuar, përkatësisht familjen e viktimës, që të realizojnë kërkesën financiare në kontest civil.

Gjykata Themelore në nxjerrjen e aktgjykimit, ndër të tjera, kishte vlerësuar (i) rrethanat lehtësuese, përkatësisht faktin se kryesi kishte "*pranuar fajësinë për veprat penale të cekura si në aktakuzë dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij, e duke i vlerësuar këto rrethana si posaçërisht lehtësuese konform nenit 73*"; dhe (ii) rrethanat rënduese, përkatësisht "*shkallën e lartë të pjesëmarrjes në veprën penale dhe shkallën e dashjes*".

Ndaj aktgjykimi të Gjykatës Themelore ushtruan ankesë prokuroria, i dëmtuari dhe kryesi P.N.

Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR nr.629/2018] më 31 janar 2019, me të cilin aprovoi ankesat e prokurorisë dhe të të dëmtuarit dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore përkitazi me cilësimin ligjor dhe dënimin përkatës, kësisoj duke shpallur P.N., (i) fajtor për vrasje të rëndë nga nënparagrafi 1.11 i paragrafit 1 të nenit 179 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2012, konkretisht për "*kryerje me dashje të dy ose më shumë vrasjeve...*", për të cilën i shqiptoi dënimin me burgim të përjetshëm; dhe (ii) fajtor për mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, për të cilën i shqiptoi dënimin me pesë (5) vite burgim; dhe (iii) me atë rast e dënoi atë me dënim unik - burgim të përjetshëm.

Në aktgjykimin përkatës, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi se "*edhe përkundër faktit se ekzistimi i veprave penale është i vërtetuar, me provat e pa kontestueshme të cilat gjenden në shkresat e lëndës, edhe pa pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar që pranimin e fajësisë e ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese.*" Megjithatë, sipas Gjykatës së Apelit, rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar drejt nga Gjykata Themelore. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, konstatoi se (i) "*shqiptimi i dënimit unik në kohëzgjatje prej 24 viteve nuk është adekuat me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarit, kjo për faktin se janë plotësuar kushtet ligjore se ekzistojnë asi rrethana posaçërisht rënduese dhe janë shkaktuar pasojat tejet të rënda me rastin e privimit nga jeta të bashkëshortes së tij dhe vajzës së tij, e që kanë mundur të shkaktohen edhe pasoja më të rënda*"; dhe (ii) "*siç rezulton nga shkresat e lëndës me rastin e privimit nga jeta të bashkëshortes dhe vajzës së tij, i akuzuari për shkak të raporteve të këqija bashkëshortore, e duke i marrë parasysht rrethanat personale të akuzuarit i cili tregon këmbëngulësi të fortë në privimin e jetës së tyre...*". Përveç sa më sipër, Gjykata e Apelit po ashtu vërejti se (i) "*i akuzuari edhe më parë në mënyrë permanente ka pas sjellje të këqija ndaj bashkëshortes së sajë dhe familjes duke ushtruar dhunë, e duke marrë parasysht mënyrën e kryerjes së veprës penale se ajo është kryer në prezencën e fëmijëve dhe vëllezërve të ndjerës V.*

*si dhe anëtarëve tjerë ku pasojat kanë mundë të jenë edhe më të rënda, për shkak të mënyrës së kryerjes së veprës penale me shkrepte në rafal nga pushka automatike, se ka pasë shqetësim të madh edhe tek qytetarët.”; dhe (ii) “dënimi i këtillë i shqiptuar i përjetshëm i përgjigjet peshës së veprës penale për arsye se i akuzuari ka treguar shkalle të lartë të në kryerjen e veprës penale, se gjithmonë një kohë të gjatë ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së sajë, e duke marrë parasysh se kemi pasoja të rënda dy viktima nënën dhe vajzën e sajë të privuar nga burri- prindi...”.*

Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit u parashtrua ankesa përkatëse në Gjykatën Supreme nga kryesi P.N., i cili pretendoi, ndër të tjera, se ishin shkelur dispozitat e procedurës penale ndërlidhur me pranimin e fajësisë.

Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [PA.-II.nr.2/2019] më 16 maj 2019, përmes të cilit e ktheu rastin në rigjykim sepse sipas Gjykatës Supreme, gjatë analizimit të pranimin të fajësisë, qartë rezultonte se i akuzuari vetëm pjesërisht e kishte pranuar fajësinë në raport me vrasjen e gruas së tij, por nuk e kishte pranuar fajësinë në raport me vrasjen e vajzës së tij. Prandaj, Gjykata Supreme konstatoi se gjykata e shkallës së parë, përkatësisht Gjykata Themelore, nuk është dashur ta pranojë pranimin e fajësisë dhe se rasti është dashur të kalojë në shqyrtim të mëtejshëm gjyqësor.

#### *(ii) rigjykimi*

Pas kthimit të rastit në rigjykim, Gjykata Themelore shpalli Aktgjykimin [PKR. nr.43/19] më 14 shtator 2020, i cili u publikua më 6 nëntor 2020, me ç'rast e shpalli kryesin P.N., fajtor për (i) veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafët 1.1, 1.3 dhe 1.11 të paragrafit 1 të nenit 179 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2012; dhe për (ii) veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga paragrafi 1 i nenit 374 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) të Kodit Penal të vitit 2012. Për këto vepra penale iu shqiptua dënimi unik me burg prej njëzet e katër (24) vitesh e gjashtë (6) muajsh.

Me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Themelore theksoi si rrethana lehtësuese si në vijim: (i) *“gjykata pati parasysh gjendjen ekonomike dhe familjare të akuzuarit, moshën e tij, sjelljen korrekte para gjykatës, pendimin për veprën penale të kryer”*. Ndërsa si rrethana rënduese si në vijim (ii) *“gjykata mori parasysh se më parë ka qenë i dënuar për vepër penale të dhunimit ndaj viktimit V. N. mënyrën e kryerjes së veprës penale”*.

Më tej dhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (i) kryesi P.N., u deklarua i pafajshëm për vrasje të rëndë dhe fajtor për armëmbajtje pa leje; ndërsa (ii) mbrojtja e palës së dëmtuar, gjegjësisht vëllezërit e viktimës V.N., ndër të tjera, gjatë seancave deklaruan se *"me dashje në mënyrë të planifikuar mirë e për motive të ulta [P.N.] e ka ekzekutuar bashkëshorten V.N. dhe vajzën K.N., ku viktimat qëllohen disa herë dhe nga plagët e marra V. vdes në vend, ndërsa K.N vdes në Spitalin e Gjakovës, njëherit i akuzuari ka rrezikuar tërë familjen M. duke shtënë me automatik në të gjitha drejtimet brenda shtëpisë,"* dhe se sipas deponimit të kryesit, P.N., e pranon se ai *"edhe para datës kritike shumë herë më parë në vazhdimësi kishte ushtruar dhune ndaj të ndjerës V.N. ku i njëjti kishte qenë i gjykuar dhe i dënuar disa herë nga kjo gjykatë, kishte premtuar disa herë se ne të ardhmen nuk do të ushtrojë dhunë, këtë premtim ja kishte dhënë vëllait të së ndjerës Sh. dhe K.M. dhe dajës së tyre dhe të njerëzve familjar të tij, ... mirëpo ky pajtim i premtuar nga i pandehuri s'ka zgjatë si të themi me orë dhe prapë ka vazhduar e njëjta situatë..."*. Përveç kësaj, sipas dy dëshmitarëve të tjerë (i) pasi që P.N., po largohej me burrat nga shtëpia e vëllezërve të V.N., ai i tha vëllait të saj *"se po që se nuk ma sjellni V. në shtëpi, më keni borxh."*; dhe (ii) pasi që P.N., kishte kryer vrasjet, ai shkoi në shtëpinë e një të afërmi dhe i tha *"e kam gjuajtur V."*, dhe kur u pyet pse, ai tha *"se nuk kam pasur rrugëdalje tjetër"*. Ndërsa, sipas raportit të psikiatrisë forenzike për P.N., të realizuar në vitin 2018, *"1. Te i ekzaminuari nuk konstatohet sëmundje mendore apo çrregullime mendore i karakterit të përkohshëm apo përhershëm dhe nuk konstatohet ngecje në zhvillim mendor. 2. Në kohën e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet llogaritimëria ka qenë e ruajtur. 3. I njëjti mund të marr pjesë në seancën gjyqësore, të përcjellë rrjedhën e saj, të e kuptoj dhe të përgjigjet në pyetjet e parashtruara"*. I njëjti përfundim është nxjerrë edhe nga raporti i psikiatrisë forenzike i kryer në vitin 2020, përkatësisht se *"P.N. nuk vuan nga prapambetja apo ndonjë çrregullim mendor i përhershëm ose i përkohshëm. Në kohën e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet nuk janë gjetur elemente psikopatologjike të cilat kanë mundur të ndikojnë në zvogëlimin e aftësisë për të kontrolluar veprimet e tij"*.

Ndërsa, sipas aktgjykimit, Gjykata Themelore, ndër të tjera, vërtetoi edhe këto fakte: (i) viktima V.N., nuk ka dashur të kthehet në shtëpinë e bashkëshortit të saj për shkak të dhunës së vazhdueshme, ku rasti i fundit i dhunës kishte ndodhur në një dasmë dhe para të tjerëve, të cilën V.N., e kishte raportuar në polici dhe të pandehurit i ishte caktuar masa e paraburgimit prej tridhjetë (30) ditësh, si dhe dënimi efektiv prej një (1) viti e tetë (8) muaj; (ii) gjatë ditës kritike, P.N., i kishte dërguar tri mesazhe V.N.-së. *"Tash të pret një dhuratë e bukur ty edhe [emër] dot i dhemb zemra"*, *"Tash do ta shohësh shpejt se sa dot vjen dhurata jote edhe e dikujt tjetër që do ti dhemb zemra [emër]"*, *"Të dua në hënë nëse shkon ... nuk asht von"*



*kthehu të lutem mos nigo vëllezër e nan e motra se ke burr e fëmi*"; (iii) nga të gjitha provat ishte vërtetuar pa dyshim se P.N., e kishte vrarë bashkëshorten e tij me dashje direkte dhe vajzën e tij me dashje eventuale; dhe (iv) viktimat ishin në dhomë dhe *"i akuzuari P. i ka parë shumë mirë"*.

Ndaj vendimit të Gjykatës Themelore parashtruan ankesë prokuroria, pala e dëmtuar dhe kryesi P.N.

Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR.nr.457/20] më 29 janar 2021, përmes të cilit aprovoi ankesat e prokurorisë dhe të të dëmtuarve dhe refuzoi ankesën e kryesit P.N., si të pabazuar. Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e Gjykatës Themelore vetëm përkitazi me cilësimin ligjor dhe dënimin përkatës, duke e shpallur kryesin P.N. fajtor për (i) veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafi 1.11 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit të ri, përkatësisht të Kodit Penal të vitit 2019, për vrasjen e rëndë *"me dashje kryen dy apo më shumë vrasje"*; dhe (ii) për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Gjykata e Apelit e dënoi kryesin me dënim unik prej tridhjetë (30) vitesh burgim.

Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të numëruara nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi se *"edhe pse [Gjykata Themelore] i ka konstatuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat i ka gjetur tek i akuzuari, të njëjtat nuk i ka vlerësuar realisht, pastaj, ka edhe rrethana tjera rënduese që nuk i ka marr parasysh dhe atë sidomos faktin se i akuzuari edhe më parë është sjellë në mënyrë të dhunshme me bashkëshorten e tij, tani të ndjerën V.N, se pastaj, veprën penale e ka kryer në shtëpinë e familjes së të ndjerës V. e cila atje ka shkuar për të kërkuar mbrojtjen nga familja e saj, pastaj, vepra penale në fjalë është kryer në prezencën e nënës së të ndjerës V. por, edhe në praninë e vëllezërve të saj dhe fëmijëve të tani të ndjerës V. e duke marr parasysh edhe rrethanat, se i akuzuari përveç, që ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij-pra, anëtarin e familjes, i njëjti po ashtu, ka privuar nga jeta edhe fëmijën-pra, vajzën e tij të mitur, pastaj, se viktimat në fjalë me as të vetmin veprim nuk i kanë kontribuar kryerjes së veprës penale, por, edhe vendosmërinë e të akuzuarit, për kryerjen e veprës penale..."*.

## 1.5 Sanksioni penal

Përmes vendimit përfundimtar, përkatësisht Aktgjykimit [PAKR.nr.457/20] të 29 janarit 2021 të Gjykatës së Apelit, kryesi P.N., u dënua me tridhjetë (30) vite burgim.



### Komentim i shkurtër:

Siç u theksua më lart, krimi është kryer në vitin 2018, kur ishte në fuqi Kodi Penal i vitit 2012. Siç theksohet në pjesën përkatëse të këtij raporti, ndryshe nga Kodi Penal i vitit 2019, i cili në nenin 173 (Vrasja e rëndë) të tij, parashikon vrasjen e motivuar në bazë të gjinisë, ky nuk ishte rasti me Kodin Penal të vitit 2012. Prandaj, në thelb, ndonëse me disa modifikime në shkallë të dytë, vrasja është cilësuar në bazë të nenit 179 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2012, përkatësisht (i) për "*privim nga jeta të fëmijës*", "*privim nga jeta të anëtarit të familjes*" dhe "*kryerje me dashje e dy apo më shumë vrasjeve...*", në bazë të përcaktimeve të Gjykatës Themelore; ndërsa (ii) vetëm për "*kryerjen me dashje të dy apo më shumë vrasjeve...*", bazuar në përcaktimet e Gjykatës së Apelit. Kjo e fundit, nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm se përse ka zgjedhur vetëm njërin nga bazat e vrasjes së rëndë, ndërsa ka eliminuar dy bazat e para, përkatësisht, "*privimin nga jeta të fëmijës*" dhe "*privimin nga jeta të anëtarit të familjes*".

Thënë këtë, dhe ndërkohë që Kodi Penal i vitit 2012 nuk parashikonte bazën për ta cilësuar krimin si vrasje të rëndë të motivuar në bazë të gjinisë, duke pasur parasysh motivin e vrasjes dhe rrethanat e kryerjes së saj, ky rast ilustron një rast tipik që bie nën përkufizimin e pranuar përgjithësisht të femicidit. Vrasjes i kishte paraprirë dhuna prej vitesh e kryesit ndaj bashkëshortes. Këtë e dinte familja e tyre e gjerë, përfshirë edhe autoritetet shtetërore. Në kontekstin e këtyre të fundit, duhet theksuar se (i) kryesi kishte vuajtur tashmë një paraburgim tridhjetë (30) ditor për dhunë në familje; dhe (ii) policia ishte informuar për ngjarjet, kërcënimet, përfshirë mesazhet që i ishin dërguar viktimës në ditën e vrasjes së saj. Më tej, ngjarjet që i paraprinë vrasjes, tregojnë qartë se kryesi kishte humbur kontrollin mbi gruan e tij, e cila refuzoi të kthehej në martesë, gjë që kishte rezultuar me ndjenjën e refuzimit dhe poshtërimit, si dhe me dëshirën për ta ndëshkuar atë, të cilën ai edhe e kishte deklaruar qartë, përfshirë në ditën kur ajo u vra. Kjo gjendje mendore dhe sjellje e kryesit është, ndër të tjera, rezultat i një sistemi patriarkal vlerash dhe rolesh stereotipike gjinore.

Këto rrethana mund të ishin marrë parasysh nga gjykatat në vlerësimin ndërmjet rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe, për rrjedhojë, në përcaktimin e dënimit. Në fakt, përderisa Gjykata Supreme e ktheu çështjen në rigjykim kryesisht për shkak të administrimit të pranimit të fajësisë gjatë gjykimit të parë në nivel të Gjykatës Themelore, çështja kryesore ndërmjet vendimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit ndërli dhej me përcaktimin e dënimit në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Të dy gjykatat dështuan të balanconin siç duhet këto rrethana.

Në këtë kontekst, fillimisht duhet theksuar se, sipas nenit 73 (Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit) të Kodit Penal të vitit 2012, *"Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit."*<sup>[83]</sup> Në këtë aspekt, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, i publikuar më 15 shkurt 2018 (në tekstin e mëtejme: Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore), pranon se një nga problemet që është i pranishëm *"ka të bëjë me dështimin e gjykatave që të përshkruajnë në mënyrë adekuate arsyet për shqiptimin e dënimit të caktuar"*, i cili, ndër të tjera, përshkruhet si një mangësi sistematike dhe se *"[problemi] rëndohet edhe më shumë kur rrethana lehtësuese të paarsyetuara përdoren për të arsyetuar një dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për atë veprë"*.<sup>[84]</sup> Përveç kësaj, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore parashikon, ndër të tjera, se *"Gjetja e ndonjë rrethane rënduese apo lehtësuese e cila nuk mbështetet me asnjë fakt në shkresa gjithashtu është shkelje e ligjit ... Rrjedhimisht dështimi i gjykatës për të paraqitur bazën faktike për vërtetimin e ndonjë rrethane të caktuar mund të shihet si aktgjykim i bazuar në fakte jashtë shkresave të lëndës apo i pabazuar në fakte. Kjo rezulton në vendime të cilat duken arbitrare."*<sup>[85]</sup> Ndërkohë që Kodi Penal

[83] Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, supra note 39, neni 73 (Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit).

[84] Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, i nxjerrë në 15 shkurt 2018, f. 10, i disponueshëm në: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing%20Guidelines\\_February%202018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing%20Guidelines_February%202018.pdf).

[85] Ibid., f. 11.

u jep gjykatave një diskrecion të gjerë për të vlerësuar rrethanat përkatëse lehtësuese dhe rënduese, pasi normat përkatëse nuk janë tërësisht të saktësuara, por edhe të karakterit orientues, komentari i Kodit Penal shpjegon gjithashtu se kjo nuk do të thotë se gjykatave u lejohej të jenë arbitrare në matjen dhe/ose përcaktimin e dënimit, por që duhet të arsyetohet në bazë të dispozitave materiale të ligjit në fuqi.<sup>[86]</sup>

Në dritën e sa më sipër, duhet theksuar se në rigjykim, Gjykata Themelore konstatoi se rrethanat lehtësuese përfshinin (i) "*gjendjen ekonomike dhe familjare të të akuzuarit*"; (ii) "*moshën*"; (iii) "*sjelljen korrekte në gjykatë*"; dhe (iv) "*pendimin për veprën e kryer penale*". Ndërsa në ndryshimin e pjesëshëm të vendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, theksoi se "*gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka konstatuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat i ka gjetur tek i akuzuari, të njëjtat nuk i ka vlerësuar realisht, pastaj, ka edhe rrethana tjera rënduese që nuk i ka marr parasysh dhe atë sidomos...*", por ajo nuk shtjelloi më tej rrethanat lehtësuese, duke u fokusuar vetëm në rrethanat rënduese. Kjo gjuhë krijon hapësirë për interpretim, sepse nuk është e qartë nëse Gjykata e Apelit është pajtuar/pjesërisht nuk është pajtuar apo nuk është pajtuar plotësisht me gjetjet e Gjykatës Themelore lidhur me rrethanat lehtësuese. Megjithatë, katër rrethanat lehtësuese të marra në konsideratë nga Gjykata Themelore dhe të pashtjelluara më tej nga Gjykata e Apelit, meritojnë vëmendje, për arsyt e mëposhtme:

- (i) "*gjendja ekonomike dhe familjare e të akuzuarit*", përkatësisht kryesit të veprës penale, bazuar në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, nuk është dashur të konsiderohet si rrethanë lehtësuese në këtë rast. Kjo pasi, sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, gjykatat zakonisht marrin parasysh "*gjendjen familjare*" të të akuzuarit dhe ndikimin që mund të

[86] Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, (Botim 1), f. 255, i disponueshëm në: [\\*Microsoft Word - 140402\\_Komentari - Kodi Penal i Kosoves-version final.doc \(rks-gov.net\)](https://rks.gov.net).

ketë burgimi tek të tjerët, veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijë të vegjël dhe i akuzuari është prind i vetëm.<sup>[87]</sup> Sidoqoftë, sipas Udhëzuesit, “Nëse ndonjë anëtar i familjes është viktimë e veprës së kryerësit, atëherë nuk duhet të ketë zbutje për rrethanat familjare të cilat kanë të bëjnë me viktimën apo të cilat vënë anëtarët tjerë të familjes në rrezik.”<sup>[88]</sup> Në vlerësimin e “gjendjes familjare” dhe nëse ajo duhet të kualifikohet si rrethanë lehtësuese, sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, pyetjet që janë relevante për gjykatat përfshijnë “Sa serioze është vepra dhe cilat janë lëndimet nëse ka të tilla?” dhe “A është ndonjë anëtar i familjes i përfshirë si viktimë?”<sup>[89]</sup> Përgjigja në të dy këto pyetje në rrethanat e rastit dhe në dritën e shpjegimeve të dhëna në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, sqaron se “gjendja familjare” nuk ka mundur të përdoret si faktor lehtësues. Nga ana tjetër dhe për sa i përket “gjendjes ekonomike” të kryesit, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, ndër të tjera, parashikon që (a) në disa raste, puna stabile ose e kaluara e mirë në punë mund të ketë një ndikim pozitiv në vepra të cilat janë më pak të rënda, sepse perspektiva e ardhshme ekonomike e të pandehurit mund të shkatërrohet, nëse ai dërgohet në burg për një periudhë të shkurtër kohore; megjithatë (b) gjykatat mund ta konsiderojnë këtë si një rrethanë të parëndësishme, duke argumentuar se “sidomos kur ka shkallë të mjaftueshme të fajësisë, se kryesi ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për dënimin e mundshëm që mund të rezultojë nga kryerja e veprës, përfshirë humbjen e punës, dhe prapëseprapë ka vendosur t’i shpërfillë pasojat.”<sup>[90]</sup> dhe (c) “me rritjen e seriozitetit të veprës gjykatat duhet t’i japin më pak vlerë kësaj rrethane. Kjo vlen posaçërisht për krimet e dhunshme”.<sup>[91]</sup> Në fakt, “gjendja ekonomike” e kryesit zakonisht merret në konsideratë kur shqiptohen

[87] Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, supra note 84, f. 113.

[88] Ibid., f. 114.

[89] Ibid., f. 115.

[90] Ibid., f. 112.

[91] Ibid., f. 113.

gjyba, konkretisht, sipas nenit 73 (Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit) të Kodit Penal të vitit 2012, “me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit..”<sup>[92]</sup> Prandaj, në bazë të sa më sipër, për shkak të peshës së veprës penale në këtë rast dhe ashpërsisë së pasojave të shkaktuara – ku kryesi P.N., vrau gruan dhe vajzën e tij të mitur, rrezikoi jetën e anëtarëve të tjerë të familjes në shtëpi, si dhe shkaktoi traumë të rëndë për shumë persona të përfshirë, veçanërisht për fëmijët e mbetur që duhet të jetojnë me këtë për tërë jetën e tyre – “familja dhe gjendja ekonomike” e kryesit të veprës penale nuk është dashur të konsiderohet si rrethanë lehtësuese në bazë të vetë Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore;

- (ii) “*Mosha e të akuzuarit*” po ashtu nuk është dashur të konsiderohet si rrethanë lehtësuese në këtë rast. Kjo për shkak se sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, (a) “*për ta vlerësuar si duhet rrethanën e ‘moshës së re’ i zbaton elementet si personaliteti i brishtë, pa përvojë, i papjekur apo naiv duhet të merren parasysh; ngjashëm me këtë, rrethana e ‘moshës së vjetër’ duhet të vlerësohet në lidhje me shëndetin, pafuqinë, sëmundjen e kështu me radhë*”<sup>[93]</sup>; dhe (b) me rastin e vlerësimit nëse mosha duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, duhet përcaktuar nëse “*kryesi ka qenë nën moshën 18 vjeçare apo mbi 65 vjeçare*”. Prandaj, në mënyrë që kjo rrethanë të jetë e zbatueshme, kryesi duhet të mos ketë qenë në gjendje të kuptojë në mënyrë adekuate natyrën e sjelljes së tij për shkak të moshës së re, ose, për shkak të shëndetit të keq dhe moshës së vjetër të kryesit, ka pak gjasa që ai/ajo të mund të kthehet në shoqëri.<sup>[94]</sup> Kryesi

[92] Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, supra note 39, neni 73 (Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit).

[93] *Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore i Kosovës*, supra note 84, f. 118.

[94] *Ibid.*, f. 118.

ishte në të dyzetat kur kreu veprën dhe rrethanat qartazi nuk bëjnë pjesë në asnjërën nga kategoritë e përshkuara në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore për sa i përket përdorimit të moshës së të akuzuarit si rrethanë lehtësuese;

- (iii) E njëjta vlen për "*sjelljen korrekte në gjykatë*" dhe "*pendimin për veprën e kryer penale*", të cilat nuk është dashur të konstatohen si rrethana lehtësuese në këtë rast dhe/ose aplikimi i tyre është dashur të arsyetohet me kujdes. Kjo sepse sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, (a) "*Kërkohet vëmendje në rastet e dhunës në familje, duke e pasur para sysh dinamikën e përgjithshme të marrëdhënies së dhunshme. Sjellja e kryerësit si rregull në këto vepra penale nuk duhet të ketë kurrfarë peshe për zbutjen e dënimit;*"<sup>[95]</sup> (b) "*Dorëzimi vullnetar zbehet substancialisht kur procedurat janë të natyrës familjare*"; dhe (c) "*Në përgjithësi, deklaratat apo kërkimfaljet nga i pandehuri duhet të shikohen me skepticizëm pasi që pendimi i rrejshëm mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës së pranishme në marrëdhëniet e dhunës në familje.*"<sup>[96]</sup> Ky Udhëzues qartazi nuk është marrë parasysh nga Gjykata Themelore dhe e Apelit kur përdorën dy bazat e lartpërmendura si rrethana lehtësuese. Çështja e pendimit dhe njohja e tij si rrethanë lehtësuese, meriton vëmendje. Përderisa Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore thekson se ai mund të jetë një faktor lehtësues i rëndësishëm, i njëjti duhet të analizohet në dritën e përpjekjeve përkatëse për të ulur ndikimin dhe rrethanat e përgjithshme të rastit. Pyetja e parë që duhet t'i jepet përgjigje në përcaktimin e peshës së pendimit në kuptim të faktorëve lehtësues, sipas Udhëzuesit për politikën ndëshkimore, është nëse "*viktima ka mbijetuar*". Posa që përgjigja në këtë pyetje të jetë negative, pyetjet e tjera të renditura në listën kontrolluese përkatëse, humbasin peshën e nevojshme, gjë që kërkon arsyetim specifik për t'u përdorur në mbështetje të këtij faktori të veçantë lehtësues;

[95] Ibid., f. 151.

[96] Ibid., f. 132.

- (iv) mungesa e vlerësimit të pranisë së fëmijëve në vendin e ngjarjes si një faktor specifik rëndues po ashtu meriton vëmendje. Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore potencon në mënyrë specifike se gjykata duhet ta konsiderojë fuqishëm këtë faktor rëndues në rastet kur (a) fëmija apo dëshmitarët (e tjerë) kanë qenë fizikisht të pranishëm kur ka ndodhur dhuna; (b) fëmija apo dëshmitarët (e tjerë) nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm, por kanë qenë në gjendje të dëgjojnë dhunën/keqtrajtimin; dhe (c) fëmija apo dëshmitarët (e tjerë) nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm dhe nuk kanë mundur të dëgjojnë dhunën/keqtrajtimin, por kanë parë pasojat e saj më vonë. Më tej, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, thekson në mënyrë specifike se nëse fëmija është i pranishëm në shtëpi gjatë veprës, Gjykata duhet, edhe një herë, të shqyrtojë të kaluarën në fjalë dhe ndikimin mbi fëmijën, duke vënë gjithashtu në dukje se edhe nëse vepra për të cilën ngrihet akuza, nuk përfshin veprë penale për veprime drejtpërdrejtë ndaj fëmijës, prania e fëmijës mund të konsiderohet faktor rëndues, pasi fëmija do të jetë viktimë shtesë. Posa të përcaktohet prania, Gjykata do të duhet të përcaktojë shkallën e dëmtimit dhe të marrë në konsideratë shkallën e ashpërsimit të duhur, ngjashëm sikurse me konsideratat në raport me viktimën primare. Vlen të theksohet se në rrethanat e rastit, viktima është vrarë në shtëpinë e vëllait të saj së bashku me vajzën e saj tetëvjeçare, përfshirë në praninë e fëmijëve të tjerë dhe anëtarëve të familjes. Përderisa aktgjykimet e gjykatave i referohen faktit që fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes ishin të pranishëm, kjo rrethanë nuk u mor parasysh dhe/ose nuk u theksua mjaftueshëm nga asnjëra prej gjykatave. Gjithashtu, duhet theksuar se Konventa e Stambollit, kërkon njohjen se fëmijët janë viktima të dhunës në familje, duke përfshirë edhe si dëshmitarë të dhunës në familje. Më tej, dhe sipas nenit 26 të saj (Mbrotjtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë), palët duhet të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe të mbështetjes për viktimat, të merren në konsideratë të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë të të gjitha formave të dhunës që përfshihen në fushëveprimin e Konventës.



Një çështje tjetër që meriton vëmendje është zbatimi i Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të vitit 2015. Kjo, ndër të tjera, për shkak se Gjykata (i) urdhëroi të pandehurin P.N., që të paguajë taksën prej 50 Euro sipas nenit 39 (Financimi i Kompensimit të Viktimave të Krimit) të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të vitit 2015; dhe (ii) me kusht që *“në bazë të nenit 463, par.2 të KPPK-së, i dëmtuari udhëzohet të realizojë kërkesën pasurore në procedurë kontestimore”*. Megjithatë, aktgjykimet nuk përmbanin asnjë informacion përkitazi me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimeve, përkatësisht nenet 9 (Qasja e menjëhershme në kompensimin e viktimës) dhe nenet 10 (Obligimi për të kërkuar paraprakisht dëmshpërblim nga i pandehuri), në bazë të të cilit viktimat mund të kërkojnë qasje në kompensim, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin e lartpërmendur. Gjithashtu duhet theksuar se sfidat në zbatimin e ligjeve në fuqi për kompensimin e viktimave të krimit janë adresuar, ndër të tjera, përmes raporteve të ndryshme të shoqërisë civile, duke përfshirë por pa u kufizuar, në ato të publikuara nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, konkretisht për i) Dështimin e gjykatave në mbushjen e Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, publikuar në vitin 2020; (ii) Sfidat e zbatimit të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, publikuar në vitin 2021; dhe (iii) Kompensimin e viktimave të dhunës në familje, botuar në vitin 2023.<sup>[97]</sup> Në këtë drejtim, duhet theksuar gjithashtu se paditë civile dhe çështjet e mjeteteve juridike dhe të kompensimit ngërthejnë detyrime pozitive të shtetit sipas neneve 29 (Paditë civile dhe mjetet ligjore) dhe 30 (Kompensimi) të Konventës së Stambollit.

[97] Shih (i) Dështimi i gjykatave në mbushjen e Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të publikuar në vitin 2020; (ii) Sfidat e zbatimit të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të publikuar në vitin 2021; dhe (iii) Kompensimi i viktimave të dhunës në familje të publikuar në vitin 2023 nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe të disponueshme në: (i) <https://kli-ks.org/deshtimi-i-gjykatave-ne-mbushjen-e-programit-per-kompensimin-e-viktimave-te-krimit/>; (ii) <https://kli-ks.org/sfidat-e-zbatimit-te-ligjit-per-kompensimin-e-viktimave-te-krimit/>; dhe (iii) <https://kli-ks.org/kompensimi-i-viktimave-te-dhunes-ne-familje/>.

Së fundi, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i saj, i obligon të gjitha autoritetet publike në Kosovë, që të interpretojnë të drejtat e njeriut në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Standardet e vendosura nëpërmjet kësaj të fundit, duke përfshirë detyrimet pozitive të shtetit që rrjedhin nga e drejta për jetën siç përcaktohet me nenin 25 [E drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe neni 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), janë referuar edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI41/12 të publikuar më 26 shkurt 2013, lidhur me vrasjen e D.K. Aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta në këtë rast, nuk iu referuan praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe as praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese në këtë drejtim.

Thënë këtë, dy aspekte të tjera të rastit në fjalë duhen theksuar në një kontekst pozitiv. Së pari, rasti është zgjidhur brenda një periudhe kohore prej dy vite e gjysmë (2,5 vite), ndërsa duhet të theksohet që rasti është gjykuar dy herë në nivelin e Gjykatës Themelore, dy herë në nivelin e Gjykatës së Apelit dhe një herë në Gjykatën Supreme, e cila e ktheu rastin në rigjykim, kryesisht për shkak të procesit në të cilin u administrua pranimi i fajësisë. Gjithashtu duhet theksuar se afatet e shkurtuara për hetimin dhe përfundimin e shqyrtimit gjyqësor siç parashikohet me ndryshimet e vitit 2023 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ishin të zbatueshme gjatë zhvillimit të procedurës në këtë rast. Së dyti, arsyetimi i gjykatave, në të gjitha aktgjykimet, nuk përmban ndonjë gjuhë degraduese ndaj viktimave.

## 2. Femicidi II: kryesi B.V., viktima A.V.

### 2.1 Përshkrim i shkurtër i rastit

Më 6 gusht 2019, rreth orës 23:18, kryesi B.V., vrau gruan e tij A.V., në rrugë, me armë të tipit Pietro Beretta Gardone, të cilën e posedonte ligjërisht. Sipas të dhënave të ofruara në aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta, ata ishin zënë gjatë ditës dhe ai kishte qenë fizikisht i dhunshëm ndaj saj. Për shkak të kësaj dhune, ajo kishte vendosur të largohej. Kur B.V., u zgjua dhe pa se gruaja e tij nuk ishte në shtëpi, ai mori armën dhe doli nga shtëpia për ta kërkuar atë. Viktima

A.V., ishte afër shtëpisë, duke e pritur taksin që e bija e kishte thirrur. Kur kryesi B.V., e pa atë, ai iu ofrua dhe e qëlloi pesëmbëdhjetë (15) herë, katërmbëdhjetë (14) prej të cilave e kishin qëlluar trupin e saj në pjesë të ndryshme, duke filluar nga koka, qafa, gjoksi dhe këmbët, duke rezultuar me vdekjen e menjëhershme të saj. Një dëshmitar dëshmoi se pas gjuajtjeve, kryesi iu afrua viktimës dhe e quajti *"kurvën e nënës"*. Pas vrasjes, kryesi B.V., e mbuloi viktimën me një leckë dhe vazhdoi të thërrasë motrën e gruas së tij duke i thënë asaj *"mirëmbërëma N. këtu B. në telefon... e vrava motrën tënde, më vjen keq, por nuk munda më, ishte mjaftë, nuk munda më"*. Ai, po ashtu, thirri të vëllain dhe djalin e tij, duke u treguar se vrau viktimën A.V.

## 2.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit

Sipas të dhënave të disponueshme në aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta, kryesi B.V., ishte shofer taksie i shtresës së mesme ekonomike, i cili ishte i divorcuar nga gruaja e tij e parë, me të cilën kishte tre (3) fëmijë. Ai nuk kishte raporte të mira me fëmijët e tij që nga divorci, me përjashtim të djalit më të madh. Sipas vajzave të viktimës, marrëdhënia mes çiftit ishte e mirë deri dy javë para vrasjes, kur ato *"vërejtën ndryshim në sjelljen e kryesit ndaj viktimës, ai ushtroi kontroll ndaj saj dhe ishte agresiv"*. Sipas dëshmitave ditën e vrasjes, kryesi B.V., e kishte rrahur viktimën A.V., dhe e kishte kërcënuar me armë, për çka ajo u kishte treguar të bijave dhe u kishte kërkuar t'ia thërrisnin një taksi.

Kryesi B.V., e mohoi të kishte kryer vrasjen me dashje, duke thënë, ndër të tjera, se për shkak të gjendjes shumë nervoze dhe afektit, *"para syve të tij është paraqitur një katror i zi"*. Mirëpo, gjatë procesit gjyqësor është kryer ekzaminimi i shëndetit mendor, sipas të cilit nuk ka rezultuar se ai ka pasur çrregullime mendore apo sëmundje mendore të cilësisë psikotike, nuk ka prapambetje mendore, çrregullime mendore organike apo abuzim me substanca narkotike, si dhe nuk kishte çrregullim të një natyre të shkurtër ose një gjendje tronditjeje të thellë mendore dhe se afekti dhe aftësia mendore për të kontrolluar dhe kuptuar veprimet e veta, ishte ruajtur.

## 2.3 Të dhënat për viktimën

Sipas të dhënave të disponueshme në aktgjykimet e gjykatave të rregullta, viktima A.V., ishte një e ve, së cilës i kishte vdekur burri i parë në një aksident dhe ajo kishte rritur e vetme dy vajzat e saj. Pas disa vitesh ajo u takua me kryesin B.V., u martuan dhe u shpërngulën në Zvicër. Ajo nuk kishte një punë dhe sipas dëshmitave ishte e pakënaqur me jetën në Zvicër dhe kishte shprehur dëshirën për t'u kthyer në Kosovë.

## 2.4 Procedura penale

Kryesi B.V., vrasjen e ka kryer më 6 gusht 2019. Prokuroria, më 28 shkurt 2020, ngriti aktakuzën [PP/I.nr.134/19] ndaj kryesit B.V., për (i) kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, përkatësisht "*privimi nga jeta i një anëtar i familjes*"; dhe për (ii) veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) i Kodit Penal të vitit 2019.

Gjykata Themelore, më 1 tetor 2021, nxori aktgjykimin [P.nr.13/20] me të cilin kryesin B.V. e ka shpallur fajtor për (i) veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të 2019, përkatësisht "*privimi nga jeta i një anëtar i familjes*; dhe (ii) veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) i Kodit Penal të vitit 2019. Ai u dënua me burgim të përjetshëm.

Bazuar në të dhënat që dalin nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore, sipas dëshmive të vajzave të viktimës, në natën kritike, nëna kishte telefonuar njërën nga vajzat, duke kërkuar ndihmë dhe duke thënë se "*unë më këtu nuk rri, po më dhembë qafa dhe nga veshi po më qet gjak dhe një taksi le të vjen me më marrë*". Gjithashtu, sipas dëshmive, ajo i kishte thënë vajzës tjetër se "*po mam qashtu është më ka rre, po më qetë veshi gjak, më ka kapë për fyti dhe mu ka kërcënuar me allti*". Gjithashtu, gjatë procedurës, avokati mbrojtës i vajzave, ndër të tjera, deklaroi se "*Duhet të merret parasysh një fakt tejet i rëndësishëm dhe atë dhimbja e shkaktuar palës së dëmtuar, dy vajzave të së ndjerës A. V., të cilat duke dashur lumturinë e nënës së tyre kanë pranuar të jetojnë ndaras prej saj dhe atë nga mosha 15 vjeçare, kurse tash nuk e kanë asnjërin prind që t'u ofrojë mbështetje prindërore dhe ngrohtësi familjare dhe kanë mbetur pa asnjërin prind. Po ashtu dhimbje e shkaktuar motrës së të ndjerës, ku pas vrasjes në mënyrë mizore, me gjakftohtësi e thërret dhe i thotë "ta vrava, ajo vdiq"*.

Ndërkaq, avokati mbrojtës i kryesit B.V., ka deklaruar, ndër të tjera, se (i) "*mungon dashja, por rasti ka ndodhur për shkaqe tjera të motivuara me konflikte verbale në mes tyre pa i vlerësuar pasojat ligjore dhe fatale duke ardhur në një gjendje tejet nervoze dhe të afektit, në sytë e të cilit i ka ra terri dhe i është paraqitur një katror i zi, andaj konsideron se mungon elementi i dashjes pasi që gjithnjë e arsyeton se të ndjerën e paska dashur shumë, mirëpo sjelljet e saj të paarsyeshme nuk ka mundur t'i pranohet por është penduar për gabimet*"; (ii) viktima A.V.,

"Asnjëherë nuk ka punuar në Zvicër, ajo jetonte nga të ardhurat e të akuzuarit B."; dhe (iii) "Natën kritike me sjelljet dhe provokimet e paarsyeshme të A. me telefonin në fytirën e tij dhe me refuzimin që ai ta qojë në Prishtinë me kerrin e tij dhe përdorimi i fjalëve kundërshtuese, tek i akuzuari B. janë krijuar aty për aty ndjenjat e pamatura të nervozitetit dhe ankthit të cilat kanë ndikuar te ai që të ndërmarrë aktin e rrezikshëm deri te privimi nga jeta të bashkëshortes".

Gjykata Themelore e dënoi kryesin me burgim të përjetshëm dhe në sqarimin e rrethanave rënduese, ndër të tjera, theksoi se: (i) "rreziku shoqëror, duke shikuar përmes rrethanës e cila është element i veprës penale i shprehur në masë më të madhe se sa është e nevojshme për ekzistimin e veprës penale dhe për kualifikimin e saj më të rëndë, konkretisht në viktimën është shtënë 15 herë deri në plumbin e fundit që kishte në pistoletë;" (ii) "shkalla e përgjegjesisë penale e kryesit ... kjo duke marrë parasysh të menduarit e pjekur dhe të gjatë për kryerjen e veprës që del nga suazat e dashjes, në rastin konkret pas shprehjes së pakënaqësisë në jetën bashkëshortore, pas një mosmarrëveshjeje ditën kritike dhe pas largimit të saj nga shtëpia, i akuzuari në të vërejtur mungesën e saj nga shtëpia, nga dy revole që i kishte në shtëpi, një me leje dhe një pa leje të organit kompetent, me vete e merr revolen pa leje dhe i vendosur për veprimet e tij, niset pas saj e pasi e gjen dhe pasi e ofendon me fjalë "kurvën e nanës", e realizon vendimin"; (iii) "shkalla e përgjegjesisë penale të kryesit, e cila mund të shihet si shkalla e përgjegjesisë, shkalla e rrezikimit të vlerës së mbrojtur"; (iv) "pasojat e kryerjes së veprës penale; rrethanat nën të cilat është kryer vepra, që vlerësohet me mënyrën e kryerjes së veprës penale duke pasur parasysh kohën e natës kur viktima ka qenë e pambrojtur dhe pa prituri se mund t'i ndodh diç e tillë; (v) "mënyra tinëzare e kryerjes së veprës kur ai së pari shtënë në shpinë e pasi rrëzohet viktima, vazhdon edhe më tej me 14 shtënie të tjera në kokë dhe nëpër pjesën e epërme të trupit"; (vi) "sjellja e kryesit pas kryerjes së veprës penale e shprehur me qëndrimin e tij gjakftohtë kur nga çanta e saj nxjerr një fustan dhe e mbulon e pastaj pa humbur kohë i thërret vëllain, djalin dhe motrën e viktimës sa për t'i informuar thjesht se e ka vrarë bashkëshorten"; (vii) "sjellja e tij gjatë gjithë kohës së procedurës pa treguar keqardhje për viktimën, përkundrazi shpreh keqardhje për vetveten duke arsyetuar veten se në një moment i ka ndodhur diçka e pashpjegueshme kur para syve i është paraqitur një katror i zi në të cilin ka shtënë, duke kërkuar të gjykohet me dënim më të butë edhe për shkak të sëmundjes, moshës dhe se e presin nipat e mbesat, duke mos menduar fare për moshën relativisht të re të viktimës dhe se edhe ajo ka lënë nipa e mbesa"; (viii) "qëndrimi i tij jo korrekt ndaj vajzave të viktimës, të cilat pas vdekjes aksidentale të babait tani kanë mbetur edhe pa nënën e shkëputur nga jeta e tyre me dorën e tij në mënyrë tinëzare, të cilat i ngushëllon se nuk kanë mbetur pa prind duke u ofruar dashuri të cilën ka pasur, ka dhe do të ketë për to"; (ix) "në fund edhe intensiteti i dhimbjes shpirtërore të vajzave të viktimës, të cilat

*pasi mamaja ka kërkuar ndihmë, janë munduar në çdo mënyrë ta shpëtonin ... por në vend se ta shpëtonin, ato kanë kuptuar lajmin për humbjen e personit më të dashur, të vetmit prind, të vrarë nga personi të cilit i kanë besuar dhe konsideruar si prind.”* Gjykata Themelore nuk ka gjetur ndonjë rrethanë lehtësuese.

Vendimi i Gjykatës Themelore u apelua nga kryesi B.V.

Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR.nr.16/22] më 25 shkurt 2022, me të cilin e ndryshoi pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe kryesin e dënoi me dënim unik prej njëzet e pesë (25) vite burgim për të dyja veprat penale. Gjykata e Apelit, në shtjellimin e baraspeshimit ndërmjet rrethanave lehtësuese dhe rënduese, ndër të tjera, konstatoi se (i) në këtë rast *“në këtë çështje penalojuridik ka edhe rrethana lehtësuese që gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marr parasysh”*; (ii) *“kur është fjala për rrethanat rënduese, përveç, që disa nga ato që gjykata e shkallës së parë, i ka konsideruar si rrethana rënduese, kanë të bëjnë me elementet përbërëse të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, disa nga rrethanat tjera rënduese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, në fakt janë rrethana lehtësuese e jo rënduese dhe atë sidomos, sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, kur i njëjti e merr një shami nga viktima dhe e mbulon kufomën, rrethanë kjo e cila nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese, pastaj, mënyra tinëzare-dinake e kryerjes së veprës penale, po ashtu, gabimisht është marr si rrethanë rënduese, ngase, në bazë të mënyrës së vërtetuar të kryerjes së veprës penale të vrasjes, nuk rezulton se vrasja është kryer në mënyrë dinake – tinëzare sikur që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, po ashtu, fakti se i akuzuari pas kryerjes së veprës penale derisa ka pritur ardhjen e policisë, në ndërkohë ka informuar familjarët e tij por, edhe të tani të ndjerës, nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese si dhe përfundimisht mënyra e mbrojtjes së të akuzuarit përkitazi me kryerjen e veprës penale, kur deklaroi se në momentin kritik i është paraqitur një katror i zi para syve të tij dhe nuk e din më se si ka vepruar, pra, duke dashur kështu që ta eliminojë dashjen si element i veprës penale të vrasjes, nuk guxon të merret si rrethanë rënduese”*; dhe (iii) *“ka rrethana lehtësuese të cilat, e njëjta-pra, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marr fare parasysh, se është baba i 3 fëmijëve, i moshës relativisht të vjetër, se është penduar, ka kërkuar falje dy vajzave të tani të ndjerës, por, njëkohësisht edhe falje publike-pra, në seancën publike të kolegjit të kësaj gjykate, nuk ka qenë i dënuar më parë, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, sidomos, momenti kur i akuzuari e merr një shami nga tani e ndjera dhe e mbulon kufomën e saj dhe duke pritur ardhjen e policisë, në vendin e ngjarjes në ndërkohë i njofton familjarët për rastin në fjalë”*. Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit konstatoi se dënimi me burgim të përjetshëm nuk ishte i përshtatshëm, duke e dënuar kryesin me njëzet e pesë (25) vite burgim.

Prokuroria paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.268/2022] të datës 7 korrik 2022.

## 2.5 Sanksioni penal

Përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.16/22] të 25 shkurtit 2022, Gjykata e Apelit dënoi kryesin me njëzet e pesë (25) vite burgim.



### Komentim i shkurtër:

Siç u theksua më lart, krimi është kryer në vitin 2019, kur ishte në fuqi Kodi Penal i vitit 2019. Siç theksohet në seksionin përkatës të këtij raporti, ndryshe nga Kodi Penal i vitit 2012, i cili në nenin 179 (Vrasja e rëndë) të tij, nuk parashihte që motivimi që rezultoi në vrasje në bazë të gjinisë, të përbënte vrasje të rëndë, Kodi Penal i vitit 2019, në nenin 173 (Vrasja e rëndë) të tij, parasheh vrasje me motivimin që lidhet me gjininë. Vepra penale në rrethanat e këtij rasti është cilësuar si "*vrasje e rëndë, vrasje e anëtarit të familjes*", siç parashikohet nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019.

Thënë këtë, duke pasur parasysh motivin e vrasjes dhe rrethanat e kryerjes së saj, ky rast ilustron një rast tipik që bie nën përkufizimin e pranuar përgjithësisht të femicidit.

Vrasjes i ka paraprirë dhuna në familje; ngjarjet që i paraprinë vrasjes tregojnë qartë se kryesi kishte humbur kontrollin mbi gruan e tij, gjë që, ndër të tjera, i shkaktoi atij ndjenjë refuzimi dhe poshtërimi, një gjendje sjelljeje e cila, ndër të tjera, është edhe rezultat i një sistemi vlerash patriarkale dhe roleve stereotipike gjinore. Këto rrethana mund të ishin marrë parasysh nga gjykatat përkatëse në kualifikimin e veprës penale në dritën e ndryshimeve të bëra në Kodin Penal të vitit 2019. Gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh risinë e paraqitur në nënparagrafin 1.10 të paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasje e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, përkatësisht privimin nga jeta të një personi tjetër motivuar në bazë të gjinisë. Më tej, çështja parësore ndërmjet vendimeve

të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit ka të bëjë me caktimin e dënimit në vlerësimin e rrethanave përkatëse lehtësuese dhe rënduese. Derisa Gjykata Themelore e dënoi kryesin me burgim të përjetshëm, duke mos identifikuar rrethana lehtësuese, Gjykata e Apelit e uli dënimin në njëzet e pesë (25) vite burgim, duke vënë në dukje një sërë rrethanash lehtësuese, të cilat meritojnë vëmendje.

Edhe pse Gjykata e Apelit vërejt se disa nga rrethanat rënduese të konstatuara nga Gjykata Themelore *"kanë të bëjnë me elementet përbërëse të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor"*, nuk ka sqaruar se cilave rrethana iu është referuar. Më tej, konstatoi se *"përfundimisht mënyra e mbrojtjes së të akuzuarit lidhur me kryerjen e veprës penale, kur deklaroi se në momentin kritik i është shfaqur një katror i zi para syve dhe ai nuk e di më se si ka vepruar, prandaj duke dashur të eliminojë dashjen si element të veprës penale të vrasjes, [Gjykata] nuk guxon ta marrë si rrethanë rënduese"*. Pavarësisht kësaj deklarate të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duhet theksuar se sipas (i) Komentarit të Kodit Penal, ndër të tjera, *"elementi objektiv shprehet në shkaktimin e vuajtjeve dhe dhimbjeve të mëdha ndaj viktimës, ndërsa elementi subjektiv në vetëdijen dhe dëshirën, përkatësisht kënaqësinë e kryesit për të shkaktuar dhimbje dhe vuajtje të tilla"*; dhe (ii) Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, *"mënyrë veçanërisht mizore do të kishte kur vepra përfshin shkaktimin e paarsyeshëm të dhimbjes dhe mizorisë dukshëm përtej asaj që përdoret zakonisht në kryerjen e një vepre të tillë"*. Pavarësisht sa më sipër, Gjykata e Apelit konstatoi se *"nuk rezultoi se vrasja është kryer në mënyrë dinake – tinëzare, siç konstatoi gjykata e shkallës së parë"*. Aktgjykimi përkatës nuk e shtjelloi më tej arsyen pse u konstatua se vrasja nuk ishte kryer në mënyrë tinëzare.

Më tej, në lidhje me rrethanat lehtësuese, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, vuri në dukje (i) *"gjendjen ekonomike dhe familjare të të akuzuarit"*; (ii) *"moshën e të akuzuarit"*; dhe (iii) *"sjelljen korrekte para gjykatës"* dhe *"pendimin për veprën penale të kryer"*. Arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk e justifikon përdorimin e të lartpërmendurave si rrethana lehtësuese, kryesisht për shkak se bazuar në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore:



- (i) në vlerësimin e “*gjendjes familjare*” dhe nëse duhet cilësuar si rrethanë lehtësuese, pyetjet që janë relevante për gjykatat përfshijnë “*Sa e rëndë është vepra penale dhe cilat janë lëndimet, nëse ka?*” dhe “*A përfshihet ndonjë anëtar i familjes si viktimë?*”<sup>[98]</sup>. Përgjigja për të dyja këto pyetje në rrethanat e rastit dhe në dritën e shpjegimeve të dhëna në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, sqaron se “*gjendja familjare*”, nuk mund të ishte përdorur si faktor lehtësues, veçanërisht për shkak të peshës së veprës penale në këtë rast dhe ashpërsisë së pasojave të shkaktuara – ku kryesi vrau gruan e tij si dhe krijoi një traumë të rëndë për shumë të përfshirë, veçanërisht për fëmijët e mbetur të cilët duhet të jetojnë me këtë gjatë gjithë jetës së tyre;
- (ii) as në këtë rast “*mosha e të akuzuarit*” nuk është dashur të konsiderohet si rrethanë lehtësuese. Kjo sepse, sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore dhe siç u përmend më lart, (a) “*për të vlerësuar siç duhet situatën e ‘moshës së re’ duhet të merren parasysh elementë të tillë si personaliteti i brishtë, i papërvollë, i papjekur ose naiv; në mënyrë të ngjashme, rrethanat e ‘pleqërisë’ duhet të vlerësohen në lidhje me shëndetin, mungesën e forcës, sëmundjen e kështu me radhë.*”<sup>[99]</sup>; dhe (b) kur vlerësohet nëse mosha duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, duhet të përcaktohet nëse “*kryerësi ishte nën 18 vjeç ose mbi 65 vjeç*”. Prandaj, në mënyrë që kjo rrethanë të jetë e zbatueshme, kryesi duhet të mos ketë qenë në gjendje të kuptojë në mënyrë adekuate natyrën e sjelljes së tij për shkak të moshës së re, ose, për shkak të shëndetit të keq dhe moshës së vjetër të kryesit, ka pak mundësi që ai/ajo të mund të kthehet në shoqëri.<sup>[100]</sup> Kryesi, sipas informacioneve të disponueshme në aktgjykimet përkatëse të gjykatave, nuk bën pjesë në kategoritë e mësipërme të moshave kur ka kryer veprën penale, ndërsa rrethanat e tjera qartazi nuk përkrijnë në

[98] Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore i Kosovës, supra note 84, f. 115.

[99] Ibid., f. 118.

[100] Ibid., f. 118.

asnjerën nga kategoritë e përshkruara në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, sa i përket përdorimit të moshës së të akuzuarit si rrethanë lehtësuese;

- (iii) e njëjta gjë vlen edhe për "*sjelljen korrekte para gjykatës*" dhe "*pendimin për veprën penale të kryer*", të cilat nuk duhet të ishin konstatuar si rrethana lehtësuese, sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, sepse (a) "*vëmendje kërkohet në rastet e dhunës në familje, duke pasur parasysh dinamikën e përgjithshme të marrëdhënies së dhunshme. Si rregull, sjellja e kryesit në këto vepra penale nuk duhet të ketë peshë për zbutjen e dënimit;*" <sup>[101]</sup> (b) "*dorëzimi vullnetar zvogëlohet ndjeshëm kur procedurat janë të natyrës familjare*"; dhe (c) "*në përgjithësi, deklaratat ose kërkim-faljet nga i pandehuri duhet të shihen me skepticizëm pasi pendimi i rremë mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës të pranishme në marrëdhëniet e dhunës në familje*". <sup>[102]</sup> Këto udhëzime nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit kur përdori dy bazat e lartpërmendura si rrethana lehtësuese. Arsyetimi i Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, se kryesi (i) u ka kërkuar falje vajzave të viktimës; (ii) mbuloi trupin e viktimës me shall pas vrasjes; dhe (iii) ka thirrur anëtarët e familjes për t'i informuar për vrasjen, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore. Çështja e pendimit dhe konsiderimi i tij si një faktor lehtësues, si në rastin e mëparshëm, meriton vëmendje. Përderisa Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore thekson se ai mund të jetë faktor lehtësues i rëndësishëm, i njëjti duhet të analizohet në dritën e përpjekjeve përkatëse për të minimizuar ndikimin dhe rrethanat e përgjithshme të rastit. Pyetja e parë që duhet përgjigjur në përcaktimin e peshës së pendimit në kuptim të faktorit lehtësues, sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, është nëse "*viktima ka mbijetuar*". Pasi përgjigja në këtë pyetje është negative, pyetjet e tjera të renditura në listën kontrolluese përkatëse humbasin peshën

[101] Ibid., f. 151.

[102] Ibid., f. 132.

e nevojshme, duke kërkuar arsyetim specifik për t'u përdorur në mbështetje të këtij faktori të veçantë lehtësues.

Së fundi, mungesa e referencës në Ligjin e vitit 2015 për Kompensimin e Viktimave të Krimin dhe mosreferimi në detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës bazuar në Kushtetutë dhe KEDNJ, siç elaborohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese, mbeten të vlefshme si në rastin e mëparshëm të elaboruar më sipër. Thënë këtë, duhen vënë në dukje dy veçori të tjera të rastit përkatës. Së pari, rasti u zgjidh brenda një periudhe kohore dy vite e gjysmë (2.5 vite). Gjithashtu duhet theksuar se afatet e shkurtuara për hetimin dhe përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të parashikuar nga ndryshimet e vitit 2023 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ishin të zbatueshme gjatë zhvillimit procedurave për këtë rast. Së dyti, arsyetimet e gjykatave, në të gjitha aktgjykimet, nuk përmbanin ndonjë gjuhë degraduese ndaj viktimës.

### 3. Femicidi III: kryesi S.Q., viktima L.Q.

#### 3.1 Përshkrim i shkurtër i rastit

Më 1 korrik 2021, rreth orës 5:00, kryesi S.Q., i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore gruas së tij, në atë mënyrë që, pas keqkuptimeve të shumta që kishin, kryesi e kishte marrë një çarçaf dhe ia kishte ndrydhur qafën gruas me të, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore viktimës. Më 1 janar 2022, kryesi S.Q., kishte kryer krimin e dhunës në familje, nga paragrafi 1 i nenit 248 (Dhuna në familje) të Kodit Penal të vitit 2019. Sipas të dhënave të cilat i përmbajnë aktgjykimet përkatëse të gjykatave, ai e kishte fyer atë, duke i thënë: *"dil jashtë nga shtëpia, sepse je duke më tradhtuar"* në prani të të birit, i cili e kishte raportuar rastin në polici. Më 5 janar 2022, rreth orës 1:30, kryesi S.Q., e kishte vrarë viktimën L.Q., në shtëpinë e tyre. Kryesi i kishte kërkuar vajzës së tij të mitur që t'i sillte një gotë ujë, dhe pasi që ajo kishte shkuar ta merrte, ai e kishte qëlluar gjashtë (6) herë dhe e kishte vrarë gruan e vet L.Q., me një revole të markës Zoraki, duke e qëlluar në qafë, nën sqetull, në anën e majtë dhe të djathtë të gjoksit, në kofshë dhe në dorë.

### 3.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit

Gjatë procedurës në gjykatën e shkallës së parë, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, kryesi, mes tjerash, kishte deklaruar se *"i kishte kryer të gjitha veprat penale për të cilat ishte akuzuar në aktakuzë"* dhe më pastaj *"iu kishte kërkuar falje të dy familjeve, në veçanti fëmijëve të vet dhe shpreson që një rast si ky të mos përsëritet më kurrë."* Sipas përfaqësuesit ligjor të viktimës, *"i akuzuari më parë e kishte rrahur dhe keqtrajtuar viktimën dhe si rezultat i kësaj fëmijët e tyre të përbashkët kishin vuajtur pasojat."* Gjykata po ashtu kishte konstatuar se kryesi *"kishte qenë në gjendje mendore normale në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht kishte qenë i aftë për ta kuptuar domethënien e aktit të tij dhe për të menaxhuar me veprimet e veta, për arsye se gjatë zhvillimit të procedurës penale deri më tani nuk është vënë në pah asnjë rrethanë e cila do të hidhte dyshime në aftësinë mendore të të akuzuarit."* Përfundimi i sipërpërmendur ishte mbështetur në Raportin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike, i cili sa i përket shëndetit mendor të kryesit, theksonte se *"i njëjti nuk vuan nga çrregullimi psikotik, se nuk është konstatuar se i akuzuari ishte i retarduar në aspektin mendor, se në kohën e kryerjes së veprës penale, aftësia e të akuzuarit për të kuptuar dhe për të kontrolluar veprimet e veta ishte e ruajtur, se ai është i aftë për t'u konsultuar me persona të tjerë dhe se mund të merrte pjesë në shqyrtimin gjyqësor, për shkak se nuk është gjetur asnjë element i natyrës psikologjike, i cili do të kishte ndikuar në validitetin e deklaratave të tij."*

### 3.3 Të dhënat për viktimën

Nuk ka të dhëna për viktimën në aktgjykimet e gjykatave të rregullta.

### 3.4 Procedura penale

Prokuroria e ka ngritur Aktakuzën [KT.I. Nr. 2/22] më 12 maj 2022, kundër të pandehurit S.Q., për veprat penale (i) lëndim i lehtë trupor nga paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 dhe 1, pika 1.4 e nenit 185 (Lëndimi i lehtë trupor) të Kodit Penal të vitit 2019; (ii) dhunë në familje nga paragrafi 1 i nenit 248 (Dhuna në familje) të Kodit Penal të vitit 2019; (iii) vrasje e rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019; dhe (iv) mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) i Kodit Penal të vitit 2019.

Në Aktgjykimin [K. nr. 127/22] të Gjykatës Themelore, të nxjerrë më 12 shtator 2022, kryesi është shpallur fajtor për (i) veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 dhe 1, pikën 1.4 të nenit 185 (Lëndimi i lehtë

trupor) të Kodit Penal të vitit 2019, për shkak të dhunës fizike të ushtruar më 1 korrik 2021; (ii) veprën penale të dhunës në familje nga paragrafi 1 i nenit 248 (Dhuna në familje) të Kodit Penal të vitit 2019, për dhunën psikologjike të ushtruar më 1 janar 2022; (iii) veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, për vrasjen e gruas të tij më 5 janar 2022; dhe (iv) për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve) i Kodit Penal të vitit 2019. Gjykata Themelore i ka shqiptuar kryesisht dënimin unik prej njëzet e katër (24) vitesh burgim.

Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, gjatë balancimit të rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese me qëllim të përcaktimit të dënimit në fjalë, sa i përket rrethanave rënduese, është theksuar se (i) *“gjykata e ka marrë parasysh sjelljen e mëhershme të të akuzuarit ndaj viktimës, e cila ka qenë gruaja e tij, ku viktima është keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht për një kohë të gjatë”*; (ii) *“që vepra penale “Vrasja e rëndë” nga Neni 173, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Kodit Penal, përveç që është kryer ndaj një anëtari të familjes, gjë e cila përbën element të figurës së veprës penale të sipërpërmendur, po ashtu është kryer në mënyrë tinëzare, për arsye se viktima është qëlluar 6 (gjashtë) herë duke shtënë në të me revole në praninë e të bijës së tyre të mitur”*; si dhe (iii) *“fakti që i akuzuari i ka kryer të gjitha veprat penale me dashje direkte si shkalla më e lartë e lidhjes psikologjike të kryerësit të veprës penale me veprën e tij”*. Ndërsa, sa iu përket rrethanave lehtësuese, është theksuar (i) *“bashkëpunimi në përgjithësi i të akuzuarit me gjykatën dhe me organet e ndjekjes penale, ku i sipërpërmenduri, menjëherë pas kishte kryer veprën penale ... ishte dorëzuar në polici”*; (ii) *“pendimi i sinqertë që i akuzuari e kishte shfaqur gjatë shqyrtimit gjyqësor”*; (iii) *“fakti që i akuzuari nuk është dënuar më herët përpara”*; dhe (iv) *“që kishte pranuar kryerjen e veprave penale për të cilat ngarkohej me aktakuzë”*.

Edhe pse prokuroria dhe mbrojtja e kryesit të veprës penale, kishin ushtruar ankesë ndaj vendimit, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR. Nr. 595/22] i kishte refuzuar ankesat dhe e kishte konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

### 3.5 Sanksioni penal

Në Aktgjykimin [K. Nr. 127/22] e datës 12 shtator 2022 të Gjykatës Themelore, kryesi ishte dënuar me dënim unik prej njëzet e katër (24) vitesh burgim.



### Komentim i shkurtër:

Siç u theksua më lart, ky krim është kryer në vitin 2021, kur ishte në fuqi Kodi Penal i vitit 2019. Siç është theksuar në pjesën përkatëse të këtij raporti, ndryshe nga Kodi Penal i vitit 2012, Kodi Penal i vitit 2019, në nenin 173 (Vrasja e rëndë), e përcakton vrasjen duke u bazuar në motivimin që lidhet me gjininë. Vepra përkatëse penale, në rrethanat e këtij rasti, është cilësuar si një "*vrasje e rëndë, vrasje e anëtarit të familjes*", siç përcaktohet në nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019.

Thënë këtë, sa i përket motivit të vrasjes dhe rrethanave të kryerjes së saj, ky rast ilustron një rast tipik, i cili bie nën përkufizimin përgjithësisht të pranuar të femicidit. Vrasja është paraprirë nga dhuna në familje, së paku në dy raste që dihen dhe janë raportuar, përkatësisht (i) më 1 korrik 2021; dhe (ii) më 1 janar 2022, gjatë të cilave ai e kishte akuzuar gruan se "*është duke e tradhtuar*", duke pasqyruar mes tjerash, një sjellje që është rezultat i një sistemi patriarkal të vlerave dhe role stereotipike gjinore. Katër ditë më vonë, ajo u vra në shtëpinë e vet. Këto rrethana kanë mundur të merren parasysh nga gjykatat përkatëse gjatë cilësimit të veprës penale në dritën e ndryshimeve të bëra në Kodin Penal të vitit 2019. Gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh risinë e sjellë në nënparagrafin 1.10 të paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, përkatësisht privimin e personit tjetër nga jeta e tij/saj për shkak të motivimit të bazuar në gjini.

Më tej, gjatë balancimit të rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese me qëllim të përcaktimit të dënimit, janë dy veçori të cilat vlen të përmenden, konkretisht (i) rrethanat kontradiktore lehtësuese dhe rënduese që lidhen me sjelljen e mëhershme dhe dënimet e kryesit; dhe (ii) mungesa e vlerësimit të pranisë së fëmijëve si një faktor rëndues. Lidhur me të parin, duhet të theksohet se gjykatat si rrethanë rënduese kanë gjetur "*sjelljen e mëhershme të të akuzuarit ndaj viktimës, e cila ishte gruaja e tij, kur viktimja për një kohë të gjatë është keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht*", përderisa në të njëjtën kohë, ata kanë gjetur si rrethanë lehtësuese, "*faktin që i akuzuari, deri më tani, nuk ka qenë i*

*dënuar më parë*". Së pari, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore në mënyrë specifike përcakton që e kaluara e mëparshme kriminale, në qoftë se nuk kemi të bëjmë me recidivizëm, pak merret parasysh gjatë përcaktimit të dënimit. Së dyti, kur kemi të bëjmë me dënimet e mëhershme penale, mes tjerash, theksohet se rëndësia e sjelljes së mëparshme të të akuzuarit përbën një faktor kompleks që ka implikime enorme në ndikimet shoqërore, pasurinë etj. Po që se gjykata vlerëson se mungesa e dënimeve të mëparshme penale mund të konsiderohet rrethanë lehtësuese, kjo gjë do të kërkojë gjetjen e fakteve që mbështesin konkluzionin për sjellje respektuese dhe predispozitën për rehabilitim. Ky nuk ishte rasti në arsyetimin e aktgjykimeve të gjykatave. Nga ana tjetër, dhe lidhur me të dytën, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore në mënyrë specifike përcakton që gjykata duhet ta marrë parasysh fuqishëm këtë faktor rëndues në rastet, në të cilat, mes tjerash, gjatë ushtrimit të dhunës kanë qenë të pranishëm fizikisht dëshmitarët fëmijë. Më tutje, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore në mënyrë specifike përcakton se në qoftë se në shtëpi është i pranishëm fëmija gjatë kryerjes së veprës penale, gjykata, duhet patjetër edhe një herë, ta shqyrtojë historinë e përfshirjes dhe ndikimin në fëmijë, po ashtu duke theksuar se edhe në qoftë se krimi i ngarkuar nuk përmban ndonjë vepër penale për veprime të drejtpërdrejta kundër fëmijës, vetë prania e fëmijës mund të konsiderohet faktor rëndues, pasi që fëmija do të jetë viktimë shtesë. Pasi të jetë konstatuar prania, gjykata do të duhet të përcaktojë shkallën e lëndimit dhe të shqyrtojë shkallën e duhur të rëndimit, të ngjashme me shqyrtimet kundër viktimës primare. Duhet të theksohet se në rrethanat e rastit në fjalë, viktimja është vlarë në shtëpi, në praninë e vajzës së mitur, së cilës i është kërkuar të sillte një gotë me ujë, pikërisht para se i ati të shtinte gjashtë (6) herë mbi të ëmën e saj. Kjo rrethanë nuk është marrë parasysh në mënyrë specifike dhe të mjaftueshme nga asnjëra gjykatë.

Përveç kësaj, sikur edhe në rastet e tjera studimore, çështja e keqardhjes/pendesës dhe marrja parasysh e saj si një faktor lehtësues, meriton vëmendje. Edhe pse Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore thekson që ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm lehtësues, i njëjti duhet të analizohet në dritën e përpjekjeve

përkatëse për ta minimizuar ndikimin dhe rrethanat e përgjithshme të këtij rasti. Pyetja e parë, së cilës duhet t'i jepet përgjigje gjatë përcaktimit të peshës së keqardhjes lidhur me faktorin lehtësues, në bazë të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore është nëse "*viktima ka mbijetuar*". Pasi përgjigjja në këtë pyetje të jetë negative, pyetjet e tjera të radhitura në listën përkatëse kontrolluese e humbin peshën e domosdoshme, duke kërkuar arsyetim specifik në mënyrë që të përdoren për mbështetjen e pikërisht këtij faktori lehtësues. Për më tepër, në bazë të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, deklarimet apo kërkimi i faljes nga i pandehuri duhet të shihen me skepticizëm ngase keqardhja/pendesa e rrejshme mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës së pranishme në raportet e dhunës në familje.

Në fund, mungesa e referencës në Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimin të vitit 2015, dhe mungesa e referencës në detyrimet pozitive të shtetit me qëllim të mbrojtjes së të drejtës në jetë, duke u bazuar në Kushtetutë dhe në KEDNJ, siç është shtjelluar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, vlejné sikur në dy rastet studimore të mëhershme, të përmendura më lart. Thënë këtë, edhe dy veçori tjera të rastit në fjalë, duhet të theksohen. Së pari, rasti në fjalë është zgjidhur brenda një periudhe prej shtatë (7) muajsh. Po ashtu duhet të theksohet që afatet e shkurtuara për hetime dhe përfundim të shqyrtimit gjyqësor, siç përcaktohen me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të vitit 2023, nuk kanë qenë të aplikueshme gjatë procedimit të këtij rasti, edhe pse rasti është trajtuar brenda afateve të përcaktuara me të njëjtin. Së dyti, arsyeimi i gjykatave, në të gjitha aktgjykimet, nuk përmbante ndonjë gjuhë degraduese ndaj viktimave.

## 4. Femicidi IV: kryesi N.M., viktima S.M.

### 4.1 Përshkrim i shkurtër i rastit

Më 25 qershor 2020, rreth orës 12:00, kryesi N.M., e kishte vrarë bashkëshorten S.M., në shtëpinë e tyre. Në bazë të detajeve të dhëna në aktgjykimet e gjykatave të rregullta, kryesi dhe viktima fillimisht janë fjalosur e më pas kryesi me një shufër metalike me gjatësi prej 73cm dhe trashësi 2.2cm, e ka goditur bashkëshorten në dorë dhe në kokë, si rezultat i të cilës ajo është rrëzuar në tokë. Kryesi N.M.,



pastaj ka vazhduar ta godasë bashkëshorten disa herë në kokë, dhe në pjesë tjera të trupit, duke i shkaktuar lëndime të rënda dhe gjakderdhje masive viktimës, e cila pastaj vdiq si rezultat i plagëve të marra. Fëmijët e mitur të kryesit dhe të viktimës kanë qenë të pranishëm në shtëpi kur ka ndodhur vrasja. Sipas detajeve të dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, vërehet se kryesi (i) është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dyzet (40) ditësh, për shkak të veprës penale, “*shkaktim i rrezikut të përgjithshëm...*”, përmes një aktgjykimi të 31 tetorit 2014; dhe (ii) është shpallur fajtor për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor kundër viktimës, përkatësisht gruas së tij, përmes një aktgjykimi të 3 janarit 2019.

#### 4.2 Personaliteti dhe sjellja e kryesit

Në bazë të informatave në dispozicion në aktgjykimet e gjykatave të rregullta, kryesi ishte në fillim të dyzetave kur e kreu vrasjen; ai ishte i gjendjes së varfër ekonomike dhe kishte të kryera vetëm katër klasë të shkollimit fillor. I njëjti më herët kishte qenë i dhunshëm ndaj gruas së tij, dhe kishte një rast të raportuar në polici. Njëri nga dëshmitarët po ashtu kishte dëshmuar se ai kishte qenë i dhunshëm në shumë raste edhe ndaj fëmijëve të tij. Edhe pse ai ka deklaruar se nuk e ka kryer vrasjen me dashje, në bazë të ekzaminimit psikiatrik, “*nuk është gjetur çrregullim apo sëmundje mendore e kualitetit psikotik, prapambetjes mendore apo çrregullimit mendor për shkak të abuzimit me substanca psikoaktive, nuk ka histori të trajtimit në aspektin psikiatrik, ashtu që në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet, nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i penguar nga elemente psikike të cilat dëmtojnë aftësinë mendore që të kuptojë rëndësinë e veprës si dhe aftësinë e kontrollit të veprimeve të tij.*” Gjatë seancave dëgjimore, ai ka deklaruar se viktimja e kishte goditur para vrasjes, megjithatë gjykata përkatëse këtë pretendim e ka konstatuar të pambështetur në prova.

#### 4.3 Të dhënat për viktimën

Viktima dhe kryesi kishin qenë të martuar pesë (5) vite dhe kishin tre (3) fëmijë së bashku, një katërvjeçare, një dyvjeçare dhe një gjashtëmuajsh. Ata ishin martuar përmes shkuesisë.

#### 4.4 Procedura penale

Aktakuza [PP.I. Nr. 91/2020] kundër kryesit është ngritur më 24 shtator 2020 për veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019.

*(i) gjykimi i parë*

Në vendimin e Gjykatës Themelore [PKR. Nr. 105/2020], të nxjerrë më 4 dhjetor 2020, Gjykata ka shpallur fajtor të pandehurin N.M., për veprën penale të vrasjes së rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, dhe e ka dënuar me burgim të përjetshëm. Ky vendim është apeluar nga i pandehuri dhe më pastaj është anuluar përmes vendimit [PAKR. Nr. 42/2021] të Gjykatës së Apelit, të nxjerrë më 24 shkurt 2021. Sipas Gjykatës së Apelit, vendimi i Gjykatës Themelore ka qenë në kundërshtim me dispozitat materiale për shkak se deklarata e të pandehurit nuk është dashur të konsiderohet si pranim i fajësisë, pasi që i pandehuri ka deklaruar se ai e kishte kryer veprën në gjendje të tronditjes mendore, duke shtuar më pastaj se duke e pasur parasysh këtë, Gjykata Themelore është dashur të kërkojë mendimin e ekspertit të psikiatrisë për ta bërë vlerësimin e gjendjes së tij mendore në kohën e kryerjes së krimit.

*(ii) rigjykimi*

Përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PKR. Nr. 105/2020] të shpallur më 5 tetor 2021 dhe të publikuar më 1 nëntor 2021, i pandehuri është shpallur fajtor për vrasje të rëndë nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, përkatësisht për *"privimin nga jeta të anëtarit të familjes"*. Sipas këtij Aktgjykimi, rrethanë lehtësuese kanë qenë (i) *"sjellja e tij korrekte në gjykatë, kërkimi i faljes dhe lajmërimi i policisë"*; ndërsa, si rrethana rënduese është vlerësuar (ii) *"shkalla e lartë e dashjes nga ana e të akuzuarit, meqenëse i njëjti bazuar në provat e administruara në gjykata, del se veprimet e tij i kishte ndërmarrë me dashje ashtu siç janë shpjeguar më lartë, po ashtu i njëjti nuk është ofruar fare për të tentuar për të ofruar ndihmë, pas kryerjes së veprës penale, apo për të thirrur shërbimet shëndetësore, si rrethanë rënduese për të akuzuarin mori edhe karakteristikat e tij personale si dhe sjelljen e mëparshme të tij, ku i lartpërmenduri me aktgjykimin ... e plotfuqishëm të datës 03.01.2019, është shpallur fajtor ... për lëndim të lehtë trupor ... ku viktimë ka qenë tani e ndjera S.M., po ashtu më 31.10.2014, i akuzuari i lartcekur është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 40 ditëve, për shkak të veprës penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm ... po ashtu si rrethanë rënduese gjykata e ka marrë për bazë faktin se si rezultat i veprimeve të tij ku është shkaktuar edhe pasoja, fëmijët e mitur i ka lënë pa nënë, ashtu që të njëjtit do të rriten në mungesë të dashurisë së ofruar nga prindi, respektivisht nënës, e cila tani është e ndjerë, si rezultat i veprimeve të të akuzuarit."*

Edhe pse kryesi N.M., kishte apeluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit ia kishte refuzuar ankesën dhe e kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës

Themelore [PAKR. nr.534/21], të nxjerrë më 21 janar 2022. Kryesi i veprës penale po ashtu ka parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të cilin Gjykata Supreme e ka refuzuar përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 112/2022] të datës 31 mars 2022.

#### 4.5 Sanksioni penal

Me Aktgjykimin [PKR. nr. 74/2021] e datës 5 tetor 2021 të Gjykatës Themelore, kryesi N.M., ishte dënuar me njëzet e pesë (25) vite burgim.



#### Komentim i shkurtër:

Siç u theksua më lart, ky krim është kryer në vitin 2020, kur ishte në fuqi Kodi Penal i vitit 2019. Siç është theksuar në pjesën përkatëse të këtij raporti, ndryshe nga Kodi Penal i vitit 2012, Kodi Penal i vitit 2019, në nenin 173 (Vrasja e rëndë), e përcakton vrasjen duke u bazuar në motivimin që lidhet me gjininë. Vepra përkatëse penale, në rrethanat e këtij rasti, është cilësuar si një "vrasje e rëndë, vrasje e anëtarit të familjes", siç përcaktohet në nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019.

Thënë këtë, sa i përket motivit të vrasjes dhe rrethanave të kryerjes së saj, ky rast ilustron një rast tipik, i cili bie nën përkufizimin përgjithësisht të pranuar të femicidit. Vrasja është paraprirë nga dhuna në familje, së paku në dy raste, të cilat janë të njohura për autoritetet dhe të vërtetuara nga gjykatat e rregullta, përkatësisht përmes (i) Aktgjykimit të 31 tetorit 2014; dhe (ii) Aktgjykimit të 3 janarit 2019. Këto rrethana kanë mundur të merren parasysh nga gjykatat e rregullta kur është bërë cilësimi i veprës penale në dritën e ndryshimeve të bëra në Kodin Penal të vitit 2019. Gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh risinë e sjellë në nënparagrafin 1.10 të paragrafit 1 të nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, përkatësisht privimin e personit tjetër nga jeta e tij/saj për shkak të motivimit të bazuar në gjini.

Më tej, gjatë balancimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese me qëllim të përcaktimit të dënimit, janë dy veçori të cilat vlen

të përmenden: (i) mungesa e keqardhjes/pendesës si faktor lehtësues; dhe (ii) mungesa e vlerësimit të pranisë së fëmijës si faktor rëndues. Përkitazi me veçorinë e parë, sikur është theksuar edhe në rastet e mëparshme studimore, çështja e keqardhjes/pendesës dhe marrja parasysh e saj si një faktor lehtësues, meriton vëmendje. Edhe pse Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore thekson që ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm lehtësues, i njëjti duhet të analizohet në dritën e përpjekjeve përkatëse për ta zvogëluar ndikimin dhe rrethanat e përgjithshme të këtij rasti. Pyetja e parë, së cilës duhet t'i jepet përgjigje gjatë përcaktimit të peshës së keqardhjes/pendesës lidhur me faktorin lehtësues, në bazë të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore është nëse "viktima ka mbijetuar". Pasi përgjigja në këtë pyetje është negative, pyetjet e tjera të radhitura në listën përkatëse kontrolluese e humbin peshën e domosdoshme, duke kërkuar arsyetim specifik në mënyrë që të përdoren për mbështetjen e pikërisht këtij faktori lehtësues. Pastaj, në bazë të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, deklarimet apo kërkimi i faljes nga i pandehuri duhet të shihen me skepticizëm ngase keqardhja/pendesa e rrejshme mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës së pranishme në raportet e dhunës në familje. Ndërsa kur kemi të bëjmë me veçorinë e dytë, përkatësisht praninë e fëmijës, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore në mënyrë specifike përcakton që gjykata duhet ta marrë parasysh fuqishëm këtë faktor rëndues në rastet, në të cilat, mes tjerash, gjatë ushtrimit të dhunës kanë qenë të pranishëm fizikisht dëshmitarët fëmijë dhe se në rrethana të tilla, gjykata, duhet patjetër edhe një herë, ta shqyrtojë historinë e përfshirjes dhe ndikimin në fëmijë, po ashtu duke theksuar se edhe në qoftë se krimi i ngarkuar nuk përmban ndonjë vepër penale për veprime të drejtpërdrejta kundër fëmijës, vetë prania e fëmijës mund të konsiderohet faktor rëndues, pasi që fëmija do të jetë viktimë shtesë, në mënyrë të ngjashme siç konsiderohet viktima primare. Duhet të theksohet se në rrethanat e rastit, viktima është vrarë në mënyrë brutale brenda shtëpisë së tyre, në të cilën kanë qenë të pranishëm fëmijët e tyre. Kjo rrethanë nuk është marrë parasysh në mënyrë specifike dhe substanciale nga asnjëra gjykatë.

Në fund, mungesa e referencës në Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të vitit 2015, dhe mungesa e referencës në detyrimet pozitive të shtetit me qëllim të mbrojtjes së të drejtës në jetë, duke u bazuar në Kushtetutë dhe në KEDNJ, siç është shtjelluar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, vlejnë sikur në tri rastet e mëparshme studimore, të analizuara më lart. Thënë këtë, edhe dy veçori tjera të rastit në fjalë, duhet të theksohen. Së pari, rasti në fjalë është zgjidhur brenda një periudhe prej një viti e gjysmë. Po ashtu duhet të theksohet që afatet e shkurtuara për hetime dhe përfundim të shqyrtimit gjyqësor, siç përcaktohen me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale të vitit 2023, nuk kanë qenë të aplikueshme gjatë procedimit të këtij rasti. Së dyti, arsyetimi i gjykatave, në të gjitha aktgjykimet, nuk përmbante ndonjë gjuhe degraduese ndaj viktimës.

# » V. TË GJETURAT KRYESORE DHE REKOMANDIMET

## 1. Të gjeturat kryesore

Qëllimi parësor i këtij hulumtimi/raporti ishte analiza e praktikës gjyqësore të disponueshme në Republikën e Kosovës lidhur me privimin e dhunshëm nga jeta të grave, të kryer nga burrat, përkatësisht femicidin. Siç është theksuar në raport, legjislacioni ekzistues në Kosovë nuk e përcakton femicidin si vepër penale të pavarur dhe/ose të veçantë. Megjithatë, Kodi Penal i miratuar në vitin 2019, ka përparuar në këtë drejtim, ndër të tjera, duke parashikuar një rrethanë të re që e cilëson vrasjen në vrasje të rëndë, në bazë të gjinisë dhe/ose identitetit gjinor. Prandaj, (i) për qëllime të identifikimit të rasteve të femicidit dhe/ose femicidit në tentativë, u aplikuan përkufizimet përgjithësisht të njohura të femicidit; ndërsa (ii) për qëllime të identifikimit të rasteve studimore përkatëse, është përdorur cilësimi ligjor i vrasjes dhe/ose vrasjes në tentativë, të motivuar në bazë të gjinisë, duke i cilësuar kështu vrasjet përkatëse si vrasje të rënda.

Më tej dhe në kuptim të statistikave të disponueshme, duke marrë parasysh se Databaza Nacionale vazhdon të mos ketë statistika të besueshme për dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, dhe veçanërisht për femicidin dhe/ose femicidin në tentativë, për qëllimet e këtij raporti, janë përdorur të dhëna/informacione zyrtare të ofruara nga Policia e Kosovës. Në aplikimin e përkufizimeve të femicidit në të dhënat/informacionet e ofruara nga Policia, rezultoi se gjatë periudhës 2018-2022, në Republikën e Kosovës, mund të kenë ndodhur njëzet (20) femicide dhe katër (4) femicide në tentativë. Në anën tjetër, sa i përket aktgjykimeve të formës së prerë në dispozicion për periudhën e lartpërmendur, vetëm katër (4) aktgjykime të formës së prerë ishin në dispozicion për studim. Përderisa institucionet e Kosovës dhe veçanërisht organizatat e shoqërisë civile, vendore dhe ndërkombëtare, në mënyrë specifike kanë analizuar, publikuar dhe rekomanduar fushat për përmirësim që kanë të bëjnë me dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore, përfshirë femicidin, qëllimi i këtij raporti të veçantë është kryesisht të analizojë zbatimin e legjislacionit të aplikueshëm në këtë fushë nga gjykatat e rregullta. Përderisa numri i aktgjykimeve të formës së prerë në dispozicion është mjaft i kufizuar, analiza e tyre hedh dritë në disa emërues të përbashkët, të cilët pasqyrojnë trende pozitive dhe negative që kanë të bëjnë me administrimin e rasteve të lidhura me femicidin nga gjykatat e rregullta. Në vijim do të përmbledhen

disa nga këto veçori, duke u fokusuar kryesisht në (i) legjislacionin në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe cilësimin ligjor përkatës të veprës penale; (ii) përcaktimin e dënimit, përkatësisht vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të rasteve përkatëse dhe zbatimin përkatës të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore të miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës; (iii) kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore përkatëse; dhe (iv) çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e palëve të dëmtuara.

Fillimisht dhe për sa i përket legjislacionit në fuqi, një (1) prej rasteve është administruar sipas dispozitave të Kodit Penal të vitit 2012, ndërsa tri (3) të tjera janë administruar sipas dispozitave të Kodit Penal të vitit 2019. Në asnjë prej rasteve, nuk ishin të aplikueshme ndryshimet e bëra në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, në vitin 2022 dhe 2023, respektivisht.

Për sa i përket cilësimit të veprave penale, të katër (4) rastet janë cilësuar si vrasje të rënda, qoftë sipas nenit 179 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2012, qoftë sipas nenit 173 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të vitit 2019, varësisht se cili ishte në fuqi në rrethanat e rasteve përkatëse. Në përcaktimin e kategorisë në bazë të së cilës vrasja përkatëse është cilësuar si e rëndë, në tri (3) raste është përdorur baza e "*privimit nga jeta të anëtarit të familjes*", ndërsa në një (1) prej tyre është përdorur baza e "*kryerjes me dashje të dy ose më shumë vrasjeve*". Përderisa në një rast që u administrua sipas dispozitave të Kodit Penal të vitit 2012, baza e privimit nga jeta të një personi tjetër motivuar në bazë të gjinisë, nuk ishte në dispozicion, pavarësisht se Kodi Penal i vitit 2019 e parashikon këtë mundësi, asnjë nga tri (3) rastet të cilat u administruan sipas dispozitave të Kodit të lartpërmendur, nuk është cilësuar si vrasje e rëndë e motivuar në bazë të gjinisë, pavarësisht faktit se të tri (3) rastet hyjnë në kategorinë e përkufizimit të pranuar përgjithësisht të femicidit. Siç është theksuar në mënyrë specifike në shtjellimin e secilit rast studimor përkatës, ato të gjitha kanë disa nga karakteristikat e përbashkëta si në vijim (i) viktimat u vranë nga burrat e tyre; (ii) përderisa vendimet e gjykatave të rregullta nuk adresojnë dhe/ose nuk arsyetojnë në mënyrë specifike detajet e motivit, të gjitha rastet duket se reflektojnë humbjen e kontrollit mbi gruan për shkak të largimit të saj nga martesja dhe/ose shtëpia dhe/ose nga xhelozia, duke shkaktuar ndjenja refuzimi dhe/ose poshtërimi të lidhura me sistemin patriarkal të vlerave dhe roleve stereotipike gjinore, ku një nga rastet përfshin paralajmërim/kërcënim specifik se gruaja do të vritet nëse ajo nuk kthehet në shtëpi; dhe (iii) përderisavetëm dy (2) raste, përfshijnë histori të mëparshme të dënimit për dhunë në familje, të gjitha rastet janë karakterizuar nga dhuna në familje para vrasjes. Gjithashtu duhet theksuar se vetëm në një (1) nga rastet, fëmijët nuk kanë qenë të pranishëm kur ka ndodhur krimi, ndërsa në tri (3) raste të tjera fëmijët

kanë qenë të pranishëm, ku një prej rasteve ka rezultuar edhe me vrasjen e një vajze tetë (8) vjeçare.

Duke marrë parasysh numrin e kufizuar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me çështjet që bien nën përkufizimin e pranuar përgjithësisht të femicidit që kanë ndodhur ndërmjet viteve 2018 dhe 2022, është e vështirë të arrihet në përfundimin për një emërues të përbashkët specifik dhe/ose tipare që do të shërbenin për të përcaktuar trendet përkatëse, e që janë të nevojshme edhe për hartimin e masave specifike për adresimin e dukurive respektive. Megjithatë, për aq sa mund të nxirren informacione nga aktgjykimet e gjykatave të rregullta, rezulton se (i) për sa i përket statusit martesor, në rrethanat e të katër (4) rasteve, viktima dhe kryesi kanë qenë të martuar, në tri (3) raste kanë pasur fëmijët e përbashkët, ndërsa në një (1) rast kanë pasur fëmijë nga martesat e mëparshme; (ii) për sa i përket profesionit/statusit të punësimit të kryesit, rastet pasqyrojnë familje me të ardhura të ulëta deri në të mesme, ku kryesit kanë qenë të vetëpunësuar ose të punësuar, kurse viktimat të papunësuar, ndërsa theksohet gjithashtu se vendimet e gjykatave të rregullta japin shumë pak informacione për viktimat; (iii) për sa i përket dënimeve të mëparshme, dy (2) nga rastet pasqyrojnë dënime të mëparshme që kanë të bëjnë me dhunën në familje, ndërsa dy (2) të tjerat, asnjë dënim formal paraprak pavarësisht se rrethanat e rasteve pasqyrojnë se ka pasur dhunë në familje; (iv) sa i përket mënyrës së kryerjes së veprës, tri (3) nga rastet ndërlidhen me të shtëna me armë, pra edhe me veprën penale të armëmbajtjes së paautorizuar dhe pa leje, ndërsa në një (1) rast vrasja është kryer me një shufër metalike; dhe (v) për sa i përket aftësisë mendore të kryesve, pavarësisht se mbrojtja pretendonte të kundërtën, institucionet përkatëse dhe rrjedhimisht gjykatat, konstatuan se kryesit e veprave penale në të gjitha rastet kanë qenë me aftësi të plotë mendore gjatë kryerjes së krimeve.

Përveç veçorive të shtjelluara më lart, emëruesi i përbashkët i rëndësishëm që rezulton nga analiza e katër (4) rasteve studimore, ka të bëjë në radhë të parë me përcaktimin e dënimeve, përkatësisht vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Përderisa dënimi mesatar me burgim për rastet e lartpërmendura është njëzet e gjashtë (26) vite burgim, vlerësimi i rrethanave përkatëse lehtësuese dhe rënduese, ndër të tjera, reflekton zbatim joadekuat të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore të miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Në kuptim të faktorëve/rrethanave lehtësuese, kjo lidhet kryesisht me përdorimin e (i) "*gjendjes ekonomike dhe familjare të të akuzuarit*"; (ii) "*moshës*"; dhe (iii) "*pendimit për veprën e kryer penale*"; ndërsa për sa i përket faktorëve/rrethanave rëndues, kjo lidhet në radhë të parë me dështimin e gjykatave përkatëse për të analizuar në mënyrë specifike praninë e fëmijëve në momentin e kryerjes së



vrasjeve përkatëse dhe për t'i dhënë peshën e nevojshme rënduese këtij fakti në përcaktimin e dënimit përkatës.

Më konkretisht, dhe lidhur me përdorimin e "*gjendjes ekonomike dhe familjare të të akuzuarit*", përkatësisht kryesisht të veprës penale, si faktor lehtësues, të gjitha rastet reflektojnë se Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore nuk është respektuar mjaftueshëm. Kjo pasi, duke marrë parasysh natyrën dhe rrethanat e krimeve përkatëse, dhe veçanërisht seriozitetin e veprës penale, pasojat dhe përfshirjen e anëtarëve të familjes në veprat penale përkatëse, Udhëzuesi i sipërpërmendur përjashtoi mundësinë e përdorimit të "*gjendjes familjare*" si rrethanë lehtësuese. Është theksuar tashmë se në të katër (4) rastet, viktimat janë vrarë nga bashkëshortët e tyre, ku tri (3) prej tyre kanë pasur të pranishëm fëmijë dhe anëtarë të tjerë të familjes. Më tej, "*mosha e të akuzuarit*", përkatësisht kryesisht të veprës penale, bazuar në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore, po ashtu duket se është aplikuar në mënyrë joadekuate si faktor lehtësues në rastet përkatëse. Siç vërehet në raport, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore është specifik për sa i përket rrethanave në të cilat "*mosha*" mund të përdoret si rrethanë lehtësuese dhe asnjë nga këto rrethana në këtë aspekt, nuk është përmbushur në rastet studimore përkatëse të analizuara. Së fundi, "*pendimi për veprën e kryer penale*", përderisa është rrethanë lehtësuese e rëndësishme në përcaktimin e dënimeve, sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, duhet të shqyrtohet me kujdes në rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në dritën e përpjekjeve përkatëse për të zvogëluar ndikimin. Në rastet e vrasjes së rëndë me motive gjinore, pendimi nuk duhet të përdoret vazhdimisht si rrethanë lehtësuese në përcaktimin e dënimit përfundimtar pa justifikimin dhe/ose arsyetimin e duhur dhe të domosdoshëm.

Nga ana tjetër, mungesa e vlerësimit të pranisë së fëmijëve në vendin e ngjarjes si rrethanë specifike rënduese po ashtu meriton vëmendje në tri (3) rastet studimore. Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore posaçërisht potencon se gjykata duhet ta konsiderojë fuqimisht këtë faktor rëndues në rastet kur, ndër të tjera, fëmija ka qenë fizikisht i pranishëm në momentin kur ka ndodhur dhuna, edhe nëse krimi nuk përfshin vepër penale për veprime të drejtuara kundër fëmijës. Sipas Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, gjykata do të duhet të përcaktojë shkallën e lëndimit dhe të marrë parasysh shkallën e duhur të ashpërsisë, ngjashëm me konsideratat në raport me viktimat primare. Siç theksohet në raport, kërkesa të ngjashme burojnë edhe nga Konventa e Stambollit në lidhje me të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë të të gjitha formave të dhunës.

Në fund, janë dy trende të tjera që duhen theksuar, konkretisht (i) kohëzgjatja e procedurave; dhe (ii) këshilla juridike e ofruar sa i përket kërkesave për

dëmshpërblim të paraqitur nga palët e dëmtuara, duke përfshirë zbatimin e ligjeve për kompensimin e viktimave të krimit. Lidhur me çështjen e parë, duhet theksuar se kohëzgjatja e procedurave ishte relativisht e arsyeshme. Procedura më e gjatë ka përfshirë një periudhë dy vite e gjysmë (2,5), megjithatë në një rast që është gjykuar dy herë, dhe ka përfshirë pesë vendime të gjykatave të rregullta, dy në nivel të shkallës së parë, dy në nivel të shkallës së dytë dhe një në nivel të Gjykatës Supreme. Procedura më e shkurtër ka përfshirë një periudhë shtatë (7) muajore deri në nxjerrjen e aktgjykimit të formës së prerë. Përderisa ndryshimet e vitit 2023 në Kodin e Procedurës Penale, të cilat shkurtuan afatet për hetimin dhe përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, nuk ishin të zbatueshme gjatë procedurave të këtyre rasteve studimore, me përjashtime, kohëzgjatja e procedurave në rastet studimore të përfshira në këtë raport, në përgjithësi bie brenda afateve të përcaktuara nga Kodi i ri i Procedurës Penale në këtë aspekt, që synon të përmirësojë efikasitetin e procedurave në rastet që ndërlidhen me dhunën në familje. Nga ana tjetër, dhe lidhur me çështjen e dytë, duhet theksuar se gjykatat vazhdimisht (i) urdhëruan të pandehurit që të paguajnë taksën përkatëse sipas ligjit në fuqi për kompensimin e viktimave të krimit; dhe (ii) i udhëzuan palët e dëmtuara, përkatësisht fëmijët e viktimës, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, në kuadër të procedurës penale, në procedurë civile në lidhje me kërkesat për dëmshpërblim; ndërsa (iii) nuk janë dhënë informacione në aktgjykimet përkatëse lidhur me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Gjithashtu duhet theksuar se sfidat në zbatimin e ligjeve në fuqi për kompensimin e viktimave të krimit janë adresuar, ndër të tjera, përmes raporteve të ndryshme të shoqërisë civile, duke përfshirë por pa u kufizuar, në ato të publikuara nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. Megjithatë, vëmendja ndaj padive civile, mjeteve juridike dhe çështjeve të lidhura me kompensimin është kritike, pasi ato pasqyrojnë detyrimet pozitive të shtetit sipas neneve 29 (Paditë civile dhe mjetet ligjore) dhe 30 (Kompensimi) të Konventës së Stambollit. Kjo është theksuar qartë së fundi nga Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit të saj në rastin K1129/21<sup>[103]</sup>, përmes të cilit konstatoi se autoritetet shtetërore kishin detyrim pozitiv të vepronin për të mbrojtur viktimat e dhunës dhe se mosveprimi i tyre përbënte shkelje të së drejtës së viktimës për jetën, e mbrojtur nga neni 25 (E Drejta për Jetën) i Kushtetutës dhe neni 2 (E drejta për jetën) i KEDNJ-së.

[103] Rasti K1129/21, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i 7 marsit 2023, i disponueshëm në: [Vleresim i kushtetutshmerise se "veprimeve dhe mosveprimeve" te Gjykatës Themelore ne Gjilan, Prokurorisë Themelore ne Gjilan, Stacionit Policor ne Gracanice dhe Prokurorisë Themelore ne Prishtine – Gjykata Kushtetuese \(gjk-ks.org\)](#).

## 2. Rekomandime

Siç theksohet në “*Analizën e praktikës gjyqësore mbi Femicidin dhe Femicidin në Tentativë në Bosnjë dhe Hercegovinë*”,<sup>[104]</sup> një parandalim efektiv i femicidit kërkon avancim të pozitës së gruas në të gjitha fushat e shoqërisë, punë sistematike për zhbërjen e stereotipeve dhe paragjykimëve gjinore dhe për ndryshime në modelet gjinore patriarkale, integrim të perspektivës gjinore në të gjitha politikat shtetërore, promovim dhe avancim të një kulture apo barazie gjinore dhe parandalim të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.

Në këtë aspekt, ky raport rikujton të gjeturat dhe rekomandimet përkatëse të ofruara nga raportet e shumta të përgatitura nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare për Kosovën, duke përfshirë por pa u kufizuar në (i) Raportin e Vlerësimit i GREVIO-s për Kosovën; (ii) Raportet e Rrjetit të Grave të Kosovës për dhunën me bazë gjinore në Kosovë; (iii) Amnesty International; dhe (iv) Raportet e Institutit të Kosovës për Drejtësi, veçanërisht në lidhje me ligjet që kanë të bëjnë me kompensimin e viktimave. Nuk është qëllimi i këtij raporti të përsërisë të gjeturat dhe rekomandimet që janë pasqyruar qartë në raportet dhe/ose vlerësimet e lartpërmendura. Rekomandimet e dhëna më poshtë më shumë reflektojnë dhe ndërlidhen me të gjeturat që kanë të bëjnë me analizën e praktikës gjyqësore në dispozicion në administrimin e rasteve që mund të kualifikohen në kuadër të përkufizimit përgjithësisht të pranuar të femicidit. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet sa vijon:

Përderisa është bërë përparim në cilësimin e veprës penale të vrasjes të motivuar në bazë të gjinisë si vrasje e rëndë përmes Kodit Penal të vitit 2019, në mënyrë që rastet e femicidit të hetohen, të ndiqen penalisht dhe të sanksionohen në mënyrë adekuate, femicidi duhet të parashikohet si vepër penale e veçantë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Si krim i veçantë kundër jetës dhe gjymtyrëve të një gruaje, femicidi do të përfshinte çdo formë të privimit nga jeta të një gruaje me motive gjinore, qoftë kjo me dashje apo nga pakujdesia dhe duhet të harmonizohet plotësisht me përkufizimet e përfshira në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, përkatësisht në Konventën e Stambollit.

[104] Slobodanka Konstantinović Vilić, Nevena Petrušić, Ljiljana Filipović, Obren Bužanin, Srđan Nedić, *Analysis of Case-Law on Femicide and Attempted Femicide in Bosnia and Herzegovina 2017 – 2021*, f. 195, i disponueshëm në: [Femicide\\_English.pdf \(gcjineteork.org\)](https://www.gcjineteork.org/).

Siç theksohet në raport, duke përfshirë edhe të gjeturat kryesore përkatëse, pavarësisht se Kodi Penal i vitit 2019 lejon cilësimin e një vrasjeje si të rëndë, veçanërisht për shkak se ajo ka qenë e motivuar në bazë të gjinisë, asnjë nga rastet e administruara sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk i ka cilësuar vrasjet përkatëse si vrasje të motivuara në bazë të gjinisë. Duke mos bërë një gjë të tillë, motivet e vrasjeve nuk janë analizuar dhe/ose arsyetuar siç duhet në aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se gjatë ndjekjes penale të femicidit, ky i fundit nuk duhet parë si ngjarje e izoluar, por duhet të merren parasysh specifikat e kontekstit dhe historia e dhunës. Siç është theksuar në raportin për Bosnje dhe Hercegovinën, (i) kjo do të kërkonte gjithashtu një ekzaminim të detajuar të historisë së dhunës, marrëdhënieve ndërmjet viktimave dhe kryesve, me vlerësime ekspertësh për personalitetin e kryesve, duke përfshirë pikëpamjet e tyre mizogjene; dhe (ii) hetimet për motivet e femicidit me bazë gjinore duhet të jenë gjithashtu metodike dhe shteruese, duke shkuar përtej ekzaminimit të thjeshtë të fakteve që lidhen me vendin, mënyrën dhe mjetet e kryerjes, me analizën e rëndësishme të epërsisë fizike të kryesit të dhunshëm ndaj viktimës dhe ekzistencës së pabarazisë së pushtetit.

Më tej, në mënyrë që hetimet dhe aktakuzat të jenë efektive dhe që sanksionet të jenë proporcionale me peshën e krimit dhe të arrihet ndikimi i tyre në aspektin e parandalimit të përgjithshëm, duhet të miratohen protokolle të veçanta për punën e autoriteteve dhe institucioneve kompetente në procesimin e rasteve të femicidit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në dritën e gjetjeve të këtij raporti, ku aktgjykimet e gjykatave të rregullta vazhdimisht pasqyrojnë zbatim joadekuat të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në vlerësimin dhe/ose balancimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në rastet përkatëse.

Për më tepër, çështja e statistikave dhe/ose e të dhënave të besueshme të disponueshme për rastet e dhunës në familje dhe veçanërisht femicidit dhe/ose femicidit në tentativë duhet të adresohet urgjentisht. Mungesa e të dhënave të duhura për një çështje me rëndësi të jashtëzakonshme për shoqërinë është potencuar edhe nga Raporti i Vlerësimit i GREVIO-s. Duke pranuar faktin se Databaza Nacionale ekzistuese për Dhunën në Familje, e cila ndahet vetëm ndërmjet disa institucioneve publike, mund të përmbajë informacione konfidenciale, fushëveprimi i kësaj Databaze Nacionale duhet të zgjerohet për të përfshirë të dhëna për rastet që bien nën përkufizimin e pranuar përgjithësisht të femicidit, si dhe të përfshijë të dhëna, ndër të tjera, për gjininë e kryesit dhe viktimës, motivin e krimit të kryer, klasifikimin ligjor të krimit, llojin e vendimit të nxjerrë nga gjykata, dënimin e shqiptuar ndaj kryesit, si dhe vegëza me qasje

në aktgjykimet/vendimet e gjykatave. Kjo jo vetëm që do të lehtësonte punën e institucioneve, por do të siguronte që kur paraqiten kërkesat për informacione publike, të dhënat të jenë të disponueshme dhe të mund të nxirren lehtësisht, dhe më e rëndësishmja, të përdoren në mënyrë të besueshme për të informuar institucionet përkatëse në marrjen e vendimeve të nevojshme ndërlidhur me politika si dhe për ndryshimet legjislative të nevojshme për adresimin e këtyre fenomeneve.

Së fundi, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të tri ligjeve kyçe si në vijim, përkatësisht (i) Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, me qëllim që, ndër të tjera, të sigurohet respektimi i urdhrave mbrojtës dhe që Policia të njoftohet menjëherë nëse ky nuk është rasti, duke parandaluar kështoj rastet e femicidit; (ii) Ligji nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, duke shqyrtuar gjithashtu mundësinë për të bërë ndryshimet e nevojshme legjislative me qëllim të avancimit të pozitës së palëve të dëmtuara në procedurën penale dhe vendosjes për kërkesat e tyre për dëmshpërblim në kuadër të procedurës penale, duke shmangur traumatizimin e tyre të mëtejme të shkaktuar nga gjykimet dhe/ose procedurat e mëpastajshme, përfshirë në procedurë civile; dhe në fund (iii) Ligji nr. 08/L -187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 08/L-032, i cili ka paraparë afate specifike për administrimin e hetimeve dhe përfundimin e shqyrtimeve gjyqësore në rastet e dhunës në familje. Të gjitha rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore dhe rastet që hyjnë në fushëveprimin e përkufizimit përgjithësisht të pranuar të femicidit, duhet të trajtohen në kohën e duhur nga të gjitha institucionet përgjegjëse.

## » VI. REFERENCAT

- » Amnesty International, *Nga letra në praktikë: Kosova duhet t'i mbajë zotimet ndaj të mbijetuarave të dhunës në familje*, gusht 2023.
- » Consuelo Corradi, Chaime Marcuello-Servos, Santiago Boira, Shalva Weil, *Theories of femicide and their significance for social research*, Botimet Sage, Vëllimi 64, 2016.
- » Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, i nxjerrë në shkurt 2018.
- » Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, (Botim 1).
- » Jill Radford, Diana E.H. Russell, *Femicide - The Politics of Woman Killing*, Tëayne Publishers, New York, 1992.
- » Kodi nr.04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19/2012.
- » Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2/2019.
- » Kodi nr.08/L-032 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 24/2022.
- » Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kapitulli 3, *Të Drejtat e Njeriut*, 2001.
- » Kosana Beker, Raport Rajonal, *Përgjigjet Sociale dhe Institucionale ndaj Femicideve në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi*, mars 2023.
- » Ligji nr.03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 76/2010.

- » Ligji nr.05/L -003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 12/2015.

---

- » Ligji nr.05/L-020 për Barazinë Gjinore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/2015.

---

- » Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/2015.

---

- » Ligji nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17/2015.

---

- » Ligji nr.08/L-187 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr.08/L-032, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 23/2023.

---

- » Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 33/2022.

---

- » Ligji nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në baza Gjinore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22/2023.

---

- » Ligji nr.08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal nr.06/L-074 të Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 23/2023.

---

- » Nataša Gaber-Damjanovska, Gabriela Gajdova, *Femicide in the Republic of North Macedonia: The state of affairs, the legal framework and the judicial practice* 2018-2022.

---

- » Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Anкета për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë, 2019.

---

- » Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhimë Viktimave, të nxjerra nga Prokurori i Shtetit në vitin 2013.

---

- » Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, të nxjerra nga Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, në vitin 2013.
- » Protokollu Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Kosovë, i miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2022.
- » Rasti K1129/21, parashtrues V.S., Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese i 7 marsit 2023.
- » Raporti i Institutit të Kosovës për Drejtësi, *Dështimi i gjykatave në mbushjen e Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin*, publikuar në qershor 2020.
- » Raporti i Institutit të Kosovës për Drejtësi, *Sfidat e zbatimit të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin*, publikuar në tetor 2021.
- » Raporti i Institutit të Kosovës për Drejtësi, *Kompensimi i viktimave të dhunës në familje*, publikuar në shtator 2023.
- » Rrjeti i Grave të Kosovës, Nga Ligjet në Vepra - *Monitorimi i Përgjigjes Institucionale ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, 2021.
- » Slobodanka Konstantinović Vilić, Nevena Petrušić, Ljiljana Filipović, Obren Bužanin, Srđan Nedić, *Analysis of Case-Laë on Femicide and Attempted Femicide in Bosnia and Herzegovina 2017 – 2021*.
- » Slobodanka Konstantinović Vilić, Nevena Petrušić, Natalija Žunić, Vida Vilić, Kosana Beker, *Femicides and Attempted Femicides in Serbia 2015–2019* (Versioni i shkurtuar).
- » Strategjia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, e miratuar nga Qeveria në vitin 2022.
- » Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), *Rekomandimet e Përgjithshme të CEDAW nr. 19, miratuar në Sesionin e njëmbëdhjetë*, (përbahet në Dokumentin A/47/38), 1992.



- » Udhëzimi lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës në vitin 2020.

---

- » UN Women, *Five essential facts to know about femicide*.

---

- » UNODC, UN Women, *Gender-related killings of women and girls (femicide/feminicide), Global estimates of female intimate partner/family-related homicides in 2022*.

---

- » UNODC, UN Women, *Statistical framework for measuring the gender-related killing of women and girls (also referred to as "femicide/feminicide")*.

---

- » Virginia Gil Portoles, Eileen Skinnider, Valentine Josenhans, *Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), 2022*.

---

- » Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës, *Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, gusht 2023*.

---





